



TINGUJ NGA SIRTARËT

STUDIME MBI ZEF ZORBËN



QENDRA KOMBËTARE
E LIBRIT DHE LEXIMIT



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I HISTORISË DHE I FILOLOGJISË
DEPARTAMENTI I LETËRSISË

TINGUIJ NGA SIRTARËT:
STUDIME MBI ZEF ZORBËN

*Udhëhoqi dhe përgatiti për botim:
Prof.asoc.dr. Viola Isufaj*

Parathënie

RIKTHIMI I ZEF ZORBËS

*Mu në palcë
Pikëllimi i kujtimeve tuaja,
O rrugët e errëta...*

Në fundmajin e vitit 1989, Zef Zorba u ul të shkruante mbi “errësinë” që mbartnin vargjet e tij. Teksa i kishte bërë gati poezitë në një libër (*Buzë të ngrira në gaz*, që do të botohej në vitin 2010 nga “Princi”), ashtu si etërit e tij shpirtërorë: Bodler, Ungareti, Montale, Quasimondo, ai donte të bënte rrëfimin. Fenomenologjia e brendshme e vargut duhet të shkonte si një muzikë, e të pushtonte zemrën e çdo lexuesi.

Përfytyrimin vetjak e kishte lidhur fort me rrugën e “esencialitetit” apo “hermetizmit” e kjo mund ta stepte një lexues të mësuar me një formë tjetër poezie. Zorba shpjegon se kishte bërë të vetat fjalët e Ungaretit: “ai [Ungareti] dëshiron të kuptohet... se forma e mundon vetëm sepse kërkon me këmbëngulje që ajo të përkojë me ndryshimet që pëson shpirti i tij, ai dëshiron që ajo të paraqiste ndonjë prej krijimeve të arritura të tij si njeri”. Po ashtu i rrinte gjithmonë në mendje sinteza që i bën Montales kritiku S. Solmi, kur shkruante se: “... muzika e ashpër e të cilit [Montales] zbulon koloritet, fragmentet mahnitëse të një bote të dendur, e cila nëpërmjet ecjes fatale të makinës së vet përbindëshe, shkon dora-dorës duke fshirë çdo shteg, çdo iluzion shpëtimi”.

“Vetëm se do dëshiroja të mos keqkuptohet admirimi që kam për poezinë moderne që nga Bodler te Montale e sidomos metoda e ‘esencialitetit’ dhe ‘hermetizmit’ diktuar prej tyre. Kam mësuar shumë prej tyre, kam parë si ata shpuprojnë ndjenja e emocione, si

unisojnë në vargjet e veta poetike çdo vështrim artistik, si manipulojnë mjete të ndërlikuara, duke ia shtuar një regjimi të fortë analize e kursimi...”, vijon Zorba.

Si njohës i mirë i hermetizmit, ai e dinte se ndryshe nga format e tjera të poezisë, kjo poezi ngre më shumë mure para lexuesit, e se depërtimi në zemër të saj, ndonjëherë kërkon kode, që gjenden sërish në tekst:

*Tash qiellzash enden
Me qindra hënë
Të reja
Njeriu s'krijoka tjetër veç kobe:
Çelik e gizë e refraktarë;
Zogjtë artificialë,
Lindur ndër ofiçina-inkubatrice
Si hëna tokën përgjojnë
E përpunojnë
Epshe tinëzare
Trofesh e përdhunimesh...*

Hermetizmi i Zorbës shfaqet krejt ndryshe nga i frymëzuesve të tij. Ekzistencializmi, që përshkon vargjet e vëllimit *Buzë të ngrira në të çon drejt shpresës*. Ndoshta se poeti e gjeti shpëtimin te shpuplimi dhe ushqimi i vazhdueshëm me leksikun e idiomat e traditës; ose ndoshta se kishte zbuluar kuptimin e vërtetë të poezisë që është vetë ekzistenca e njeriut. Nëse hermetizmi shihej si një frymë që u përket letërsive të tjera, libri i tij vjen për të pasuruar letërsinë shqipe me një formë që vetë rrethanat historike e bënin të munguar.

Me një jetë të ngjashme me vargjet që shkroi, Zef Zorba vjen para lexuesit në një shekull që nuk e jetoi, në shekullin XXI, si përfaqësues i denjë i poezisë shqipe. Kritika dhe studimet tona janë ndalur shumë pak për të treguar dimensionin e këtij poeti, që u shfaq si një vezullim në letrat shqipe pas viteve '90-të, si një modernist *par-exelence*, i rrethuar me kureshtjen e përhershme që mbartin figura të tilla. Rrëfimi i tij në pasthënien e librit, tregon figurën e një poeti të thellë,

që endet nëpër labirinte të së brendshmes, për të treguar si krijohet muzika, ajo muzikë për të cilën poezia shqipe ka folur aq pak: “Kam bërë përpjekje për të mobilizuar mjete nga më të ndryshmet. Për unjism muzikal është kërkuar jo vetëm ritmi i qenësishëm në fjalët e në vargje, por edhe tentativa e riprodhimit të formave muzikore, fugat, fugatot, sonatat me tempot, kadencat...”, shkruan Zorba. Ai është ndër poetët e vetëm që kërkon ta lidhë poezinë me muzikën, duke besuar se muzikaliteti i së brendshmes duhet të shëndrrohet në nota.

Zef Zorba lindi më 31 mars 1920, në Kotorr të Malit të Zi, në një familje shqiptare. Mbas mbarimit të gjimnazit në Shkodër, më 1941, ai regjistrohet në Fakultetin e Shkencave Shoqërore, dega e Studimeve Politike, në Universitetin e Padovas, në Itali. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, më 1943, i ndërpret studimet për t’u kthyer në Shkodër. Në vitet 1945-’46 punon si regjisor në Shtëpinë e Kulturës, ku vë në skenë vepra dramatike, me tingëllim të qartë disident, si: *Juda Makabe* e Gj. Fishtës, *Armiku i Popullit* i H. Ibsenit etj. Për këtë arsye mund të jetë arrestuar më 1946 dhe burgoset nën akuzën e agjitacionit dhe propagandës. Vuan dënimin deri në vitin 1951, e pas burgimit ndoshta e kuptoi se rruga e vetme për të jetuar me artin ishte mbyllja në vetvete dhe hermetizmi.

Këtë vit shënjohet 100-vjetori i lindjes së këtij poeti, ndër më të rëndësishmit e gjysmës së dytë të shekullit XX, e asaj periudhe që e lidhim me soc-realizmin, mu në mes të territ të të cilit, Zorba, me heshtjen e tij, arriti të konfiguronte avangardizmin në poezinë shqipe.

Në pamundësi për të zhvilluar veprimtaritë e programuara (prej pandemisë së virusit), Qendra Kombëtare e Librit dhe Leximit, në bashkëpunim me Departamentin e Letërsisë, në Universitetin e Tiranës, sjell për lexuesit këtë libër me studime, pikërisht në *Ditën Botërore të Librit dhe të së Drejtës së Autorit*, në shenjë vlerësimi e mirënjohjeje të pamatë për jetën dhe krijimtarinë e Zef Zorbës.

Profesoresha e Letërsisë Bashkëkohore, Viola Isufaj ka përgatitur për botim këtë përmbledhje studimore mbi krijimtarinë e poetit, e para e këtij lloji, me punime të studentëve të degës së Gjuhës dhe të

Letërsisë Shqipe. Para pak vitesh, ajo ka bërë të mundur përfshirjen e veprës letrare të Zorbës në programin mësimor të “Poezisë Bashkëkohore”, për të vijuar me studimin e veprës së tij edhe me udhëheqjen e temave të kursit, mikrotezave e temave të diplomave, duke iu qasur këtij poeti nga pikëvështrime të ndryshme e të thelluara.

Besojmë se admiruesit e poezisë e aq më tepër ata që prej vitesh ndiejnë mungesën e poetit do të jenë vërtet të kënaqur kur të shohin mirëseardhjen e autorit të tyre të parapëlqyer në auditorët e universitetit, si dhe të shijojnë frymëzimin e të rinjve, që e përngjall rishtas Zef Zorbën prej sirtarësh.

*Drejtore e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit,
Alda Bardhyli, 2020*

~ Poezi të zgjedhura ~

Tjera blerime
Terezës

Si lule dyelli gjethet
veshur me vapë e t'zberë
e nuk lëvizin...
e merrnin frymë me zor...
e...oh...
S`andejmi
ku paskeshin ngelur kujtesë brymore
zgjohen flauri
tjera blerime,
rinore
(A të kujtohet? Atë verë
burimet heshtja na i trazonte.
këndoja vijat e fatit
në dorën tënde flakë.
Endeshim rrugësh të çuditshme,
pa folë.

Pastaj n`teatër; një Gjido
i larë në djersë
përpëlitej i falisur.
Ti shkuleshe n`gaz me të madhe,
por në sy të vetëtinte
stuhia e Shtatorit...
A të kujtohet?)

Prap me furi

Mëngjezesh të himta murlani
Hardhitë gungaçe përqeshë
m'anë Zallit të Kirit.

Andante mosso

Se çfarë kumbon, se ku ndriçon s'e dijmë:
vetiu prej dheu buron trishtim e mjegull.
Prej gjumit shekullor, ende të gjalla
Lajthitjet kot se i përpushë: qenkan shfrime
Tani të pezmatuara: vetëtima
Që flakuruan dikur (e ç'përcullonin!).
Div i kërtlyur ëndrrimesh, pa drojtje
zhigat kundroje, e syri fek s'të bënte
pse binin një pas një: e Zot, e trima,
e dituri te lashta. Dhe atëherë me shifra
ujdi sendërgjoje, e vetëm lëndës
ia pate besën, pa e marrë në dorë
teposhtën.
Por gjeometria afshin nuk ta zgjidhi,
madje as vargu, kur e hulumtove
në difraksion rrezesh iks jeremisur
ke mbetë
në mes të askurrgjësë e të pambarimit....

Allegro furioso

.... e shpesh kam pa liqenin të shpupurishur:
kundër reve të mbarsura
me shkreptëtira të dhunshme,
me kordha shkumësh të pareshtura,
me gjithë sa kishte frymë,
sulmonte, e gërmushej;

por shi vazhdoi me ra....

Lento

Për çdo 10 qershor

Rrugë e përmbytur në mjegull, ngushtime
rrathësh, kjo amulli e hirtë ku shuhet
hingëllime kuajsh të stërvinuar harrese.

(Oh, kot se i përsëris me mend poetët!
Kurdoherë e më fort ushtojnë fjalët
që, herët atë mëngjez, të cunguara
si lamsh iu lidhen gruas në fyt kur tha:
“o burrë, nuk ke çka bën, nuk ke...na vdiq...”

E vështrova -atëherë - majat e pemëve:
avullonin në qullin e çative
me vorbuj vese.
Stinës i paskëshin mbaruar ditët
ndër labirinte aq të ndërlikuar,
por jo si m'i pati shtruar ajo
kur sytë i bënte mjaltë e më tregonte
detin e horizontin, e kristalet
e praruar që shkumën posa e ciknin
kinse me siguri libimi
ndër brigje...)

S'kam më nevojë me pa. Tash përmbi mjegull
e di se plyma shpendësh të uritur
sulen drejt bregut moçalor të liqenit....
por i kthen veri mbrapa; sikur dhe mua
shortin ma dredh e që s'më shqitet më dot:

të mos e honeps prap tymin
e furrës gëlqerore
m'atë anë të liqenit
që malit papushim
gjithnjë
i lëvyret e i lëvyret....

*Raki e lirika**- Baladë -*

O ndoshta angushtia, o veç nevoja
 për hapësi më të madhe se dhomat,
 të Djelash mbasdite na shpie në rrugë...
 ...e rruga qenkesh plym me njerëz që enden
 poshtë e përpjetë, e njëri tjetrin shohin
 shtrembër, pa fek ndër sy (sikur këqyren
 statujat prej porcelani me kukullat
 n'vitrinat e Mapos, në prak të Vitit
 të Ri)

Por ne vrojtimin tresim lart
 ku rrezet e perëndimit përhudhen
 akrobatike çati më çati;
 rreze ato, të vetmet që ne kapim
 pa cingërime t'ashpëra – frekuencat
 tona mbi artin, estetikën, fjalën
 e zorshme. E bota edhe mund të qeshet
 për ne, kur shetitorja ka kaq femra
 të bukura, me veshje prej najloni,
 ku ijet valë-e-valë e ritmíkisht
 i përkundin; kur shihen asi burrash
 të rëndë e me kostume gri të hapët
 që të përshëndesin me ulje qepallash
 (por që ka vlerë sa një shpërblim vjetor!)
 Fytyra të përditshme... [...]

“Eh, po...”-ia bëre ti
 e më nuk fole, pse për tjera fjalë
 nuk paskërka nevojë as ironia.

Por s' u durova unë: "E pse nuk dalim
prej këtij vorbulli? Në qoshen e terracës
së Kafes, te parmaku, qenka bosh
një tavolinë." - Dakord - ma miratove
ti... dhe ndenjëm. [...]

Mbi tavolinën brune tonë
vendosi katër gota me raki...
Ti je e përmbajtur, unë aspak: bërtita:
"Duam dy raki, jo katër! dy raki...
e dy lirika...! - "Çfarë?!..." - shkrepri rrufe
e ra mes sheshit sa një obelisk,
pika çuditëse e saj... E trimijë
zemra shtanguan në vend, e dyfish sy
terrën zhbiruan përmbi çatitë, kush pati
dorën në xhep, te goja shpejt e çoi
një britmë për me ndalue. [...]

"Mbase lirikat
janë brenda në raki..." Unë zura kryet
me grushta: si të mos kish ndodhur gjë
vozitja xixëlluese stërkeqej
(dhe e quejtkan "gjallëri") e po harbonte
sërishmi nëpër bulevard, njësoj
me ankth, me po atë ëndërr që s'ia thonë
as vetes: frikë e mërtisur me qeshje
stereotipe manikinash parafine,
me xhupa blu, me organtina,
si ficka verdh... e sy pa kokërdhokë... [...]

Ti more një raki në dorë e unë
një tjetër. Në dy gotat mbi tavolinë
notonte nga një yll i bardhë, e dridhej,
e vezullonte....

Nuk e çuam rakinë,
por ulëm gotat: yjet u bënë katër.
"Ah, – thirra i shpërbërë – ah, si nuk vjen
sërish kamarierja, [...]..."
Ti prap ma miratove, por: "Ç't'i bëjsh..."
the, dhe e përcolle fjalën me nënqeshje.
Mbetem si dy qyqarë...

E kush e di
gjer kur kryevarë do të kishim ngelë
të mos na qasej papritur ai çifti
i huaj, i atyre që fotografonin
majat. Na erdhën pranë e po na lutnin:
"Can we join you in your table?"

Dhe u ulën
në dy karriget bosh. "Amerikanë?" -
ti ju drejtove. "No, nein, non, njet, no..."
shpejt u përgjigjën.

Ishte ajo si plazëm.
Në flokët e lëshuar, si penda e korbit,
notonin marramendas blutë e Jonit,
e u vinte era mollë e manaferrë...
Faqet me duar mërtiste, por shkëlqenin
porsi fildish pas gishtash; e dy sytë
– dy buçila që shkëlqejnë mes borës, [...]
"Shiko – më the – se ku i paska gjetur
lulet e jargavanit, edhe pse
tash në Korrik s'ka lule jargavani;

si në frymëmarrje i ndihet qartë dihatja
e ndeshjes në stadium, o një përqethje
vajzash që zgjat veç një të qindtë sekondi.”

Kish bluzën bojë orizi e gjithandej
me guaska, verdh e blu e manushaqe.

Ai vinte i hollë e i gjatë, madje më i gjatë
se çdo shejtnor i El Grecos. Pa ndërprerje
thithte llullën e tymi ia mbështillte
kokën për rreth, si brenda një aureole
të bërë me pluhur “spray” varaku t’imtë
që sytë ia mbushnin me shkëndija, e fjalën
ia tingëllonte si në ani kozmike,
qofshin për lutje, o për një gjemb mersine,
e për pajtim të foshnjës kur kjason,
o kur për valën flet që rërën lmon
me ëmbëlsi.

Kur kryet ajo mbi sup
ia mbështeti, me leshterikë lundruës
sikur u mvesh; e lehtë-e-lehtë ia mori
një kënge plot me “s” e me zanore
të dredhura, një melodi që zvarrë
tërhoqi sheshin, bulevardin, pishat,
yjet feksuese në qiell, e deri flladin.
“Oh-pëshpërita i tretur – she can hear
the daisies grow”.

Sa gota i ngritëm tok?
Kush i numëroi? Dolli e vargje na ngrenin
Mbi re sikur me aerostat
“Nga vini?-

i pyetëm. "Prej Parnasit: breg polar,
 ku natën del aureola boreale...
 e piqen portokalle.- "Jo-qeshi ajo-
 nga shkreti e Saharës; si mirash
 mund të duket, por gjendet përnjëmend;
 në mes të verës pellgu ngrin akull;
 aty zhvillohen gara patinazhi
 çdo vit. Ç' "teta", sa spirale bëjnë
 mbi akull, veç t'i shihnit-mrekulli!..."
 "Just as in California -ai pohoi -
 dikur aty patën ngritur një "lager"
 - shtoi me trishtim - Maitenant il n'y a pas. Tani
 s'ka "lager" më!... por po ndërtojmë një rampë...
 - zëri iu fik. Por ajo butë ia priti:
 "Qu'importe, my dear!... [...] Përtëritja
 nuk ka të sosur... vdekja s'ka ç'na bën. [...]
 sërishmi do të dëgjojmë kanone
 Mozartiane... "In un tedio malcerto
 il certo tuo fuoco..."

E papritur dritat
 U shuan. Zukatja e rrugës u fashit;
 - si të kish ra murtaja - dhe çdo puls
 u ngath. Tinës krejt sheshi u boshatis,
 e heshtja lmuç plandosi anë-e-mbanë...
 Në pauzën që mortoi të merrej fryma;
 harbonte errësi...
 Por ne shikimin
 e çuam përpjetë ku yjet po ndriçonin. [...]
 - çoi gotën ai e thirri sa ku mundi,
 e brofëm n'këmbë të gjithë e gotat plot
 i kapërdimë e i flakëm në çimento
 të Kafes; podi sëpari kumboi
 mandej krejt sheshi bosh, e krejt qyteti
 gjëmoi e mori dhenë hareja e shendi: . [...]

Ashtu të ndezur flakë
Me turr në mes të sheshit zbritëm, dorë
për dore u kapëm, e shaminë e kokës
ajo duke tundur na priu në valle:
“Hej largohu mal sa të dali hana, sa
t’na bajë dritën për mbrama!...”
E ne të dy
ishim në mes e bota po na dukej
e madhe sa një diell.

Natën, kur bie shi...

Natën,
kur bie shi me rrëshekë
e n'errësirë
radioja transmeton
- ritmuar me shkrepëtira-
mazurkat e Shopenit
kujto trogloditin:
njeriu i Neándertalit,
me trurin plot përbindsha viganë
e zvarranikë tinzarë e të neveritshëm,
në skutën me qullë të shpellës
- i ngrysur, i uritur -
mendime yjesh përçapë,
botën e ndritur me flakë,
që akujt e kobit, shtijakë
t'mos e shporojnë.
Rëndomët një gazmend e vokë,
në sfera përmbi sfera
e flakëron të lehtë,
në ëndrrën që nis e bëhet jetë...

natën,
kur bie shi me rrëshekë.

Natën,
kur bie shi me rrëshekë,
kur buron shiroku e thyen xhame,
kur daca të kërleshur
në trapazane
me dufe çirren, me inate,
me serenatë,

kujto Diogjenin:
stoiku i stërkequr,
i velur neverish,
kacuk
para fuçisë,
ndragur prej lotësh e vreri,
prap dhe njëherë
beson
një fill sikur e kapë
- qoftë veç një zë, një tingull
që rishtas ta çojë peshë
për çka askurrë nuk kishte gjetë...

natën,
kur bie shi me rrëshekë.

Natën,
kur bie shi me rrëshekë,
ku qielli bubullues
çatitë gërmuçe i tremb,
kur drurin e krevatit
tenja ngulmuese e bren
me kadencë sahati,
kujto Kolombin:
eksploratori,
i mbledhur shuk në vetvete,
sytë i bën ujë
mos tutje perëndimit
të qenkish horizonti i përdredhur
(thua gjer aq larg
nuk mund u sulkan dallgët?)
e sikur tjera herë
në ankime imagjinare tretë....

natën,
kur bie shi me rrëshekë.

Natën
kur bie shi me rrëshekë,
kur mbi kalldrëm, mbi trotuar
pullazet katarakte shprazin
e kur jehonë të piskatura
në labirinte mendimesh
mbështillen e harbojnë
përtej çdo pentagrami,
kujto Bethovenin:
mërguar nën kreshtën e çapërdisur
- me tymra, me shpaté,
me ngjyra ylberi,
me dashuri
e me shpërthime -
mbrun, hedh në erë, përplasë
këtu një namë, atje një afsh...
... një lumturi
(o veç shëmbëllesë të një pajtimi?)
që kurrë s'i gjeti në jetë...

natën
kur bie shi me rrëshekë.

Natën
kur bie shi me rrëshekë,
kur vetëtimat thyejnë
kupën e brishtë
si leskër gatarine
e zjarrit të përjetshëm
shtegun ia hapin drejt tokës,
kujto Ainshtajnin:
divi i papërfillur,
i mjerë,

tek dirgjet kurbash ideore
 për një vështtrim,
 - së paku për vetvete -
 për një buzëqeshje
 mbrapa infinitit e tëhu
 kufiza shkarëse shigjete....

natën,
 kur bie shi me rrëshekë.

Natën
 kur bie shi me rrëshekë,
 në "allegrot" e pafund
 që këso netësh
 burojnë e kullojnë
 shkëndijëvishëm
 - ngjyrimë që përftohen
 përtej gamës optike -
 kur mjaltë e gjumit përkëdhelë,
 kur duar të buta të kapitjes
 qafën me afsh ta rrokin,
 kujto Ungaretin,
 dashnorin,
 kujto Kuazimodon,
 pikllimin,
 kujto Montalen,
 zhgënjimin....

natën,
 kur bie shi me rrëshekë...
 kur bie shi.... kur bie... kur...

Marinela Hysenllari

PËRKIME DHE NDIKIME NË POEZINË E ZEF ZORBËS

Zef Zorba – individualiteti krijues

Ajo që më zgjoi kërshtërinë e përzgjedhjes së këtij poeti është interesi për të analizuar një individualitet krijues e një vëllim poetik, kritikën dhe vlerësimet mbi të cilët, janë të pakta. Gjithashtu, një tjetër faktor nxitës është edhe shija ime estetike kundrejt poezisë hermetike, si dhe njohja e mirë e poetëve italianë nga të cilët, Zef Zorba pati ndikime të dukshme.

Për poetin Zef Zorba, i cili është bërë i njohur për lexuesin pas vdekjes, nuk është shkruar shumë. Ka disa vlerësime të rëndësishme nga kritikë e shkrimtarë si: Ismail Kadare (i cili ka shkruar edhe parathënien e librit), Sabri Hamiti të *Albanizma*, Nehas Sopaj e Ardian Ndreca, që hedhin dritë si mbi formacionin poetik të Zef Zorbës, ashtu edhe për vëllimin *Buzë të ngrira në gaz*. Mendoj që duhet të pasohen nga të tjera punime e vlerësime shkencore për të shteruar plotësisht individualitetin krijues të Zef Zorbës, vlerat estetike të *Buzë të ngrira në gaz*, e mbi të gjitha, për të kuptuar se si qëndron kjo vepër në raport me sistemin tonë letrar. Në parathënien poetike *Buzë të ngrira në gaz*, Ismail Kadare shprehet se Zef Zorba, duke qenë më i pashquari i poetëve, më i mbështjelli nga heshtja dhe nga terri, na shfaqet në të vërtetën, pamjen dhe përmasat e tij të tjera. Studiues të tjerë e kanë konsideruar të errët e të mbyllur, hermetik e poetin profetik që nuk shkroi për lexuesin e kohës së tij, por për atë të së ardhmes.

Duke qenë poet hermetik, receptimi i veprës së Zorbës nga lexuesi ka qenë vlerësimi i kritikës për veprën e tij. I frymëzuar apo dhe ndikuar prej poetëve të huaj, janë pranëvënë në rrafsh krahasues

poetikat, mjetet stilistikore, tematikat, figuracioni e kompozicioni i veprave të tyre me ato të Zorbës, me qëllim që të nënvizohen jo vetëm ndikimet specifike dhe sendërtimi i tyre te poezia e Zorbës, por edhe të përcaktohet se si personalizimi i këtyre teknikave i jep tipare origjinale gjithë vëllimit poetik. Në këtë kuadër janë përcaktuar edhe mënyrat sesi Zorba, për herë të parë në poezinë shqipe, e ndërthur muzikalitetin e vargut në një formë të veçantë, ndryshe nga pararendësit e tij, Lasgush Poradeci, Fan Noli etj.

Si vijon do të trajtohen çështjet që përcaktojnë individualitetin krijues të poetit nëpërmjet veprës së tij; raporti i tekstit letrar me kontekstin historiko-social dhe rëndësinë e jashtëzakonshme komunikuese të veprës letrare me receptuesin, shfaqet e hermetizmit në poezinë shqiptare, por edhe të origjinalitetit të Zef Zorbës.

Receptimi i veprës *Buzë të ngrira në gaz* në sistemin tonë letrar

Për sa i përket jetës intime të Zef Zorbës dhe mbrujtjes poetike, Ismail Kadare do të shkruante në parathënien e librit të tij: “I arrestuar bashkë me gruan e tij të re, pas lirimit nga burgu, pesë vite më pas, më 1957, ai, natyrë e ndjeshme e poetike si rrallëkush, e kuptoi se rruga e tij në art nuk mund të ishte veçse ajo e mbylljes në vetvete dhe e mënjanimit. Ndërkaq, ndonëse i tillë, ai u bë poet i kohës, në qoftë se do të pranojmë, siç u tha më lart, se zona e heshtjes, ku ai dhe të tjerë si ai, krijojnë art, ishte pjesë e rëndësishme e kohës. Zgjedhja e Zef Zorbës e këtij lloji arti ishte e pashmangshme. Arsyeja kryesore përse ai e sprapsi tundimin e natyrshëm të botimit ishte, sepse ndihej krejtësisht i huaj ndaj regjimit që u vendos në Shqipëri... Shumë njerëz mund të bëjnë sot këtë pyetje naive lidhur me “letërsinë e sirtarëve”, dhe kjo gjë do të vazhdojë deri në hapjen e plotë të arkivave të fshehta, prej të cilave do të mësohen shumë gjëra. E ndër to do të mësohen padyshim mënyrat e sofistikuara të shtrirjes së përgjimit totalitar gjer atje ku është e vështirë të përfytyrohet”.¹

¹ Ismail Kadare, parathënie, në: Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, dhjetor, 2009, f. 9-13

Sado paradoksale të duket, në fund të fundit, ai shkroi për të ardhmen, për kohën kur do botohej. Nuk është e rastit që vargjet e fundit të kësaj përmbledhjeje poetike janë:

*O, jetë!
edhe në zgrip...
shtegtarët e tu
Gjithnjë dashurojnë!*

Ai është ndër të rrallët poetë shqiptarë, që bëri eksperimente avangardiste, aq pak të pranishme në poezinë shqipe. Një nga këto është synimi për një martesë të lumtur të poezisë me muzikën, duke gërshetuar teknikat e tyre. Ndërkaq, ky pasion i tij për avangardizmin, nuk pengon që herë pas here, pas vargjeve të tij të ndihet fryma dhe ritmika e Dantes.

*Bie ora pesë e unë kryqin marr në krah
e me pak frymë fillohem për Kalvar
Eci. Dhe me ngadalë e lehte një këngë sajohet
Ndër dej: "ad adiavandum me festona".
E këmba përmbi baltë lë gjurmë të thella*

E njëjta frymë zotëron në përkthimet e tij që nga Ungareti dhe Elioti:

... e perdja ra, pa përfunduar akti.

Kështu ka shkruar Zef Zorba në vjeshtë të datës 29 mars, të vitit 1957, mu në mes të natës totalitare. Të njëjtën poezi të trishtueshme ai e mbyll me vargun "*Vec drita s'ka mbarim*". E kjo do të thotë se kur ka qenë i ligështuar në shpirt, në thellësi të tij ai ka besuar se perdja do të ngrihej përsëri, e për rrjedhojë, akti do të vazhdonte. Pas botimit e ribotimit të veprës *Buzë të ngrira në gaz*, jehona e kritikës zorbiane nisi të jepte vlerësimet e para. Në këtë kontekst, Ardian Ndreca do të shkruante: "Jeta e poetit Zef Zorba ka pak data, mbasi kuptimsia e qenies së tij vinte prej përtypjes së pafund të emocioneve dhe prej hapsinës së pamatun të ndjenjave. Emocionet e ndjenjat nuk kanë

data, pse nuk matën me ditë e orë, por vetëm me intensitetin e tyre të papërsëritshëm. Flas për një kohë kur poezia ishte çnjerëzue prej idhujtarisë së verbër të pushtetit e asokohe Zef Zorba maste hapat e shpirtit të vet me Montale, Ungaretin, Quasimodon etj... Poezia shqiptare njeh, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluem, dy poetë hermetikë: Martin Camajn dhe Zef Zorbën. I pari, i imun, i dyti, i padukshëm. Camaj mbart në hermetizmin e tij, diçka prej mënyrave lakonike të shprehjes së urtisë se malësorëve, ndërsa Zorba asht i errët, “skoteinos” në sensin antik grek të termit, ai ia mbyll dritaren mushicave por len që nëpërmjet saj të depertojë një dritë e zbehtë hane që i jep kuptim çdo gjaje. Ajo çka ka rëndësi në veprën e Zorbës është hija e objekteve sesa përmasat e tyre reale.. Hermetizmi i Zef Zorbës ka kuptim të dyfishtë: ekzistencial dhe profetik. Ekzistencial se koha në të cilën ai jetoi nuk i lejonte as të mirët as të këqijtë me përfutue idenë të qarta e të dallueshme. Profetik, pse poetik mbërrin me shikue përtej mjegullës së kohës dhe me dhanë sinjale, të cilat për shumë kend janë të dobëta e të pakuptueshme, por mbartin me vete një andërr të pame me sy të çilë, siç e kanë përçasue andrren e shpresës shndërruese².

Poezia e tij është e përshkueshme anë e përtej përmes notash lirike që herë-herë janë të pakapshme prej lexuesit të rëndomtë.

Shpejto, pranverë!

*Kjo shpresa qenkish tharm që shpirtin bren
më keq se urithi dhenë.*

... Ndër të gjithë autorët e “letërsisë së sirtarit”, ndahet në shenjë Zef Zorba, frymëmarrja poetike e të cilit, ka gjallnue fjalë e thërrmiza fjalësh, pa pasë nevojë me u ba patetik e i mërzitshëm. Ai bahet gati sot, ma në fund, me ardh drejt lexuesit me një botim të ri, tue na pru freskinë e tij ndriçuese me fjalën e kursyeme e me penelatat e zbehtë që kajherë lejojnë me shikue dhe përtej fjalës.”³

² Ardian Ndreca, shkëputur nga editoriali “Letërsia në pritje të poetit”, 2008

³ Po aty

Studiuesi Nehas Sopaj do të shprehej kështu për Zef Zorbën: “... një poezi me titull “një gozhdë” bashkë me disa poezi të tjera të autorit Zef Zorba, të botuar në tekstin shkollor Maja e çelur, të autorëve Gj. Zheji dhe V. Zhashka, ka zgjuar kureshtjen time për këtë autor, të panjohur fare prej meje në fillim; ndërkaq, antologjia e A. Aliut, në të cilën vërehet, pos një hapësire më të gjerë të prezantimit të tij, gjatë kohës më linte indolent të dija më shumë për të, dhe ky është hapi i dytë i njohjes së këtij autori... Paqartësitë që i implikon fenomeni letrar i Zef Zorbës, i sqaron dhe i determinon poezia e tij”.⁴

Me pak fjalë, ai flet për burimësinë e poezisë së tij, e cila e shquan natyrën e artit të tij, kurse kjo është poezia hermetike. Fjalët e tij të para flasin për errësirën e poezive të tij, pastaj për sintaksën, metaforat, metonimitë, prozodinë, për të folur në fund për çështje të fenomenologjisë së artit. Poetët e adhuroar të poetit tonë.

“Just as in California- ai pohoi-
 Dikur aty patë ngrejtur një “lager”
 - shtoi me trishtim- Maitenant il n’ya pas. Tani
 S’ka “lager më” ... Por po ndërtojnë një
 rampe...
 - zëri iu fik”. Por ajo butë ia priti:
 “ Qu’ importe, my dear! në shpellat troglodinte
 Prap mirrë e kem do djegim. Përtëritja
 nuk ka të sosur... vdekja s’ka ç’na bën
 Pastaj prej radios stereofonike
 Së rishmi do të dëgjojmë kanone
 Mozartiane... “In un tedio malcerto
 Il certo tuo fuoco...”

Vendi i analizës së Zef Zorbës duhet kërkuar në një laborator poetik herë të hapur e herë të mbyllur, të një ligjërimi autentik, kaq shumë të përkryer artistikisht sa ndonjëherë arrin kuptimin e të

⁴ Nehas Sopaj, *Shpalimi i herbariumit*, “Jehona e Karadakut”, 2008, f. 63, 64

pamundshmes, të paprekshmërisë dhe të ekskluzivitetit, që d.m.th., kufirin ku formulimet poetike, bëhen të paarrtshme që t'i "prekin" horizontet e fjalës poetike që tingëllojnë para lexuesve të besuar.

Mund të pohojmë se vëllimi i tij poetik *Buzë të ngrira në gaz*, dëshmon gjurmë të hermetizmit, duke sjellë në letërsinë shqipe një lloj poezie të panjohur deri më atëherë. Në këtë kontekst, mund të përmendim: mungesën e shenjave të pikësimit, korrelacionet e objekteve apo imazhet e përzgjedhura për përçimin e një gjendjeje të caktuar emocionale të poetit, fragmetarizimin e vargut dhe disa teknika sintaksore krejt të reja në poezinë shqipe. Në sistemin letrar shqiptar, Zorba i mëshoi fort simboleve e vargut hermetik, ndryshe nga bashkëkohësit e tjerë, të cilët, edhe kur e përdorën simbolin, nuk e fshehën pas imazheve apo objekteve, por nëpërmjet tij u shpërfaqën me gjithë botëkuptimin e tyre.

**Ndikimet dhe marrëdhëniet e Zef Zorbës me shkrimtarët e huaj:
(Eugenio Montale, Salvatore Quasimodo, Giuseppe Ungaretti dhe
Tomas Eliot)**

Vetë Zorba në pasthënien e librit të tij do të pohonte: "Kam bërë të miat fjalët e Ungaretit. Ai dëshiron të kuptohet... se forma e mundon vetëm se kërkon me këmbëngulje që ajo të përkojë me ndryshimet që pëson shpirti i tij, ai dëshiron që ajo (forma) të paraqiste ndonjë prej krijimeve të arritura prej tij si njeri. Konsumatorit të sotshëm të letërsisë i duhet të jetë si vizitori i Louvr-it që kuvendon me Leonardo da Vinçin para Giacondës, ose si ai që ankon e galdon me Vangogun para një peizazhi norman. Ose si lexuesi i Ungaretit që vuan e heq, e vuan të zitë e ullirit bashkë me poetin në llogoret e luftës"⁵. Siç pohon vetë poeti, poezia e tij pati një ndikim të fuqishëm nga "hermetizmi Ungarettian". Si te Zorba ashtu edhe tek Ungaretti, konteksti historik, pati ndikim në botëkuptimin dhe tematikave të poezive. Ungaretti jetoi në periudhën në të cilën borgjezia, pasi arriti të ngrinte në Itali kapitalizmin, nuk arriti të çojë përpara idealet e drejtësisë e lirisë, por

⁵ Ismail Kadare, parathënie, në: Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, f. 171, 172

mbyllet në vetvete, në skepticizmin e humbjes së hegjemonisë së saj, ndaj ia beson zgjidhjen e kontradiktave shoqërore fillimisht kolonializmit dhe imperializmit e më pas luftës së dytë botërore e fashizmit. Përvoja e luftës është ajo që përcaktoi te poeti përkufizimin e brishtësisë e vetmisë se njeriut, por gjithashtu edhe spontanitetit dhe thjeshtësinë që gjendet në dhimbjen njerëzore. Pikëpamjet e Ungaretit për ekzistencën janë të dhimbshme, sepse ai mendon se njeriu nuk ka mundësi të konkretizojë pritshmëritë sociale e morale të tij. Ungareti, nuk beson në filozofinë e përfuturit të realitetit nëpërmjet arsyes, ndaj përpiqet që ta rrokë atë përmes poetikave të bazuara te analogjitë apo pranëvënia e imazheve racionalisht të largëta me njëra-tjetrën.

Kjo përvojë e konceptimit të realitetit, bën që Ungareti të refuzojë çdo formë metrike tradicionale: refuzon leksikun letrar dhe e zëvendëson atë me terma absurdë, të cilët i shndërron në letrarë, duke refuzuar rregullat gramatikore, sintaksore e teorike (si p.sh., eliminon shenjat e pikësimit, lidhëzën *si* tek analogjia etj.); krijon ritëm të lirshëm, me vargje të shpërbëra, të shkurtra, të rrufeshme, ku çdo fjalë e vetme ka një vlerë absolute.

Poetika është e fragmentarizuar. Në këndvështrimin e Ungaretit, poezia, duhet të jetë shprehje e një përvoje jashtëzakonisht të veçantë, përvojë e cila duhet jetuar maksimalisht në gjithë intensitetin e saj. Sipas tij, përzgjedhja e fjalëve të duhura në poezi, është një akt shumë i mundimshëm pasi njeriu duhet të çlirohet nga ideja që qëndron brenda dhe jashtë tij. Të njëjtat këndvështrime mbi njeriun pesimist i gjejmë të sendërtuara edhe te poezia e Zorbës. Nëse Ungareti mbyllet në vetvete si pasojë e kushteve socio-politike në të cilat gjendej Italia, po ashtu edhe Zef Zorba, kauzën e mbylljes në vetvete dhe shpërthimit në poezi hermetike e gjen te vendosja e sistemit totalitar në Shqipëri.

Ismail Kadare në parathënie shprehet se: "... ai, natyrë e ndjeshme poetike si rrallëkush, e kuptoi se rruga e vetme e tij në art nuk mund të ishte vetëm ajo e mbylljes në vetvete dhe e mënjanimit. Ndërkaq, ndonëse i tillë, ai u bëhet poet i kohës, në qoftë se do të pranojmë, siç

u tha më lart, se zona e heshtjes, ku ai dhe të tjerë si ai, krijonin art, ishte pjesë e rëndësishme e kohës⁶.

Për sa u përket pikëtakimeve të poezisë së Giuseppe Ungaretit dhe asaj të Zef Zorbës mund të pohojmë se gjenden shumë pikëtakime si në aspektin formal, në atë përmbajtjesor, po ashtu edhe në esencialitetin e poezisë së shkurtër.

Ndikimi i Zorbës prej hermetizmit

- Konceptet themelore dhe përkufizimi i hermetizmit

Termi *hermetizëm* është përdorur për herë të parë në vitin 1936 nga kritiku Francesco Flora në veprën *Poezia hermetike*. Termi u përdor me konotacione negative për të përcaktuar një lloj të ri poezie të lëvruar nga disa poetë të rinj fiorentinë, të cilët krijuan një poezi të mbyllur e të errët. Me kalimin e kohës, termi humbi konotacionin negativ dhe në ditët e sotme përcakton një prirje poetike të viteve '30 në Firence. Hermetizmi e vë theksin te "poezia e pastër", absolute, ekskluzivisht lirike dhe që përjashton diskutet logjike e ideologjike, të praktikuar nga të ashtuquajturit poetë modernë nga viti 1925-1935.

Hermetizmi vazhdoi të kishte produkte poetike deri në fillimin e viteve '50, por me rënien e fashizmit dhe me përfshirjen aktive në luftë të poetëve, hermetizmi pësoi një rënie të tij. Hermetizmi i ka rrënjët e tij në ideologjinë me të cilën identifikohet jeta dhe poezia. Jeta konceptohet si përvojë e brendshme shpirtërore dhe poezia konceptohet si "arsyeja e vetme e qenësisë sonë", i vetmi "dinjitet" i mundshëm i njeriut. Hermetikët kërkojnë të tutelojnë universin njerëzor duke sublimuar kërkimi mes pastërtisë shpirtërore të papërlyer nga ideologjizma politike apo racionale. Poezia hermetike dallon nga lloji i poezive të shkruara deri para viteve '30, në sajë të përdorimit të shpeshtë të simbolit. Ajo ndërtohet mbi bazën, jo vetëm të simbolit, por ajo vë theksin edhe tek ana formale e stilistike, në elipset analogjike, në devijime surrealistike dhe në korrespondencat tingullore dhe muzikore.

⁶ Ismail Kadare, parathënie, në: Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, f. 10

Grupi i poetëve hermetikë formon një shkollë të vërtetë, me një “gramatikë” të mirëpërcaktuar dhe me një regjistër të ndërtuar mbi bazën e mjeteve gjuhësore dhe formale.

- *Teknikat, gjuha dhe shenjat e pikësimit në poezinë hermetike*

Ekziston një “mënyrë” hermetike e të krijuarit të poezisë, të përcaktuar nga elementet e mëposhtme:

- përdorimin e shpeshtë të njëmbëdhjetërokëshit;
- abstraksione të imazheve, jo në aspektin konceptual, por “lirik”, me funksionin e vetëm për të fuqizuar vlerën e evokimit;
- kufizimi i fjalorit deri në përdorimin e fjalëve kyç;
- përdorimin e shumësit të papërcaktuar në vend të njëjësit;
- prishjen e qëllimshme të lidhjeve gramatikore me ato sintaksore.

Në këtë kontekst, mund të pohojmë se poetët hermetike synojnë që t’i kthejnë fjalës poetike gjithë vlerën e saj shprehëse, duke lartësuar “poezinë e pastër” që ndërtohet jashtë përmasave hapësinore dhe kohore, me qëllimin jo për të komunikuar, por për të evokuar. Poezia hermetike nuk është funksionale, ajo është e çliruar nga dëshira për të shprehur vlera apo për të edukuar, ose funksionon si e tillë vetëm në raport me vetveten.

Natyra evokative e poezisë realizohet nëpërmjet teknikës së analogjive, të cilat lidhen me imazhet poetike të çliuara nga racionalja e ideologjia. Në këtë kuadër, poezia shndërrohet në shprehjen më origjinale dhe të drejtpërdrejtë të aspekteve më të thella e misterioze të ndjeshmërisë së natyrës njerëzore. Përveç analogjive, karakterin e errët e të mbyllur, poezisë hermetike ia shton edhe përdorimi i metaforave dhe leksiku i përzgjedhur.

Përdorimi i këtij leksiku, kërkon sforco të mëdha interpretimi nga ana e lexuesit, por në të njëjtën kohë, rrezikon edhe mbylljen e poetit në vetvete, duke e bërë më introvert dhe duke e izoluar nga bota që e rrethon. Poetët hermetikë, ishin të ndërgjegjshëm për komunikimin me lexuesin, por shfrytëzuan këtë lloj poezie për të shprehur veten dhe pakënaqësitë ndaj retorikës fashiste.

- *Tipare të tjera të poezisë hermetike*

-Nuk pati rregulla, çdo eksponent i poezisë hermetike ka karakteristikat e tij estetike e formale të ndërtimit të poezisë, të cilat janë të ndryshme edhe radikale nga lëvruesit e tjerë të kësaj poezie.

- Letërsia shihet si një pasion original e total.

- Poezia shndërrohet në një përvojë që të çon te absolutja; ajo përcjell pastërti, esencialitet dhe pafajësi.

- Poezia bëhet e pavarur nga artet e tjera dhe shndërrohet në një përvojë njohëse e shpëtuese.

- Refuzon retorikën e D'Anunzios, impresionizmin dhe sentimentalizmin e Giovanni Pascolit.

- Përdor analogjitë, simbolin dhe lidhjet me objektet. Qëllimi i poezisë hermetike nuk është as të përshkruajë e as të përfaqësojë; poezia thjesht evokon. Nuk ka rëndësi receptimi i kuptueshmërisë së mesazhit, aktit poetik në vetvete.

- Dykuptimshmëria dhe errësira në poezi; refuzimi i metrikës dhe i sintaksës tradicionale; Poezia konceptohet si realizim shpirtëror i esencës së qenies njerëzore, e përqendruar në evokimin e botës së brendshme shpirtërore të zhgënjyer, së cilës i kundërvihet një botë ëndërrimtare më e mirë.

Poetët hermetikë nëpërmjet poezisë së tyre i drejtohen lexuesit të rafinuar dhe rreken të gjejnë një gjuhë të re e krejt origjinale poetike. Tekstet e poezive hermetike e refuzojnë kulturën e kohës së tyre, ato nuk kanë referenca historike apo sociale konkrete, por priren të universalizojnë abstrakten. Luan Topçiu do të shprehej për hermetizmin: "Hermetizmi dhe errësira janë realitete të poezisë aspak pezhorative, ndaj ngatërrimi i tyre do të na çonte në gabim. Ato duhet të vihen në lidhje me nocionin e hapjes së veprës letrare, nocion i futur në mënyrë eksplicite nga teoricieni i estetikës Umberto Eko. Është domethënës fakti që termi *hermetizëm* ka qenë i lidhur me poezinë moderne (me përjashtim të italianëve *l'ermetismo*), duke përdorur termin francez *obscurite*. Një sferë ontologjike strikte implikon poetika hermetike (me një vlerë afërsisht univoke), ndërkohë që errësimi i lirizmit modern përmes hapjes së pafundme

refuzon fiksimin ontologjik, duke lënë të lirë ambiguitetin... Përmes hermetizmit është kuptuar mendimi i fshehtë mbi botën dhe ekzistencën, ndërsa që të thuash tjetër rendi të botës, përmes figurash simbolike që eventualisht për t'u zbërthyer kanë nevojë për një çelës dekodifikues. Në këtë proces, vepra poetike e hapur dhe e errët provoko një transmetim polivalent, përmes karakterit plurivok të mesazheve që rrjedhin nga polisemia e gjuhës, në gjykimin e lirë të receptorit. Errësira e poezisë moderne ka gjasa të interpretohet *ad infinitum*⁷.

Në thelb, gjithsesi, hermetizmi është i mbyllur në planin e njohjes, kurse errësira është e hapur përmes pranimit të papërcaktueshmërisë. Më saktë, në hermetizmin poetik mesazhi i krijuesit është bazal, ndërsa në lirikën moderne të hapur, polivalenca e mesazheve i takon sajimit të interpretuesve që kuptojnë në mënyrë të diferencuar gjuhën poetike. Thënë ndryshe, konvencioni i veprës së hapur ka në bazë pikërisht këtë bashkëpunim të pakufizuar midis krijuesit dhe konsumatorit, apo midis autorit dhe receptuesit.

Hermetizmi presupozon një vizion të veçantë mbi botën dhe mbi rregullat e universit. Duke sugjeruar një shumësi kuptimesh, vepra e hapur bëhet ambigue dhe pranon ndihmesën krijuese të interpretuesit. Nga pikëpamja e "përmbajtjes" synon më shumë drejt simboleve origjinale, ndërkohë që poetika e hapur përdor në formë të lirë shenja nga mund të nxirren mesazhe jounivoke.

Bota poetike hermetike shihet si një mori simbolesh dhe elementesh stilistikore, që lidhen mes tyre në mënyrë komplekse. Detyra e poetit është pikërisht të zbulojë këtë lidhje mes elementeve. Kur pranëvihen elemente të përkundërta nga ana kuptimore, të cilat në kushte normale nuk do vendoseshin pranë njëri tjetrit, lindin frazat hermetike të cilat janë të errëta të dykuptimshme, pa një kuptim të qartë dhe për më tepër, të pakuptueshme.

⁷ Luan Topçiu, Leksione mbi hermetizmin në Departamentin e Italishtes, Tiranë 2012

Gjuha e përdorur është evokuese, plot analogji që lidhen mes tyre, me figura retorike dhe simbole: privilegohen imazhet e ëndrrës, të ankthit, të halucinacioneve, sepse vetëm duke jetuar në gjendje anormale e irracionale mund të kuptosh marrëdhënien e mirëfilltë mes gjërave. Hermetikët ndihen larg nga jeta sociale, ata krijojnë poezi të ngarkuara simbolikisht dhe me një gjuhë tejet të vështirë për t'u deshifruar menjëherë. Hermetikët iu kundërvunë dekadentizmit të D'Anunzios dhe melankolizmit të Pascalit i cili u gjykua si shumë subjektiv e pak universal. Hermetizmi iu kundërvu gjithashtu edhe futuristëve, pasi e konsideronin tepër retorike. Frymëzimin me të madh poezia hermetike e pati nga dekadentizmi francez, kryesisht në përdorimin e korrespondencave dhe vlerës së poezisë në vetvete, e cila shndërrohet në një mjet vetënjuhjeje.

Poezia hermetike lartëson fjalën të cilën e ngarkon me kuptime dhe teknikisht priret të shfrytëzojë kapacitetin evokativ të fjalës. Për sa i takon figuracionit, similituda zëvendësohet me analogjinë e cila favorizon shumëkuptimshmërinë e vargut e të fjalës. Karakteristikë origjinale e poezisë hermetike është përdorimi i shumtë i metaforave, shpesh herë të vështira për t'u kuptuar apo interpretuar dhe mbi të gjitha, vulën e origjinalitetit e mban edhe loja e imazheve. Metrikisht, ka një prirje të përdorimit të metrit tradicional, njëmbëdhjetërrrokëshit.

Teknikat e hermetizmit përthyer te Zorba

- *Shmangia e përdorimit të nyjave:*

Te poetët hermetikë spikat vargu konciz, pa nyje, të cilat mund të kenë si funksion zgjerimin e argumentit për të cilin po flitet, apo mund të zgjasë më shumë vargun. Nëse do ta konkretizonim me poezinë e Zorbës, mund të sjellim, si shembull, poezinë *Rrugët në vjeshtë*:

*ndër pragje dyersh
Shtëllunga gjethesh ...*

- Përdorimi i fjalëve me kuptim abstrakt:

Nuk i japin rëndësi lidhjeve sintaksore me strukturën logjike të asaj çka shkruhet. Mund ta konkretizojmë me poezinë *Tema e fagotit*:

*Prap më gërgasin
Si fikja
Pak e nga pak
E monotone
E acidit ribonukleik*

- Analogjia dhe shenjat e pikësimit

Analogjia është një figurë letrare e ngjashme me krahasimin, por në të cilën shmanget përdorimi i lidhëzës krahasuese *si*. Sipas hermetikëve, përdorimi i analogjisë çliron fjalën poetike e cila, fuqizohet nga renditja e vargjeve njëri pas tjetrit në vazhdimësi pa përdorimin e shenjave të pikësimit. Në vëllimin poetik të Zef Zorbës, mund të përmendim poezinë *Kruja*:

*Gjerdan margaritarësh
Mbi gjoksin tënd
t'irnuar*

Ata që hodhën themelet e hermetizmit në Itali, e që arritën me anë të veprave të tyre të krijojnë një lloj poezie, e cila nuk kishte ekzistuar më parë në Itali, si nga pikëpamja formale ashtu edhe nga ajo kompozicionale e strukturore, ishin: Eugenio Montale, Salvatore Quasimodo dhe Giuseppe Ungareti – poetë nga të cilët, Zef Zorba ka shumë pikëtakime, gjë të cilën e përmend dhe e pohon edhe në pasthënie.

Marrëdhënia me tjetrin***Ndikimet e Zef Zorbës nga Giuseppe Ungareti***

-Poezitë e Ungaretit, ashtu si edhe një pjesë e poezive të Zorbës janë të shkurtra. P.sh.: Poezia *Ndriçohem pafundësisht*⁸ e Ungaretit, poezia më e shkurtër e tij, përbëhet nga dy vargje e dy fjalë, poezi të ngjashme gjejmë te Zef Zorba, poezi me tri vargje.

⁸ Titulli original *Mi illumino d'imenso*, përkthimi është përshtatur nga unë.

-Një pikëtakim tjetër i rëndësishëm mes Ungaretit e Zorbës është sensi i dhimbjes së poetit (dhimbja dhe mungesa e shenjave të pikësimit vihet re te disa poezi të Zorbës).

-Në fakt, poezitë e Ungaretit janë shumë të trishtuara, duke qenë se janë frymëzuar nga lufta e dytë botërore; po ashtu janë edhe poezitë e Zorbës, duke qenë se janë frymëzuar nga mungesa e lirisë gjatë diktaturës komuniste.

Këtë tipar te Zorba, e gjejmë të konkretizuar te poezia *Hej, zemërplasura*:

*Shuhet me rrahje të rralla, të mekura
kënga kujtuese e kumboneve e
mbyllet me gazin qestí të vajzave
mbetë zemërplasura.*

*Sepse nuk ka kuptim me vdekë
Qind herë në ditë"*

Ndërsa te Ungareti:

*... Ndihej i mënjanuar mes njerëzve
Por për ta ndjej keqardhje ...*

-Përdorimi i fjalëve-kyçe, fjalë emblematike, simbole të pafajësisë.

Ungareti përdor shpesh fjalën *ishull*, sidomos te përmbledhja *Ndjenja e kohës*, në të cilën ishulli është një vend i cili ekziston jashtë kohe, është një shumësi ëndrrash dhe realitetesh ndërsa

Zef Zorba përzgjedh ndër të tjera, si fjalë-kyçe, fjalën *fëmijë*, të cilën e gjejmë te disa poezi si retrospektivë e lirisë absolute të njeriut:

Ballkoni (i shtëpisë së vjetër):

*"... e mbledh si zgjua
Këngë e vaj me shpresë
Për ditët që do t'vikan,*

e gazin e fëmijëve të dliërë

*që motet përpara gjurmojmë
me sytë e mëdhenj e boj-qiell.
Çudi!*

Filizin e njomë"

Në poezinë e sipër përmendur fëmijët i sjellin ndër mend poetit dëlirësinë dhe shpresën. Poeti pranë të kaluarën me të tashmen dhe çuditet se si ato janë antipode të njëra-tjetrës.

Mbas varrimit:

*Shiu s'po pushon sot nadje.
Dy djem të fillores,
Sytë duke picërruar lexojmë
Në shtyllë të telefonit në udha-kryq
Letrën me anë të zeza.*

*Uuu ...! ai plaku...
(çon trinën e dorës nen hundë më i madhi)*

*Buzëmbërëja a hëna e plotë e
Shkëlqen e pa-marre.
Kalojnë nën Ballkan
e gazin që i plasë*

Përsëri, dy djemtë (fëmijët), janë personifikim i pafajësisë e spontanitetit.

Zalli i Kirit:

*Zallet e bardha pa dritë
ku Natën zbresin yje
me mijra
pa u ndi*

*Mbase janë sytë,ve
që vdiqën në habi*

Si zogj dallëndysheje

*Tash muzgu sa me vrap
Qullosë rrugën time;
(telat e dritës diku janë çartë)*

*Prej trurit trishtimi
Shkumëzon e shprazet
Në gjymtyrët e këputura*

Heq këmbën zvarrë

*Si zogj dallëndysheje,
Fëmi të lagjes
Më shkasin anash
Plot shend-e verë"*

Shtëpizat

*"Për njëra-tjetrën strukur
Shtëpizat,
Të dala boje përkulen,
Mërdhasin
me sy të ngulitur në horizont*

është qielli plot pranverë.

*Unë s'druaj
Edhe po të më priret prej hallesh
një brengë.*

*(Mos ndoshta kjo erë
Ma zgjon falisur
Për reshje përtëritëse?*

*Kesh të bëhemi fëmi
Edhe një herë!)*

Ashtu si te poezitë pararendëse në të cilat përdoret fjala *fëmijë*, edhe tek kjo poezi fëmijët janë burim lumturie në retrospektivë dhe nostalgji për ato gjendje shpirtërore ekzaltuese, të cilat i përkasin një kohe që s'është më.

Sa mirë, atëherë...

*"Sa mirë, atëherë, o mite, kur isha fëmi;
I lodhur prej lodrimesh gjithë ditën,
Nën hije të një shelgu bija këputur gjumi;
Ëndrra*

*Gjithfarë, plot ndriçime, i pezmatuar
tash vetëm ndrydhi, e nata, e ditës lubi,
shpirtin ndër helme përkundë,
e arsyerja brehet*

pa nda, e bren.

E në agim shiroku,

*një mbas një, sy lotues ngulitë mbi xhame;
bie ora pesë; unë kryqin mbaj në krah
e me pak frymë fillohem për Kalvar.*

*Eci. Dhe me ngadalë e lehtë një këngë sajohet
ndër dej: "ad adiuvandum me festina"*

e këmba përmbi baltë len gjurmë të thella.

Edhe te kjo poezi, Zorba bëhet nostalgjik për fëmijërinë dhe e transmeton këtë fuqishëm nëpërmjet shprehjeve frazeologjike.

Fjala *shi*. Përveç fjalës "*fëmijë*" që shpreh nostalgjinë e poetit ndaj ngazëllimit të munguar, një tjetër fjalë që gjen përdorim të shpeshtë është edhe fjala "*shi*".

Një nga simbolet që paraqet zymtësinë e rëndë, errësirën, mjerimin e jetës nën diktaturë, peshën e zezë të politikës, është shiu. Ai është kryefjala e fjalëve më kyçe të poezisë. Por ai është gjithashtu, [lirues i kujtimeve të shpirtrave.

"Natën, kur bie shi ..." është një poezi ku përvijohen këtu, në strofa të veçanta: Njeriu i Nedertalit, Diogjeni, Kolombi, Betoveni, Ainshtajni, dhe në strofën e fundit, poetët Ungareti, Kuazimodo dhe Montale. Çdo strofë fillon dhe mbaron me dy vargjet që simbolizojnë vështirësitë e jetës.

Te Zorba, ai është i mbushur me musht universal. Universalizmi, së tepërmi, e karakterizon poezinë e Zorbës për të plazmuar vizione meditative, kryesisht, metafizike. Ndër të tjera, ka dy strofa shumë të ngjashme, në të cilat vihet re edhe përdorimi i kllapave për specifikim të kohës kur është shkruar poezia.

Ndikimet e Zorbës nga Salvatore Quasimodo

Përveç Ungaretit, poezia e Zorbës, ka pikëtakime me një hermetik tjetër, siç është Salvatore Quasimodo. Zorba, ashtu si Quasimodo:

Ngre çështje të ekzistencës së njeriut, si p.sh., në poezinë:

"Secili rri në zemër të tokës,

I depërtuar nga një rreze dielli

dhe menjëherë vjen nata (Quasimodo)

Dhe pezull varen

Ne tehun e një rrezeje

qëniet e këputura" (Zorba)

Këto poezi janë të ngjashme si në formë ashtu edhe në përmbajtje, pasi të dyja janë parabola e ekzistencës së njeriut, i cili ka ngelur pezull përballë jetës së tij me pamundësinë për të ndryshuar gjendjen.

Nën titullin e poezisë *Qokthi*, poeti ka vënë dy vargje të Salvatore Quasimodo-s: *"... il mio cuore, / sospeso nel buio, una voce"* (*"... zemra ime, / e varur në errësirë, një zë"*), fjalë të cilat, ai shpreh gjendjen e

njeriut në diktaturë. Poezia është rruga e tij e shpëtimit tek e cila sendërton dhimbjen dhe në të njëjtën kohë bukurinë e jetës.

Fjala

Vetëtimë.

E zbret fulikare

Fjala që vret mu në shpirt.

Më e bukur se jeta vetë

Oh ...

Të dy janë poetë pesimistë, të cilët nuk i “këndojnë” jetës në mënyrë të drejtpërdrejtë, por nëpërmjet kujtimeve të njerëzve të afërm, njerëzve të vendit të tyre, lartësojnë gëzimet e saj, gëzime të cilat poetit i mungojnë.

Ndikimet e Zorbës nga Eugenio Montale dhe Tomas Eliot

Poet tjetër hermetik, me të cilin pati pikëtakime Zef Zorba, është edhe Eugenio Montale. Të dy këta poetë, përveç dashurisë për poezinë hermetike, patën interes e pasion të veçantë për muzikën, ndaj te të dy vërehet prirja për t’i dhënë muzikalitet vargut.

Prania e objekteve, imazheve të cilat shprehin gjendjet emocionale të poetit, teknikë kjo e cila është teori e ngritur nga Tomas Eliot-i, por që është një element kyç i rrymës së hermetizmit.

Rikthimi të fëmijëria për të lartësuar çastet e lumturisë, të cilave iu pranëvenë realitetin e hidhur (edhe kjo temë që u përdor gjerësisht nga hermetikët). Pikëtakime në planin formal dhe përmbajtësor të poezisë, Zef Zorba pati edhe me poetë francezë e anglezë, por kryesisht me Tomas Eliot.

Principi themelor që krijoi Tomas Eliot dhe që më vonë u shndërrua në një ndër karakteristikat kyçe të hermetizmit, *ishte mënyra e komunikimit të poetit me lexuesin*.

Poeti nuk komunikon “drejtpërdrejt” me lexuesin, ai nuk është lehtësisht i receptueshëm nga lexuesi, por zgjedh një formë krejtësisht të re komunikimi, duke krijuar korrelacione objektive: pra, poeti në vend që të tregojë atë që ndien dhe mendon, tregon objekte apo tërësi

Thirrja e poetëve klasikë dhe thellimi i mendimit në vargun pararendës apo pasues mes kllapash, është gjithashtu ndikim nga poezia e Tomas Eliot-it.

Në këtë poemë, poeti thërret persona të ndryshëm, si: Dante Aligeri, Charles Dickens, Baudlaire, Ovidi etj. Të njëjtën teknikë e shohim edhe te *Buzë të ngrira në gaz*, ku Zorba thërret Horacin, Safon, Montalen dhe Oscar Wilde. Siç vihet re, Zorba, ashtu si edhe Elioti,

nuk thërret vetëm poetët e antikitetit, por edhe “Virgjin” e tij poetik, Montalen.

Yves Chevrel, në *Letërsi e krahasuar*, ka bërë një analizë të hollësishme mbi poetikat krahasuese, ku shprehet se:

... *vepra është një art fakt i prodhuar prej një autori, nga i cili shkëputet teksti, që është tërësi shenjash që prodhojnë një kuptim.*

... *Në gjithë ecurinë e intertekstualitetit është fare e rrallë, madje, ndoshta, përjashtohet krejt mundësia që secili prej teksteve të merret me tërësinë e tij*⁹.

Në këtë kontekst, do të ishte me interes një përjasje e raporteve intertekstuale të poezisë së Zorbës me poezinë e Tomas Eliot-it. Këtë e gjejmë të konkretizuar te poezia *Raki e lirika*, ku shihet qartazi që marrëdhëniet intertekstuale janë të ngjashme me ato të *Toka e shkretë*, të T. Eliot-it.

Fragmentarizimi i Zorbës ecën “krahë për krahë” me ritmin e mendimit, ashtu si edhe te poema *Tokë e shkretë* e Eliotit. Figuracioni artistik: prania e aliteracionit, shtjellimit të idesë në kllapa, reticenca, pasthirrma, onomatopeja dhe aliteracioni.

Originaliteti në poezi

Gjatë trajtimit të çështjes së origjinalitetit të poezisë së Zorbës, më lindën natyrshëm disa pyetje në lidhje me faktorët që përcaktojnë origjinalitetin në një poezi dhe se ku duhet kuptuar ky thelb artistik. Mos vallë duhet kuptuar në marrëdhënien që ndërton vepra me lexuesin? Në marrëdhënien e tekstit me sistemin letrar ekzistues, me universalizimin e fenomeneve apo thjesht në aspektin formal të poezisë?

Për t’iu dhënë përgjigje të gjitha këtyre pyetjeve, duhet të hulumtojmë në rrënjët e universalizmit të poezisë, universalitet i cili lidhet me kohën personale në procesin e krijimit. Nëse origjinalitetin e poezisë do ta studionim në rrafshin e kohës tradicionale, do të pohonim që poezia është origjinale kur ajo nuk bëhet njësh me traditën letrare, por elaboron forma të reja letrare komunikuese me

⁹ Yves Chevrel, *Letërsi e krahasuar*, f. 123, 124, “Alpin”, 2002

lexuesin. Nëse origjinalitetin e poezisë do ta shihnim në raportet që krijon ajo me traditën letrare dhe sistemin ekzistues letrar, atëherë do të arrinim në përfundimin që kjo lidhje me traditën dhe me përvojën, krijon një lloj standardizimi, i cili e shndërron në domosdoshmëri hyrjen në sistemin e vlerave, sistem në të cilin secili poet origjinal spikat me unin e tij krijues.

Në këtë skemë analizuese të përcaktimit të origjinalitetit në vepër dhe në krijues, do të mbështetemi për të analizuar veprën e Zorbës dhe individualitetin krijues të tij. Do të shohim; a është pasues i traditës letrare të deriatëhershme, a arrin organikisht të shkëputet nga e përgjithshmja tek e veçanta dhe cilat janë mjetet stilistikore me anë të të cilave kristalizon individualitetin e tij krijues për të cilin Sabri Hamiti do të shprehej se zbulimi i *Buzë të ngrira në gaz* është një hyrje në zgjidhjen e enigmës së poezisë moderne shqipe, e cila është një zgjedhje e enigmës së autorit që zgjat gjysmëshekulli.

Originaliteti te Zef Zorba

Në pasthënien, me të cilën poeti ka dhënë sqarime për poezinë e tij, thuhet: “Ku më pak e ku më shumë këto punime janë mbarsur nga ironia, madje edhe nga autoironia, por që mjerisht, pa dëshirën time, ka shkarë ndonjëherë në sarkazëm. S’kam pasë fare të bëj: ashtu ka ardhë. Por dua që këto tipare të mos interpretohen si pesimizëm: Nëse duken si të tilla fajin e ka aftësia ime e kufizuar e jo vetëdija”¹⁰.

Këto sqarime sendërtohen më së miri në vargjet:

O jetë!

Edhe në zgrip,

Shtegëtarët e tu,

Gjithnjë të dashurojnë.

Në këtë punim kemi folur për veçantinë e poezisë që solli Zorba dhe ndikimet e dukshme që pati poezia e tij nga ajo e huaj. Zorba, si admirues dhe praktikues i hermetizmit, pati ndikime të mëdha nga

¹⁰ Ismail Kadare, parathënie, në: Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, f. 173

hermetikët italianë, por edhe nga poetë modernë europianë e amerikanë, përmendim këtu Tomas Eliot.

Në ciklet poetike të *Buzë të ngrira në gaz*, nga analiza që i kam bërë tematikave të çdo poezie, mund të pohoj se mbizotërojnë vëzhgimet meditative për vdekjen, jetën, fëmijërinë, ekzistencializmin, përsiatjet poetike për gjendjen e ankthshme të të jetuarit nën diktaturë, por edhe trajtimin e temave më pak meditative. Në një pjesë të mirë të poezive janë trajtuar tablo nga jeta e përditshme, tablo që hera herës përcillen te lexuesi nëpërmjet ironisë dhe kuptimeve metafizike. Shkollimi i tij jashtë Shqipërisë, e familjarizoi me parime të estetikës e filozofisë moderne të cilat ndihen në një pjesë të mirë të poezive të tij. Një nga faktorët që ka ndikuar në hermetizmin e tij, ka qenë dhe njohja e gjerë muzikore e cila u sendërtua në fugat e sonetet të cilat për t'u përtypur, siç duhet nga lexuesi, kërkojnë një formim të zgjeruar dhe përgatitje intelektuale të veçantë në njohjen e këtyre përbërësve të poezisë së tij.

Në pranëvënien me poetë nga të cilët u formua personalitë prej poeti i Zorbës, kemi përmendur disa teknika estetike e kompozicionale të huazuara nga poetët italianë e anglezë, si:

- **Ndërthurjen e poezisë me muzikën, ndërthurje e cila nuk kishte ardhur ndonjëherë në formën në të cilën na e përcolli Zef Zorba**, njohës i mirë i poezisë hermetike, poezisë moderne evropiane e amerikane dhe muzikës, ndaj edhe eksperimentoi për t'i shkrirë me njëra-tjetrën apo për t'i vënë në funksion të njëra-tjetrës. Teknikën e ndërthurjes së muzikës me poezinë e gjejmë edhe te pararendës të Zorbës, si: Fan Noli, Lasgush Poradeci dhe Gjergj Fishta, por ata e kanë përdorur muzikalitetin e vargut si një element të formës, e cila arrihet nëpërmjet përzgjedhjes së tingujve, rimave e kadencave. Ndërsa te Zorba, muzikaliteti poetik nuk është thjesht formë, ai është edhe përmbajtje, siç do të shprehej vetë Zorba në pasthënie: "Për unjimin muzikal është kërkuar jo vetëm ritmi i qenësishëm në fjalët dhe në vargjet, por edhe tentativa e riprodhimit të formave muzikore:

fugat, fugatot, sonata me tempot, kadencat etj¹¹.” Të kësaj natyre është cikli poetik “Fugat e fundit” po dhe poema *Mbresat e rrugëve*. Në “Fugat e fundit” kemi të bëjmë me pesë poezi, të titulluara me terma të formave muzikore, dy prej të cilave kanë edhe nga një nëntitull: *Allegro*, *Andante mosso*, *Lento* (për çdo 10 qershor), *Largo* dhe *Allegro furioso* (*canzonetta*). Në rrafsh gjuhësor, fjala *fugë* ka kuptimin e ikjes, arratisjes, veprimin e të ikurit nga një vend, largimit nga rrethana të ndryshme etj., ndërsa në teorinë e praktikën muzikore, fuga është forma më komplekse e kompozimeve muzikore, që zhvillon disa tema, në funksion të një teme gjeneruese. I tillë është ky cikël poetik. Rreth një teme qendrore, që është amullia e hirtë e përditshmërisë, në “Fugat e fundit” zbulohet një tematikë e larmishme me plot meditacione filozofike.

- Fragmetarizimi i poezive të cilat i ndeshim dukshëm te poezitë e Tomas Eliotit, sidomos në fugat, të cilat simbolizojnë edhe arratinë e poetit nga realiteti i hidhur.

- Intertekstualiteti, i cili paraqet tekstin që është në raport me tekste të tjera; paraqet njëfarë modeli nëpërmjet të cilit formësohet një tekst i ri, të cilin kritika moderne e konsideron intertekstin shumë të rëndësishëm, për shkak se plotëson tezën se një tekst u ka më shumë borxhe teksteve të tjera se sa realitetit, që e përshkruan ose që e rrëfen.

- Ndërtime kompozicionale dhe figuracion që është tipik për poetët hermetikë, si: shmangia e përdorimit të nyjave të cilat e bëjnë ligjërimin poetik më sugjestionues e i japin poezisë hermetike karakterin e kufizuar në fjalë.

- Përdorimi i fjalëve kyç-simbol rreth të cilave enden një pjesë e mirë e poezive të tij: Kemi përmendur më sipër fjalën “fëmijë” e “shi”, ku fjala fëmijë evokon të kaluarën ngazëllyese dhe fjala “shi” të tashmen e errët e te zymtë, errësirën e shpirtit si pasojë e mbylljes në vetvete.

- Përdorimi i imazhit që evokon objektin, karakteristikë kyç e ndërtimit të poezisë hermetike. Përpos admirimit për hermetikët,

¹¹ Ismail Kadare, parathënie, në: Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, f. 173

Zorba ka përcjellë origjinalitet në dhënien e emocioneve dhe të përfytyrimeve vetjake. Origjinalitetin e tij, “shpëtimin prej grackës së hermetikëve”, siç e quan ai, e ka arritur nëpërmjet “analizës kritike të botës individuale, të rrethanave, të kushteve të ekzistencës, të aspiratave dhe të idealeve, sidomos kundërshtimet e botëkuptimet personale, që edhe mund të paraqesin afri sensitive me këdo tjetër, por jo unjism filozofik e ideor”.

Një burim tjetër shpëtimi nga ajo grackë është jetësuar në rrafshin leksikor: “shpuplimi dhe ushqimi i vazhdueshëm me leksikun dhe idiomat tona (të traditës dhe ato që bota krijon çdo ditë)”, ka shkruar ai po aty. Në këtë kontekst është me vlerë të pohojmë që Zorba, ligjërimit sintetik, eliptik, intensiv e të errët, ligjërimit që ndricon elementet afektive e ndjenjësore, e realizon nëpërmjet fjalorit të pasur, i cili pasurohet nga shpluhurosja e fjalëve të rralla e arkaike.

Këto fjalë përdoren për të shprehur gjendje a veprime apo edhe për të cilësuar objekte të ndryshme. Edhe në rrethin më të ngushtë të leksemave që përdor më shpesh, ai nuk i shmanget kësaj rruge. Të tilla janë: rrokoll-e, zhig, zalle, qull-e, qyqe, qyqar, lëmuç etj.

Një tjetër element i rëndësishëm për të shprehur botën e brendshme të poetit, janë edhe përdorimi i disonancave, karakteristikë të cilën e hasim dhe tek Eugenio Montale. Këtë efekt, ai e krijon duke përdorur shprehje frazeologjike popullore, të folklorit, pothuajse të harruara, në të cilat përsëriten tinguj të njëjtë që në pozicionet përkatëse shqiptohen me vështirësi:

“Në jerevinë e ngarravaçuar të druvarit”, “Janë po ato rrenime shpirti, të rrokuara në zgrip”, “E mbetën ashtu lmuç të laskaruar”, “E nyjça krahë/ të lacaruar”. Është pikërisht shpalosja e individuale në mënyrë krejt të veçantë që përbëjnë origjinalitetin e veprës së Zorbës.

Sabri Hamiti tek *Albanizma*, thekson se: “... Poezia lind, duket, pas vdekjes, ajo është e përjetshme... këtë e dëshmon pasthënia e cila nuk është vetëm tekst reference mbi përvojën personale e krijuese, por edhe shpalim teknik i artit poetik, një përkufizim i modernizmit e

modernitetit poetik shqiptar, duke prekur edhe referencat e autorëve të huaj, duke pranuar mësimet e mbi të gjitha gabimet¹²...".

Në këtë kontekst, te poezia e Sabri Hamitit vihen re teknikat e hermetizmit e kryesisht të hermetikëve, si: Montale, Ungareti e Quasimodo, vihet re fragmentizmi i Eliotit, vihet re errësira e poezisë së Bodlerit, por të gjitha këto realizohen me një subjektivizëm të autorit dhe me një forcë të madhe shprehëse.

Hermetizmi e ndihmon poetin të krijojë trajta të shkrimit poetik, me qëllim shpalosjen e esencialitetit të shprehjes e të kuptimit. Sintetizmi poetik është më i dukshëm e më i përdorur në poezitë e shkurtra, por është pikërisht ky esencialitet që formëson edhe fragmentarizmin e poezisë, i cili, është në sintoni me mendimin poetik. Këtë teknikë e shohim të konkretizuar te:

*Mëngjesesh të hirta murlani
Hardhitë gungaçe përqeshë
M'anë të zallit t'Kirit.*

Një figurë letrare e përdorur me frekuencë të lartë në poezinë e Zef Zorbës është paralelizmi, i cili zbulon unin poetik, hyn thellë në individualen dhe personalen e poetit, duke përfunduar me ironi për vetveten siç vihet re në poezinë *Sonte feste*:

*Sonte festë: shi me shtrëngatë,
bubullimë e erë leshjane.
(Hënë nuk ka)*

*Mbi çimento para meje
Rrahin pikat me furi,
thyhet breshëri porsi kripa;
o çimento, si unë si ti".*

Poeti pranë fortësinë e çimentos e të breshrit me "ëmbëlsinë" e një dite feste. Ky paralelizëm e njëkohësisht fragmentarizim të kujton sa

¹² Sabri Hamiti, *Albanizma*, f. 156, Akademia e Shkencave dhe Arteve, Prishtinë, 2009

*Të mos na qasej papritur ai çifti
i huaj, i atyre që fotografonin
majat. Na erdhën pranë e po na lutnin:
"Can we join in your table?"*

Ajo që të bie në sy te poezitë në të cilat kemi shpërthime individuale të poetit është aftësia dhe mënyra e qasjes së poetit te e brendshmja e tij, teknikë të cilën e realizon nëpërmjet kalimit nga përshkrimet e jashtme te universi i tij ndjenjësor i tronditur dhe i trazuar. Një ndër krijimet poetike më domethënëse të vëllimit *Buzë të ngrira në gaz*, është edhe balada *Raki e Lirika*, në të cilën poeti shpalos paralelisht vetveten dhe realitetin. Metaforikisht poeti parapëlqen të arratiset me ndihmën e poezisë, për të fituar lirinë sublime, oksigjenin e motivimit të tij për të jetuar në një realitet krejt të ndryshëm për nivelin e tij intelektual dhe pritshmërive për jetën. Autori ulet në një tavolinë në cep (a thua se nëpërmjet kësaj poezia na jep koordinatat reale të gjendjes së tij në raport me realitetin, i mënjanuar e i veçuar) dhe bashkë me mikun e tij, ai ndjen nevojën për dy raki të cilat do të jenë gjeneza e dy lirikave e ato do të zbresin mes tyre shumë yje. Me anë të paralelizmave e simbolit, poeti nis një udhëtim imagjinar drejt vetes për të shpërthyer emocionalisht duke përdorur edhe shpluhurosjen e leksikut të vjetër duke i dhënë vlerë vargut. Nëse do të bënim një analizë të poezisë *Raki e lirika*, për të nënvizuar çështje të origjinalitetit të Zef Zorbës do të pohonim që gjatë "rrëfimit të vetvetes", spikasin:

- Leksiku, shprehjet frazeologjike dhe idiomat shqipe, e cila ndodh edhe në përcaktimet që poeti i bën kamerieres, duke e etiketuar si; *laraske, qyqe* etj.

- Rimarrja e teknikës së vargut me muzikalitet, por ndryshe nga pararendësit, muzikaliteti nuk është vetëm i jashtëm e formalisht, por arrin unitete tingullore, duke e shndërruar veten në element të brendshëm që i jep ngjyra vargut.

- Personalizimi i fragmentarizmit, i cili huazohet edhe nga hermetikët edhe nga Tomas Eliot, dhe nuk "klonohet" në poezinë e

tij, por vendoset në funksion të shpërthimeve të unit poetik e të shpalosjes së botës shpirtërore duke ecur paralelisht me njëri-tjetrin.

Zef Zorba do të shprehej se nuk do të donte kurrësi të ishte i njëjtë me hermetikët, ndaj kjo dëshirë e tij për të qenë original, konkretizohet në vepër në saj të orvatjes së poetit, për të krijuar një përfytyrim të vetvetes, shprehjen emocionale të skutave më të errëta të së ndërgjëgjshmes e të së pandërgjëgjshmes së tij, këndvështrimet e botëkuptimet individuale. Të gjitha elementet e sipërpërmendura janë reflektime apo të afërta me hermetikët, apo Eliotin, në aspektin filozofik, por është gjeneza, burimi i shprehjes dhe personalizimi i tyre, që e dallojnë poetin nga “Virgjlët” e tij të frymëzimit poetik.

Për sa thamë më sipër, edhe lexuesit të sotshëm i kërkohet një nivel i ngritur intelektual për ta receiptuar drejt, e për ta rrokur shterueshëm veprën e Zorbës në të gjithë shpalosjen shpirtërore e intelektuale të poetit, në mungesë të kësaj përgatitje intelektuale do të ishte e pamundur receiptimi tërësor i veprës. Në këtë kontekst shtrohet natyrshëm pyetja:

Sa origjinale dhe ndikuese ka qenë vepra e Zef Zorbës për receiptuesin bashkëkohor?

Kështu, vepra e Zorbës na nxit të ngremë disa pyetje në lidhje me shkallën dhe intensitetin e rrokjes së veprës në gjithë tërësinë nga receiptuesi bashkëkohës. Nëse përcaktimin e origjinalitetit të poezisë së Zorbës do të përqendroheshim te komunikimi i tekstit me lexuesin, mund të pohojmë që ai krijon vështirësi për t’u receiptuar intensivisht dhe plotësisht nga lexuesi i zakonshëm.

Vëllimi *Buzë të ngrira në gaz* na nxit, gjithashtu, të shtrojmë edhe disa pyetje të tjera në lidhje me kontekstin historiko-social në të cilën është shkruar vepra, të cilat janë:

- *A ekziston një lidhje organike mes kontekstit historiko-social dhe veprës?*

- *A është koha produkt i veprës apo vepra produkt i kohës?*

- *A ka lidhje organike të brendshme mes veprës dhe sistemit letrar bashkëkohës?*

Duhet të ekzistojnë lidhje organike me kontekstin, faktorët historikë, bashkëkohësinë etj. Teksti letrar, për shkak të ndërlidhjes së domosdoshme me kontekstin, asnjëherë nuk është plotësisht autonom, as i mbyllur në vetvete, as nuk i mjafton vetvetja – pasi një letërsi “egoiste”, do humbiste thelbin e çdo teksti të vlerësuar si letërsi; atë të komunikimit masiv me receptuesin për ta njohur me vlerat dhe universalitetin e saj. Ai gjithnjë është pjesë e një tërësie: së pari, i letërsisë dhe i sistemit të saj të formave, llojeve etj. Më pastaj i vetë kulturës, si jetë e përbashkët shpirtërore e një kohe apo populli dhe i shoqërisë, si hapësirë ku rrjedh jeta e njeriut dhe ku tekstet letrare dhe artistike luajnë një rol kyç. Te Zef Zorba, nëpërmjet *Buzë të ngrira në gaz*, shohim një intelektual të veçantë, një njohës dhe admirues të hermetizmit, apo Eliotit, një njohës dhe admirues të poezisë fjalëpakë dhe eliptike, por mungesën e universalizimit të fenomeneve për t’u receptuar njëlloj nga lexuesi bashkëkohës i tij.

Spontaniteti i vargut është terreni që ai përgatit për të shtrirë fjalën e tij e cila jo vetëm që ndihet e lirë në poezinë e tij por nis e “këndon” në sajë të muzikalitetit si strukturë e brendshme të gjithë vëllimit poetik. Kështu, Zorba arrin që nëpërmjet çlirimit të fjalës në poezi, të luajë me vargun e melodinë, të bashkojë dy arte thellësisht komunikative në mënyrë të drejtpërdrejtë siç janë: poezia dhe muzika. Të paktën Zorba arrin të komunikojë me veten e tij e në saje të kësaj zbrazeje të unit të tij poetik, të komunikojë me lexuesin, paçka se vepra e tij nuk do të mbërrinte menjëherë në duart e lexuesve.

Nga sa thamë më sipër, në lidhje me formacionin poetik të Zorbës, me shijen estetike kundrejt hermetizmit, me adhurimin dhe me ndikimet nga Qusimodo, Montale, Ungaretti dhe Elioti, nëpërmjet spontanitetit të fjalës, Zorba bëhet një alternativë e hermetizmit në Shqipëri.

Poetët e sipërpërmendur janë ura lidhëse për të bërë një kalim organik drejt hermetizmit, gjë që e realizon nëpërmjet fjalës së lëshuar “fulikare”, duke ripërtërirë e shpluhurosur leksik te folklorit. Është pikërisht mjeshtria e përdorimit të fjalës ajo që i jep hermetizmit të

Zorbës kuptim ekzistencial (tematikë kjo e përdorur rëndom nga ekzistencialistë si Kafka apo Bodler), temë e guximshme kjo nëse kemi parasysh kontekstin historik.

Ekzistencializmi i Zorbës vjen nga të jetuarit në një kohë ku “e pathëna” ngadhënjën mbi fjalën, në një kohë kur poetit i duhet të fshihet prej vetvetes për të mos iu kundërvënë haptazi regjimit komunist, e nëse poetit i “mek” fjalën atëherë tronditet thellë ekzistencializmi i tij. Hermetizmi i Zorbës ka gjithashtu edhe karakter profetik pasi ai arrin që të projektojë një të ardhme e cila shpejt do të ishte realiteti që i duhet fjalës së lirë.

Ndoshta profetizmi i tij e ka zanafillën në dëshirën e ngutur që ky realitet të vijë sa më shpejt, ndoshta e ka të pranëvënja e shoqërive të tjera evropiane të cilat i njihte shumë mirë përmes poezive të bashkëkohësve të tij në Evropë e më gjerë.

Në gjithë vëllimin poetik *Buzë të ngrira në gaz*, Zef Zorba shfaqet si bartës i njohurive nga fusha biblike e ungjillore, antropologjisë kulturore, etnografike e folklorit, e cila e çon lexuesin të mendojë se hermetizmi i tij e ka zanafillën në rikodifikimin e muzikalitetit e trashëgimisë folklorike.

Si përfundim, do të thoshim se Zef Zorba, ky poet pak i njohur nga lexuesi, erdhi në letërsinë shqipe si një njohës i shkëlqyer i hermetizmit, të cilin e ndeshim rëndom në gjithë vëllimin e tij poetik *Buzë të ngrira në gaz*. Mbi veprën e tij, është shkruar pak nga kritika; cilësojmë këtu punimet e Sabri Hamitit, Ismail Kadaresë, Nehas Sopajt, Ardian Ndrecas etj., punime në të cilat flitet për ndikimet e poetit nga hermetikët italianë.

Poezia e Zorbës nuk mundi të lexohej “freskët” nga lexuesit bashkëkohës të poetit, jo vetëm sepse nuk e njohu dritën e botimit menjëherë (por pas vdekjes së poetit), por gjithashtu edhe sepse teknikat hermetike të cilat i gjejmë rëndon në gjithë vëllimin poetik (paçka se të personalizuarat e të sjella krejt veçantë, kërkonin një lexues të sprovuar me këtë lloj letërsie).

Poeti jetoi në periudhën e komunizmit, në periudhën e ndryshimeve të mëdha të statusit të lirisë së artistit, në periudhën ku gjithsecilit i duhej të gjente forma “arratie” në artin e tij për të mos humbur të ndërgjegjshmen e të pandërgjegjshmen artistike të cilat do të endnin më pas gjithë unin poetik.

Shumë artistë kanë krijuar tinëz veprat e tyre, e Zorba është ndër ata poetë që i foli letërsisë e lexuesit të saj me “zërin e së ardhmes”, duke kontribuar që modernizmi shqiptar të zhvillohej në heshtje. Nacionet teorike me të cilat qe mbrujtur personaliteti i tij krijues dhe uni poetik, i shërbyen poetit që të shpalosë vetveten deri në skutat më të errëta të mendimit të tij nëpërmjet; muzikaliteti të vargut, fragmentarizimit i cili bëhet njësh me ritmin e mendimit të poetit; trajtimi i temës së ekzistencializmit (jetës dhe vdekjes) të cilat i gjejmë dukshëm në krijimtarinë e Franz Kafkas apo të Bodlerit, përdorimin e fjalëve kyçe, evokimin e imazheve për të “riprodhuar” situata të ndryshme, shmangien e përdorimit të nyjave apo të parafjalëve, poezia sintetike me vargje të shkurtra e koncize, ironisë e autoironisë etj. Janë të gjitha këto elemente – skela në të cilat ndërtohet e gjithë poezia e Zorbës, elemente të cilat shpeshherë sa e afrojnë me hermetikët aq edhe i japin tipare origjinale veprës së Zorbës. Mendimet kritike njëjtësohen në pikën që vepra e Zef Zorbës nuk e gjeti menjëherë lexuesin e duhur, me përgatitjen e duhur intelektuale për t’u receptuar drejt e shterueshëm, nuk mundi të depërtonte lirshëm te lexuesi, pasi kjo poezi erdhi si pasojë e një personaliteti artistik mjaft të konsoliduar artistikisht e me huazime letrare ende të panjohura nga lexuesi i asaj kohe. Në këtë kontekst, Zorba do të shprehej se do ta linte veprën e tij të fliste vetë, e nëse kjo nuk do të ndodhte, atëherë fajtor do të ishte vetë poeti. Ndër të tjera ai shton se botimi i këtyre punimeve do ta trembte pamasë, por përpos skepticizmit të vetë autorit, ai ia doli të realizonte një vepër letrare ndryshe (me gjithë huazimet e letërsisë së huaj), duke shpalosur një *un* shumë të veçantë poetik që mund ta përcaktojë poetin si një alternativë të modernizmit shqiptar.

Bibliografi

- Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, Tiranë, 1989
Nehas Sopaj, *Shpalimi i herbariumit*, Prishtinë, 2008
Wellek dhe Warran, *Teoria e letërsisë*, Onufri, 2007
Sabri Hamiti, "*Albanizma*", Prishtinë, 2009
Sabri Hamiti, "*Bioletra*" Prishtinë, 200
Yves Chevrel, *Letërsia e krahastuar*, Tiranë, 2002
Tomas Eliot, *Tokë e shkretë*, Tiranë, 2010
Luan Topçiu, *Leksione mbi hermetizmin*, Tiranë, 2013
Irena Ndoci, *Leksione mbi hermetizmin*, Tiranë, 2013
Giuseppe Ungaretti, *L'allegria*, Milano, 1931
Salvatore Quasimodo, *Ed e subito sera*, Milano, 1941

Adriana Balla Sadiku

MARRËDHËNIET MUZIKORE NË PËRMBLEDHJEN POETIKE *BUZË TË NGRIRA NË GAZ*

Risi në poezinë shqipe – vëllimi poetik *Buzë të ngrira në gaz*

Parapëlqej ta nis këtë studim me një citim të shkrimtarit I. Kadare për poetin Zef Zorba, në parathënien e vëllimit: “ai është nga të rrallët poetë shqiptarë, që bëri eksperimente avanguardiste, aq pak të pranishme në poezinë shqipe. Një nga këto është synimi për një martesë të lumtur të poezisë dhe muzikës, duke gërshetuar teknikat e tyre”¹³. Vëllimi poetik *Buzë të ngrira në gaz* është krijuar në një kohë politike të vështirë për lirinë e arti; në periudhën ku krijues nuk ishte individ, por në njëfarë mënyre vetë sistemi i ideologjizuar, dogmat e të cilit shndërroheshin në parime krijuese. Për këtë arsye arti i Zorbës mbart vlera të veçanta, pasi ai diti të përqafojë artin e vërtetë përpos frymës së përgjithshme dhe nxitjeve e dhunimeve çnjerëzore.

Zorba operon me një poezi moderne si në strukturë ashtu edhe në përmbajtje. Sa i përket llojit të vargut mund të themi se lëvron përgjithësisht një *varg të lirë me muzikalitet të brendshëm*, megjithëse nuk mungojnë edhe poezitë me strofa dhe me vargje më të pakta dhe herë-herë deri në dyvargësh.

Në poezinë e tij, leksikisht gjejmë një **gjuhë** me fjalë tejet të zgjedhura dhe rrallë të hasura në poetikën e poezisë shqipe. Kjo për arsyetimin që bën Zorba në poezi sa i përket përzgjedhjes së fjalëve. Shpeshherë hasen fjalë të gjuhës standarde, të cilat i përkasin dialektit të toskërishtes, ndërkohë që për t’i dhënë ngjyrë dhe forcë shprehëse poezive gjenden në të edhe fjalë në dialektin e gegërishtes. Një zgjedhje e tillë rrit larmishmërinë dhe tërheq vëmendjen e lexuesit nga ndryshime të befta dhe të herëpashershme. Gjuha me të cilën sillen poezitë nuk i përket një ndarjeje të caktuar dialektike, por hasim

¹³ Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, Princi, Tiranë, f. 12

një ndërthurje të standardit me gegërishten. Megjithëse kjo mbetet një çështje e hapur, dhe për t'u parë nëse ky ka qenë konceptimi i Zorbës për poezinë e tij apo është ndërhyrë gjatë mbledhjeve dhe botimit të tyre.

Zorba shquhet për një **poezi eliptike**, për shkak të trajtës së parapëlqyer që i jepte. Kjo për vetë faktin e dëshmisë së poezisë *Merimangë*, e cila paraqet shtrydhjen në vargje dhe ruajtjen e pjesëve më esenciale, ruajtjen e thelbit dhe eliminimin e detajeve të tepërta, të ujshme. Një praktikë e tillë është ndjekur edhe nga M. Camaj, i cili në periudha të ndryshme kohore ka parapëlqyer të rishikojë krijimet e tij dhe të risjellë poezi, të cilat i dendëson kuptimisht, duke i eliminuar çdo element që nuk nevojitet. Një përpunim i tillë te Zorba është i vlefshëm për poetikën që ai ndjek. Te poetët modernë gjuha është një element i rëndësishëm, pasi nga përqendrimi maksimal krijohet aspekti më i vështirë i poezisë *errësimi*. “*Errësimi*, si një cilësi poetike, është një shqetësim i posaçëm për *purizëm* dhe për *esencializëm*, jo në kuptimin e purizmit bosh të lirikës moderne, por si karakterizues i një koncepti humanist. Errësimi i poezisë është shenjë e modernitetit. ‘Është një lavdi e veçantë që të mos jesh i kuptuar’, shkruante Baudelaire, ndërsa Montale do të shprehej në një mënyrë më të prerë: ‘Askush nuk do të shkruante vargje, nëse problemi i poezisë do të ishte ai që të bëhesh i kuptueshëm për të tjerët’”¹⁴.

Kalimi nga **personalja tek universalja** dhe **e anasjella**, me mjete tejet personale po dhe universale e të gjithkohëshme. Tekstet e tij poetike sjellin një mënyrë që merr shkas e impuls nga tradita letrare, për të tejçuar e zbuluar emocione e ndjesi të ndryshme personale.

Ndërlikueshmëria dhe teksti shumështrësor: Tipar i spikatur i poezisë moderniste është vështirësia që paraqet për lexuesin mesatar, dhe si e tillë kërkon përqendrim më të madh. “Në tekstet klasike ne udhëhiqemi nga autori (shkrimtari) dhe nuk mund të kuptojmë, edhe po deshëm, më shumë se nga ç’na thotë ai, kurse në tekstet bashkëkohëse ne ndihemi të lirë, mund të nxjerrim kuptime të

¹⁴ Topçiu, Luan, *Tradita Moderne në letrat shqipe*, Zenit, Tiranë, f. 87

ndryshme nga i njëjti tekst.”¹⁵, ndërsa për sa i përket krijuesit: “poeti bashkëkohës e shkruan tekstin dhe nuk na imponon asgjë. Kështu, duke lexuar poezinë moderne ne mund të prodhojmë kuptime të reja, që i zgjedhim në tekstin e dhënë poetik”¹⁶ Pra, një tekst i cili thotë edhe më shumë sesa paraqet në lexim të parë, shtresëzimi një element i qenësishëm dhe primarë për sa u përket mënyrave të receptimit.

Poezia e Zorbës bën pjesë në llojin e *poezive afirmative*. Sipas një ndarje të llojeve poetike nga studiuesi Ibrahim Rugova, “poezia e këtij tipi realizohet qenësisht në objektivin e entuziazmit, që njihet si gjendje estetike e vetë subjektit poetik. Konkretisht subjekti poetik është në pajtimësi të plotë me realitetin, me realitetin e ndryshuar si shtysë kryesore e indicies së inspirimit. Pra, është fjala për realitetin e ri social që shfaqet në raporte të reja, i cili përthyeret nëpër elementin e entuziazmit poetik që duhet të marrim si qëndrim poetik”¹⁷. Ndarja dhe përzgjedhja e këtij lloji bëhet duke u mbështetur në elemente estetike, të tillë si raporti subjekt poetik apo objekt, por edhe element të rëndësishëm poetik si **sistemi i figuracionit apo forca e përgjithësimit të abstraksionit poetik**, e të tjerë elemente të kësaj natyre, të cilat në poezinë e Zorbës janë të dallueshëm.

Sintetizimi dhe sugjestionimi: Duke u udhëhequr nga parimi që një maksimum mendimesh, të shprehet me një minimum formulash, për të na dhënë një pafundësi receptimesh poetike, në vëllimin *Buzë të ngrira në gaz*, poezia ndërtohet me *vargje të gjatësive të ndryshme*, ku shpeshherë kemi vargje me një fjalë dhe në të tjera raste me disa fjalë. Në poezi dhe kryesisht në tekstet e poetëve modernë ka rëndësi jo vetëm çdo fjalë, por në to, hapësirat e bardha në fakt bëhen të rëndësishme, tërheqin vëmendje qysh në fillim, të bëjnë përshtypje qysh në kontaktin e parë me tekstin. Në poezi vargëzimi i kërkon si heshtje rrethuese, hapësira e bardhë e letrës bëhet e pranishme për marrësin e mesazhit sa herë që një imazh pushon së qeni ose

¹⁵ Rugova, Ibrahim, *Kritika*, ASHAK, Prishtinë, f. 203

¹⁶ Po aty, f. 203

¹⁷ Po aty, f. 320

shndërrohet në një tjetër, duke pranuar në këtë mënyrë një vazhdimësi vlerash.

Ndikimi prej hermetizmit

Zef Zorba e ka zhvilluar krijimtarinë e tij letrare duke mbartur mbi supe një formim të mirë kulturor e veçanërisht letrar. Duke lexuar kolosët e letërsisë, filozofisë dhe kulturës botërore e shqiptare, ai diti të marrë më të çmuarën prej tyre. Ai pohon në pasthënien e vëllimit ndikimin e tyre, duke u shprehur: “Vetëm se do dëshiroja të mos keqkuptohet admirimi që kam për poezi moderne, që nga Bodler te Montale, e sidomos *metoda e esencialitetit ose e hermetizmit* e diktuar prej tyre. Kam mësuar shumë prej tyre, kam parë si ata shpuplojnë ndjenja e emocione, si unisojnë në vargjet e veta poetike çdo vështirim artistik, si manipulojnë mjete të ndërlikuara duke ia shtruar një regjimi të fortë analize e kursimi, si mobilizojnë jo vetëm rimat e aritmitë, metrat e asimetritë, por deri pauzat, pikësimet e kursive me asonanca e disonanca qëllimore, me pasazhe e kolorite, duke i çuar të gjitha drejt një komunikimi poetik të madhërishëm”¹⁸.

Zorba, si një poet me një krijimtari nën frymën e ndikimit, diti të përvetësojë metodën krijuese të artistëve botërorë. Imitimi i tij nuk qe i drejtpërdrejtë, sepse siç thotë dhe ai: “parimi i rrugëve emocionale të tyre do të kishte qenë një vazhdim i mjerë dhe i pafrut”¹⁹.

Hermetizmi është një ndër aspektet e poetikës së Zorbës, i cili përbën një detaj specifik në raste studimesh dhe analizimesh të poezive të tij, por edhe lexuesi duhet të gjejë hapësirat e duhura për tejkaluar atë në poezi. *Hermetik* dhe *hermetizëm* janë terma të cilët mbase në përdorimin e zakonshëm e të përditshëm përdoren për të treguar mbylljen dhe izolimin në mënyrën më të skajshme. Hermetizmi në letërsi është një periudhë e cila është përcaktuar dhe quajtur e tillë për shkak të vështirësive që ka hasur lexuesi në receptimin e veprave të caktuara letrare. Mendoj se ky fenomen ka ardhur në mënyrë graduale, si pasojë e letërsisë klasike, e cila në

¹⁸ Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, Princi, Tiranë, f. 171

¹⁹ Po aty, f. 172

njëfarë mënyre kërkonte thjesht vetëm të lexohej. Për një letërsi e cila kërkon të na bëjë bashkautorë e bashkëndijues, ose dhe bashkëvuajtës me unin lirik, janë gjetur e vendosur të tilla emërtime. Megjithëse nuk më duket e drejtë të quhet *hermetizëm* dhe *hermetik* një shkrimtar apo një letërsi e cila na jep mundësinë e një interpretimi të pafundmë e tejet personal, por edhe shumëformësh. Gjithsesi për të mos u ndalur në këtë pikë, Zorba ka ditur të marrë më të mirën e hermetizmit dhe duke e përshtatur më tej me intuitën dhe vizionin e tij mbi botën, jetën, vdekjen.

Te *Buzë të ngrira në gaz* kemi vargje në italisht, të cilat nisin poezi të ndryshme, duke shërbyer si frymëzim apo si një formë nxitëse receptuese për poezinë në një drejtim të caktuar. Me *metodën e esencialitetit*, siç e quan vetë Zorba, arrihet të përçohet shumëfish emocion ndonëse vëllimisht mund të kemi tekste të shkurtra. Vendosja e fjalëve dhe lidhja e përafrimi midis tyre konotojnë ngjyrimë të pamundura dhe të reja për lexuesin dhe për botën e tij. Kjo e bën më të vështirë punën me tekstin e, nga ana tjetër, edhe më tërheqëse. Është kjo metodë krijuese që Zorba zgjedh si model, i cili përdoret për të sjellë sërish vlera, por duke kaluar përtej tij. Duke e përditësuar atë me të renë, duke e personalizuar atë me shpirtin e tij dhe duke i dhënë jetë në një tjetër formë e përmasë, sa që e shndërron atë në një mënyrë në tjetër model ndikues për të ardhmen.

Koncentrimi muzikor në artin e Zorbës

“Unë nuk besoj që ka art tjetër që të ndikojë aq shumë tek artistët sa ç’ndikon muzika... Asnjë vepër arti, duke filluar që nga ato të letërsisë, pikturës, arteve skenike nuk mundë të ekzistojë pa atë që quhet ritëm”, shprehej Bardhyl London. Bashkëpunimi midis poezisë dhe muzikës ekziston, patjetër, por poezia me vlera të larta nuk priret drejt muzikës, kurse muzika më e madhe nuk ka nevojë për fjalë²⁰. Lidhja midis llojesh të ndryshme artesh nuk e zbeh aspak vlerën e veprave të ndryshme artistike, përkundrazi, arrijnë të përçojë te

²⁰ Wellek, R., Warren, A. *Teoria e letërsisë*, Onufri, Tiranë, f. 129

publiku emocione të shumëfishuara për të përcjellë të bukurën në shumë forma.

Poezia e Zef Zorbës e ka të ndjeshëm *unjisimin* me artet e llojeve të tjera. Duke u mbështetur dhe në të dhënat biografike dhe personale, është e dukshme dhe evidente në shumë elemente dashuria e tij për artin. Lidhja e ngushtë familjare me artistin Kolë Idromeno (Zorba qe nipi i tij), lidhjet shoqërore me kompozitorin instrumentalist Prenk Jakovën, janë disa burime të pashmangshme e tepër ndikuese në formimin kulturor e artdashës shumëplanësh të Zorbës. Mbështetur në të tilla të dhëna, është e justifikuar zgjedhja e tij për ndërthurje dhe sintetizime të mundshme në vepra të elementeve ndërlëndore të artit.

Poezitë e vëllimit *Buzë të ngrira në gaz* nuk janë dhe nuk synojnë të jenë një kopjim i tingujve të dalë nga instrument të ndryshëm muzikorë. Lidhja e tyre me muzikën është më e thellë dhe jo e një rrafshi të tillë elementar. Muzikaliteti në poezinë e tij nuk është i pranishëm vetëm në rrokjet dhe në tingujt që përcillen, po fryma muzikore ndihet si përçimin e ndjesive ashtu edhe në ritmin e brendshëm, duke lidhur elementet shqisore me ato ndijore. Titujt që mbajnë poezitë janë përfaqësues objektsh e kohësh muzikore, dhe nga njëra anë në plan të parë na paraqesin Zef Zorbën euridit, por na për afrojnë me situata, dëshira, mohime, thyerje e kufizime. Poeti synon t'i sjellë emocionet, ndijimet dhe imazhin e tij për botën nëpërmjet dy artesh njëkohësisht.

Struktura poetike dhe struktura muzikore

Vëllimi ndahet në cikle, të grupuara në gjashtë të tilla, shoqëruar me një pasthënie nga vetë autori. Shënimi i autorit për veprën e vet zgjon te lexuesi kuriozitetin dhe nxit dëshirën për lexim, për të gjetur në një mënyrë a në tjetrën arsyen e frikës dhe të ngurrimit për botimin e poezive të tij: “Nga ana tjetër këto punime s’janë bërë për botim, sepse edhe botimi i tyre kurdo dhe kudo më tremb pa masë”²¹. Botimi i dytë është shoqëruar me parathënie nga shkrimtari Ismail

²¹ Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, Princi, Tiranë, f. 174

Kadare, i cili, me vlerësime të larta për artin e Zorbës bën një ndalesë të shkurtër në tipare të poetikës dhe krijimtarisë së tij, duke përvijuar në një mënyrë një shteg drejt poezisë së Zorbës dhe formës së ardhjes së saj në letërsi.

Në ciklin e parë “Elemente” përfshihen trembëdhjetë poezi, të cilat bazuar dhe në emërtimin përmbledhës ashtu edhe në titujt e tyre duket sikur na paraqesin çaste emocionesh, kujtimesh të mbledhura në kohë e në periudha të ndryshme, duke paraqitur gjendje dhe emocione të perceptuara po aq ndryshe nga njëri-tjetri, herë më të vrullshme e herë-herë më të qeta.

Cikli i dytë “Blerime tjera e zalle”, në të ndjehen të tjera ndijime, perceptime, mbase edhe kushtime që paraqesin të tjera prezantime ndjesish e dëshirash. Ky cikël përmbledh dhjetë poezi.

Cikli i tretë “Pasqyra të cilituna” është i përbërë nga nëntëmbëdhjetë poezi. Ku edhe emërtimi, i cili i vendoset cikleve, vetvetishëm bëhet përfaqësues për një grup poezish, mbështetur në detaje të ndryshme.

Cikli i katërt është më i shkurtri i përbërë nga pesë poezi dhe në të ndjehet një ndryshim në formë, strukturën e vargjeve, gjithashtu, ndryshimi është i dukshëm dhe në vetë titujt e poezive (*Allegro*, *Andante mosso*, *Lento* etj.), të cilat janë ndryshe nga ciklet e mëparshme.

Cikli i pestë “Mbresta e rrugëve (poemë)” është ndër ciklet më të veçanta për sa i përket titujve pasi duket kemi të bëjmë me poezi të titulluara me emra instrumentesh apo kohësh muzikore, dhe në disa raste me nëntituj. Ky cikël sipas faksimileve apo sqarimeve të gjendura në tekst ka qenë i parashikuar për një libër më vete. Gjithsej kemi të bëjmë me 12 poezi.

Cikli i gjashtë dhe i fundit “Në zgrip” është i përbërë nga tetë poezi. Titulli i këtij cikli më kujton përnjëherësh disa nga vargjet për mendimin tim të ndjera dhe përfaqësuese të Zorbës:

*Në cep të greminës,
që joshë e ngujon,
a nuk e sheh si po lëkundem? (Poezia Në vend të hyrjes)*

Ndonëse një poezi kjo e cila nuk bën pjesë në këtë cikël unë mendoj se aty gjendet dyzimi i një jete të tërë. E vendosur dhe në hyrje vargjet dhe kjo poezi sipas S. Hamitit: janë vetë të lexueshme, veç të tjerash. Estetikisht të tillë emocione ngjallin edhe poezitë e këtij cikli, i cili është dhe një ndër ciklet me poezi të tjera me muzikalitet, si: *Një gozhdë, Natën kur bie shi* etj.

Cikli poetik "Fugat e fundit"

Prania e muzikalitetit dhe mënyra se si përcillet estetikisht në poezi kjo harmoni e kryqëzuar e të bukurës ndërlëndore do të përbëjë thelbin e analizimeve për rastin e marrë në shqyrtim. Përtej çdo fjale dhe vargu qëndrojnë ndijime të shumta dhe të motivuara jo vetëm leksikisht por edhe muzikalisht.

Cikli apo "libri" *Fugat e fundit* hapet me *Allegro. Allegro, Andante Mosso, Lento, Largo* dhe *Allegro Furioso* lidhen midis tyre me anë të konceptit të fugës (në ciklin poetik me titullin përbashkues *Fugat e fundit*). Parimi më i thjeshtë i fugës, në muzikë, është *imitacioni*: si një lodër muzikore (në një kor me katër zëra) të gjithë zërat me radhë përsërisin ose imitojnë atë që këndon zëri kryesor (zëri që e fillon). Na krijohet përshtypja e shumë melodive; në fakt, tingëllon një melodi e vetme ku shumë zëra rrugës gërshetohen me vetveten. Ndonjë nga zërat pushon, të tjerët këndojnë, ata nuk tingëllojnë gjithnjë përnjëherësh. Ndonëse zërat ecin së bashku, ndër ata ka gjithnjë një që zotëron. Ky është përkufizimi më i thjeshtë, por fantazia, llogaritja e bëjnë fugën një gjini jo të thjeshtë.

"*Allegro*, si formë muzikore është krijuar që të përforcohet shpejt, në mënyrë të shkathët, dhe kështu verbi/krijimi i Zorbës, më shumë se për nga ritmi i shpejtë, për nga vetë substanca e fjalëve të zgjedhura dhe imazhi akustik i tyre (*ernat, përtërimjen, çatrafillojnë*) është levend, i ndezur, energjik. Përfytyrimi i lëvizjes së rrymave të ajrit në drejtime të ndryshme, i erërave të forta, të holla a të tërbuara, çfarëdo qoftë, është diç nxitëse, aktive, gazmore. Përdorimi i foljes më të goditur që shënjon pështjellim dhe çrregullim të bukur *çatrafilloj* dhe përdorimi i fjalës *përtërimje* paralajmërojnë gjallërimin, lulëzimin,

rishfaqjen ashtu siç ka qenë... Porse asnjëherë *Allegro* e Zorbës nuk është vërtet thelbi i formës muzikore, por dëshirimi, ravgimi, pritja e mrekullisë.²²

Zakonisht, në muzikë, pjesët e gëzueshme jepen me *allegro*, ose kanë temp *allegro*, por ka pjesë të trishtueshme po me këtë temp (si *Allegro con brio* e Bethovenit). Kështu, ndodh që pjesa e dytë e kësaj poezie të Zorbës nis e na paralajmëron trishtimin. Në strofë shfaqen duke pluskuar fjalë që zymtojnë si *mavi*, *moçal*, *re*, *kufizuese*; aq më tepër lidhjet që krijojnë këto fjalë me njëra-tjetrën në frazë, i japin edhe më shumë forcë zymtuese imazheve. Sipas studiueses Viola Isufaj: “Ato fuqizojnë edhe më shumë potencialet e tyre në lidhjet sintagmatike ngjyrën mavi të moçalit; re kufizuese, kurse folja *zbres* njofton uljen, lëvizjen më poshtë, tatëpjetën, të themi, kadencën.”²³

Motivet lirike të hasura në poezinë e mësipërme janë të gjalla. Ndonëse në rrethana privuese gjallëria është e pranishme, përpos zymtësisë që në fund përmbyll një shpresë dhe dëshirë të subjektit lirik. Për një receptim dhe kuptim sa më të qenësishëm është e nevojshme që t’i analizojmë me imtësiht pranëvëniet e fjalëve dhe në poezinë “*Andante mosso*”. Nuk e dimë se çfarë kumbon, dhe drita nga vjen (apo s’vjen), por një trishtim buron në mënyrë të vetvetishme përpos gjithçkaje.

Tani nga një gjumë shekullor kanë mbetur ende të gjalla lajthitjet (dëshira, çmenduri). Ishin pikërisht ato vetëtima që dikur flakëruan, por nuk mundën të ishin më të plota se një dritë e çastit, një ndezje e momentit, pa mundur të shpërthejnë në flakë, pa mundur të marrin jetë. Ato synime, dëshira, pasione kanë ardhur nga një kohë e kaluar e kanë mbetur të tilla, në përpjekje për të flakëruar, nuk kanë shpërthyer në dritë por as nuk janë shuar.

Div i kërtylur ëndërrimesh, nuk u shqetësove dhe pse binin një pas një Zot, trima dhe dituri të lashta. Mjaftoheshe me ujdi të trilluara, plotësoheshe me sajime dhe bëma ku flitej me shifra. Por *gjeometria*

²² Isufaj, Viola, *Relacione muzikore në poezinë e Zef Zorbës*, në aktet e Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 2017

²³ Po aty.

afshin nuk ta zgjidhi, gjeometria ose hapësira në dimensionin e saj të plotë ku përmbledh çdo pikë të natyrës dhe përfshinë dhe vetë ajrin brenda saj. Paskësh qenë e pamjaftueshme edhe sundimi i çdo hapësire në pjesën e saj më të plotë për të zgjidhur afshin. Vijon më tej absurdi i pamjaftueshmërisë madje as vargu, kur e hulumtove në difraksion rrezesh iks, fjala e cila përballë hulumtimeve ishte si një objekt nën efektin e rrezeve x, i tejdukshëm dhe i zbuluar në detajet më të thella.

Div i fuqishëm, i gjithëpushtetshëm, i pangopur në hapësirë dhe në ide, zotërues i trupit dhe mendjes nuk u plotësove përpos gjithçkaje.

Në fund të këtyre veprimeve çmendurie mbetesh jeremisur,

Jeremisur

ke mbetë

në mes të askurrgjësë e të pambarimit.....

Është aq i përforcuar mohimi tek bashkimi i fjalëve *askurrgjësë* sepse kemi *as+kurrë -pa*. "*në mes të askurrgjësë e të pambarimit.....*" përumbja është e kudondodhur përreth dhe duket aq gjithëpërfshirës sa të krijon idenë e vdekjes për së gjalli.

Në të gjithë poezinë, lidhur dhe me vetë titullin i cili shpreh lëvizje, ndjehet lëvizja, por nuk kemi një kurbë graduale të saj, nga përgjumja, arrihet në kërtylje dhe më tej i jeremisur. Por kjo jeremisje është pambarim gjeri në pafundësi.

Kalimi nga numri shumë në numrin njëjës vjen në mënyrë të dukshme, ligështia, dhimbja dhe trishtimi nëse në fillim të vargjeve subjektivisht jepeshin të përgjithësuara, në fund të vargjeve ato mblidhen në një qenie të vetme. Plot bujë, zhurmshëm dhe e fortë jepet dhimbja në fillim kur thuhet *kumbon, buron trishtim, shfrime, vetëtima*, dhe përmyllen në fund në një kurbë, e cila ulet duke të krijuar idenë e vazhdimit dhe të gjatësisë.

Me rrjedhën e vargjeve të krijohet ideja e lëvizjes së vuajtjes si një bumerang, ku gjithçka e shkaktuar nga subjekti rikthehet në të njëjtën formë tek vetë ai, por shumë më fuqishëm dhe e shumëfishuar, pa i dhënë mundësinë për të gjetur shpëtim në shpirtin e tij. Shpirti nuk gjen shpëtim, pasi ai nuk mund ta zotërojë dot forcën për të ndaluar

rënien: *e vetëm lëndës/ ia pate besën, pa e marre në dorë/ tëposhtën*. Prania e zanores o në vargjet e para dhe gjendja e saj pikërisht në fjalë, të tilla si: *kumbon, ndriçon, buron*, të krijon idenë e hapësirës, të gjerësisë e të lartësisë, pasi kumbimi si dukuri ekziston në ajër dhe hapësirë, dhe ndriçimi është gjithashtu një dukuri e dallueshme nga shqisat e të parit, ndërsa burimi është specifikuar që vjen nga dheu. Dukuri të tilla si të mësipërmet paraqesin veprime dhe lëvizje në pjesën e fillimit të poezisë. Gjithçka gjendet në lëvizje, ndjehet në çdo pjesë element që përcjellin rrjedhje dhe veprim. Në kontrast me pjesën e fundit në të cilën ravijëzohet një gjendje prehje, ngrirje, e cila jepet me sintagmën *Jeremisur ke mbetë*, dhe përforcohet në fund me ndajfoljen *të pambarimit...* e cila të krijon ndjenjën e shuarjes së ngadaltë, ndjekur dhe nga trepikëshi i cili është përfaqësues “i diçkaje që vijon”.

Ashtu si dhe vetë titulli gjatë gjithë poezisë që në fillim dhe deri në trepikëshin e fundit ndjehet ideja e lëvizjes, zgjimit, ndryshimit, nëpërmjet detajeve të tilla si *prej gjumit shekullor...lajthitjet kot se i përpushë*.

“Poezia *Lento* është një formë ndjesore që evokon ndjeshmërinë e një gjendjeje të amullt e të trishtë plot me tension emocional. Kohëzgjatja e tingullimit këtu është më e madhe se në të tjera poezi, nyjëtimi artistik ka lidhje me një mendim, disi të zvargur, me emocione të përmbajtura dhe mbytëse. Tingujt e gjuhës këtu kanë kuptim, kontekst dhe “ton” jo të ngjashëm me poezitë që e paraprijnë. Është një modelim i ndryshëm i tingujve në varësi të asaj çka ato shënojnë. E, në këtë model tingullor përsëritja e zanoreve apo e bashkëtingëlloreve me cilësi të veçanta, konfiguracionet e papërsëritshme të lëvizjeve të ngadalta apo të gjendjeve të pezullta janë vendimtare.”²⁴

Shprehjet dhe fjalët me konotim kundërshtues dhe të ndryshme, përshfaqin brengat ndjesore të unit lirik. Struktura e poezisë është në harmoni me ndjesitë dhe shpresimin e i cili vjen duke u venitur, ashtu dhe teksti fillon të tkurret. Krijohet ideja e një tharje dhe shterimi,

²⁴ Isufaj, Viola, *Relacione muzikore në poezinë e Zef Zorbës*, në aktet e Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 2017

ndryshimi është në një mënyrë graduale si kuptimisht dhe konkretisht.

“Poezia *Lento* shquhet për groteskun, ankthin, tëhujësimin – veçori edhe këto të stilit ekspresionist. Vëmendje e veçantë i kushtohet vegimeve dhe gjendjeve të rënda të shpirtit dhe të trupit të njeriut.

Titulli është ndoshta dhe një kurajë dhënë vetes për ta marrë me ngadalë e me qetësi fatkeqësinë.”²⁵

Poezia e mësipërme është një rikthim në të shkuarën i subjektit lirik, ndjesitë që përshkruhen janë të kaluara, por gjurma dhe shenja që kanë lënë është po aq e gjallë. Atmosfera e humbjes, kalbjes, dhe vdekjes sjell një tonalitete të ulët për sa i përket pjesës emotive. Kjo nga ndjeshmëria që përcillet vargu, duke sjellë me vete një dramaticitet përfshirës në kohë dhe hapësirë. Hapësira dhe koha janë përfaqësuese të ritmit, dhe si të tilla përçojnë detyrimisht nota të ulëta.

Titulli i poezisë *Largo* dhe nëntitulli *Conzenatto* paraprijnë për një tekst me tinguj dhe fjalë që lënë shenjë dhe gjurmë. Duke u renditur njëra pas tjetrës fjalët *largo* – dhe *conzenatto* – gërvoishtë, që në nisje të krijohet ideja e një gërvoishtë të gjatë e cila gërren dhe çjerrë. Në muzikë *largo* emërton tempin e ulët, ose pjesët muzikore me një temp të tillë. Një lidhje e tillë kuptimore nuk është e zakonshme dhe e çfarëdoshme. *Largo* është një tjetër nga poezitë e ciklit “Fugat e fundit”, që nga vetë titulli dhe nëntitulli na përgatit për një tekst plot elemente ritmike, ndjesore, emocionale, që na përcjellin atmosferë akustike të ndjeshme dhe të dëgjueshme, po aq sa të lexueshme.

Strukturalisht poezia ndërtohet në tri pjesë, në pjesën e parë ndjehet një lëvizje dhe zgjim nga ngujimi, i cili ishte në shkallën e tij më të lartë, ngujim të *prunjur*, të *stërkequr*. Emri i përveçëm në këtë pjesë krijon një aktualizim, duke lexuar edhe sqarimin nga autori për një përdorim të tillë: “*Marini ka qenë një i deleguar i “Propaganda Fide” për të vrojtuar gjendjen e dioqezave të asokohshme në Shqipëri, pra në kohën e pushtimit otoman, dhe ka hasur vështirësi e pengesa gjithëfarësh për kryerjen e misionit që i ka ngarkuar*”.

²⁵ Isufaj, Viola, *Relacione muzikore në poezinë e Zef Zorbës*, në aktet e Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 2017

Përzgjedhja e një emri të tillë për të bërë një aktualizim të ndjenjës së vuajtjes, krijon dhe një lidhje me shpeshtësinë e përdorimit të tingullit zanorë *i*, që në shumë raste shërben për të ngjallur përshtypjen e haresë. Në rastin tonë ndonëse nuk jepet hare dhe përshtypje e atmosferave gëluese, në vetvete kemi një dalje nga ngujimi dhe domosdoshmërisht hareja vjen dhe është e pranishme në të tilla këndvështrime.

Pjesa e dytë e poezisë na përball me të renë, e cila lind nga rrënjët e vjetra të mënjanuara të papërfillura më parë. Por ndryshimi nuk është aq i dukshëm dhe i plotë, pasi është *po ajo këngë e lashtë e fisit, që në mërgim përkundi shumë do burra*. Lidhja e të resë me të vjetrën gjendet në këngë dhe kudo, pasi nga ajo e shkuar jemi këto që jemi. Këta burra janë përkundur dikur me këto këngë. Ndikimi i tyre ka qenë i pashmangshëm dhe ka formësuar dhe krijuar atë çfarë sot janë.

Përdorimi i foljeve është i pakët dhe prania e tyre duket më e shpeshtë në fund të poezisë. Mbizotërimi në këtë rast i shprehjeve treguese (përemrat dëftorë, përemrat vetorë, ndajfoljet e kohës e të vendi) nuk të drejtojnë te sendet, por te vetë fjalët. Ky element qartëson një nga tiparet krijues të Zorbës dhe kryesisht, të cikleve “Fugat e fundit” dhe “Mbresat e rrugëve”, që është mungesa e përshtimeve objektive dhe të qarta. Nuk gjejmë përshtime tipike situative, sepse në vetë poezitë e përmbledhjes poetike *Buzë të ngrira në gaz* rëndësia nuk qëndron tek objekti sesa qëndron tek ndjesia që arrihet të përçohet. Foljet e përdorura kryesisht janë në kohën e kryer: u përmbyskan, u shpalosje etj. Për t’i dhënë një jehonë të shkuarës, duke lënë të nënkuptuar mbi të gjitha rëndësinë e saj për çdo gjë që vjen në të ardhmen e kushtëzuar nga e kaluara.

Vihet re një pluskim i zanores *u*, përdorimi i saj të krijon idenë e thellësisë, errësirës e deri të frikës. Por pyetja që lind është: Kujt mund t’i druhet ky un lirik? Humbjes së të shkuarës dhe mungesës së asaj çfarë ishte dhe kishte dikur, apo të ardhmes, të resë dhe të panjohurës? Një lloj përgjigjeje për ndjesinë e tillë kemi në fund të pjesës së tretë dhe të fundit në vargun *Veç, çoroditje prap*.

E gjithë çfarë u tentua u dëshirua dhe u përpoq, s' ishte asgjë më shumë se një çoroditje, si të tjera herë. Pasi ndajfolja *prap* e vendosur pas emrit *çoroditje* na tregon që kemi të bëjmë me një veprim që përsëritet tashmë dhe kurba e tij ka ardhur në rritje. Mbyllja e poezisë me vargjet:

...atje ku s' humbe

e kurrë nuk humbe... dhe me praninë e epiforës, e cila e përforcon efektin kumtues të fjalës *humbe*. Por nga ana tjetër si efekt tingëllues realizon dyfishim tingujsh duke zgjatur në këtë mënyrë edhe pjesën e shuarjes si një zvargie dhe një rënie e ngadaltë homogjene dhe e njëtrajtshme.

Në poezi kemi përdorimin e reticencës në katër raste duke përftuar efekte stilistike të lidhura këto me kumtimin. Por më e rëndësishmja qëndron dhe në faktin dhe rolin tingëllues që vjen nga kjo zgjedhje e autorit. Gjatë përdorimit të reticencës intonacioni qëndron pezull, efekti intonativ pëson ndryshim të beftë, dhe të menjëhershëm. Kryesisht ndryshimi që përfitohet lidhet edhe me uljen e ritmit dhe krijimin e pauzave ndaluese për të ngadalësuar një dukuri vepruese, duke e lënë atë të nënkuptuar.

Fjalët me më shumë se dy rrokje janë mbizotëruese dhe efekti i tyre stilistik është i ndjeshëm në uljen e ritmit dhe realizimit të një vije melodioze e harmonike të qetë dhe pa ndalesa e ulje ngritje. Vihet re dukuria e fjalëve me shumë rrokje kur shpeshherë kemi bashkim me parashtesa ose prapashtesa, në të tilla fjalë si: *stërkequr, papërgjasim, bukurituar, motmoti etj.*

Një veçori e këtij teksti poetik përbëjnë leksemat: *Marinit, Murani, muranat*. Fjala e cila grafikisht përmban thujtë të njëjtat grafema, me ndryshim të pjesshme në fjalën e parë. Nga ana leksikore ato janë shënjuese për shënjuar të ndryshëm. Në rastin e parë kemi të bëjmë me një emër të përveçëm, sipas sqarimeve edhe të vetë autorit. Në rastin e dytë i shënjuari është një send, një lloj objekti qeramik zbukurues, dhe rasti i tretë dhe i fundit i cili përfaqëson një objekt të përbërë nga gurët. Përzgjedhja e fjalëve të tilla nuk lidhet me anën

kuptimore të tyre sesa më shumë me harmoninë dhe njëtrajtshmërinë tingullore që i falin ato poezisë.

Nga poezitë e tjera të mëparshme të ciklit “Fugat e fundit”, *Largo* është poezia me ritmin më të ulët dhe fjalët kanë njëtrajtshmëri tingëllimi. Duke qenë se në muzikë *Largo* identifikohet si një ndër tempet më të ulëta të lëvizjeve në minutë, në tekstin poetik të shqyrtuar ndjehet dhe përfaqësohet kjo ulje ritmike varg pas vargu.

“Koncepti *allegro* na shfaqet në një temp më të stuhishëm që në fund njih një bjerrje të beftë në poezinë tjetër *Allegro furioso*. Tek *Allegro furioso* ka një kundërvënie të një grupi idesh dhe një grupazhi imazhesh energjike me në grup tjetër me tipare më të buta dhe nota lirike. Në këtë pjesë, Zorba kontrastin midis dy ideve kryesore, e nxjerr në pah në fund”²⁶.

“*Allegro furioso*, me efekte zanore shumë ekspresive, me përshkallëzim shumë të fuqishëm në emra, folje e mbiemra – ka formën e një pjese sonate. Nëse do të zbërthenim më tej idetë kryesore kundërvënëse, do të hetonim se këto ide janë në përputhje a në ngjashmëri me dy ide muzikore; ideja e parë është aktive, e fortë, me disa elemente dramatike dhe mishëron forcën që ecën gjithnjë përpara dhe që duket se nuk sprapset kurrë. Pjesa e dytë, ose ideja e dytë, e përbërë nga një varg i vetëm, i jep poezisë një karakter të theksuar dramatik.”²⁷

Cikli poetik “Mbresat e rrugëve”

Ky është një cikël që lidh ngushtë elementet poezisë me ato të muzikës, jo vetëm për sa i përket titujve me emra instrumentesh muzikore, por dhe në ndërtimet e poezive dhe në receptimet e mundshme që mund të realizohen prej tyre. Një cikël poetik i cili parë nga plani letrar realizohet dhe sillet si poemë, ndërsa po ta shohim në anën jashtëletrare, muzikore, vjen si një koncert. Muzika duket se

²⁶ Isufaj, Viola, *Relacione muzikore në poezinë e Zef Zorbës*, në aktet e Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 2017

²⁷ Po aty.

është një detaj i rëndësishëm dhe përbën një sfond madhështor në hapësirën prezantuese poetike jo vetëm në tituj, por dhe më tej.

Ky cikël, i konceptuar nga Zorba si një libër më vete, mund të përbëjë mbase ciklin poetik më të veçantë në letërsinë shqipe, sa i përket konceptimit dhe mënyrës së gërshetimit të muzikës me poezinë.

Emërtimi përmbledhës i ciklit lidhet me mbresat. Çfarë mund të jenë këto mbresa? Dhe pikërisht të rrugëve. Ajo çfarë pres të gjej në poezitë që përmban ky cikël është një koncert. Një koncert në ambient të hapur ku të ndërthuren bashkë tinguj instrumentesh dhe natyrë. Aty ku fundi të jetë plot mbresa. “Mbresat e rrugëve” përcjell kuptimisht një eveniment të tillë muzikor, ku të rëndësishme janë mbi të gjitha *mbresat*. Vetishëm lind pyetja: A kërkon Zorba në një lloj mënyre të tërthortë mbresat për artin e tij, për poezitë që ai krijoi? Mbresat e atij publiku që ai s’e njohu!

Poezia e parë e titulluar *Introduksion* është pjesa hapëse e ciklit. Në muzikë introduksioni: është fillimi i pjesëve muzikore apo i koncerteve instrumentale. *Introduksion (Kthehen kujtime)* është një nga poezitë e cila të sjell vegime të një kohe të largët. Kohë e cila mbart mbresa. Që në vargjet e para prania e ndajfoljeve të kohës *tash* dhe *lehtë*, krijon një hapësirë e cila nuk është thjesht një periudhë kohore, por është një boshllëk që sjell ndryshime. Këto ndryshime kanë ndodhur tashmë, megjithëse koha ka mbetur kohë. Retiçenca e herëpashershme në fillim të vargjeve është një heshtje e cila vijon më tej në vargjet e radhës me leksemat, *pa frymë, heshtje*. Duket se ndjesitë për të shkuarën përbëjnë emocione aq të thella për unin lirik sa që herë pas here ndalet. Duket sikur çdo gjë tjetër ka ndryshuar, veç koha jo. Kujtimet e një kohe që tashmë ka shkuar janë objekt ideal i melankolisë për unin lirik.

Në raportin dhe lidhjet muzikore vargjet të ndjellin emocione dhe ndjesi melankolike dhe të qeta. Ashtu siç dhe në muzikë kur flitet për introduksion kemi të bëjmë me hyrje të qetë dhe nota të ulëta. Si poezi hapëse e një cikli, *Introduksin* është përfaqësuese pasi në të

mbizotëron motive përgjithësues dhe toni i qetë, çfarë lë të nënkuptohet që kemi të bëjmë pikërisht me një hyrje.

Tema e fagotit, është poezia e radhës në ciklin “Mbresat e rrugëve”. Fagoti është një instrument i veglave frymore të drunjta i cili prodhon tinguj të ulët. Në poezi gjenden fjalë të shumta të cilat përmbajnë bashkëtingëlloren *g* (*gurmaz, gërhet, gropë, ngacmuese etj*). Ritmiku është të tilla përdorime sjellin tinguj ritmiku të ulët, sepse ndjellin një pengesë gjatë artikulimit të fjalëve. I arsyetuar një përdorim i tillë lidhet sa aq me procesin e kumtimit të fjalëve, por edhe me akustikën e tyre. Elementet e ndërthurjes së kësaj poezie me muzikën janë dukshëm të qenësishme, dhe lidhja me temën e fagotit është e pranueshme si riprodhim tingujsh të ulët, por kjo nuk do të thotë që kemi imitim të temës së fagotit. Mund të flasim për ndjesi apo emocione të cilët lindin dhe mund të përcillen në një mënyrë të tillë. Reflektimet e brendshme janë shpërthime që marrin sadisfaksion dhe nisje po nga të tjera ndjesi dhe përcillen në poezi me kumtin e fjalëve dhe melodinë e tingujve.²⁸

Tema e ksilofon kumbonëve është një tjetër poezi që lidhet me muzikën, qysh në titull cilësohet instrumenti muzikor dhe funksioni që ai kryen. Ksilofoni është vegël muzikore, që përbëhet nga disa pllakëza druri me madhësi të ndryshme, të cilat i godasin me dy çekanë të vegjël për të nxjerrë tinguj. Në këtë poezi jepet një gjendje e trazuar e natyrës. Në veçanti, mbizotërimi i zanoreve të theksuara, duke krijuar një lloj të foluri kumbues arrin të artikulojë të folurit strikt, të qartë dhe të kuptueshëm dhe kjo do të ndikojë edhe në artikulin e vetë idesë, përkatësisht të qartësisë së saj, që shkon bashkë me ligjërimin e përgjithshëm poetik. *Ngado- m'atëanë; ëndërr-njëllor; gurgullon-kushtrim* janë disa nga përdorimet e asonancave, efekti që krijohet nga të tilla përkime zanoresh, është i ngjashëm me tingujt që vijnë prej druri, ashtu si tingujt e ksilofonit që vijnë nga goditja e pllakëzave të drunjta.

²⁸ Isufaj, Viola, *Relacione muzikore në poezinë e Zef Zorbës*, në aktet e Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 2017

Zymtësia dhe elementet e errësirës janë mbizotëruese dhe përcjellin trishtim dhe melankoli të subjektit lirik. Por ëndrra që shtrembëron çdo gjë mund të jetë një vend prehje dhe qetësie, një mundësi jashtë së vërtetës dhe realitetit. Përhumbja në ëndërr mund të jetë i vetmi shpëtim.

Tema e Violës (Ne djemtë dhe vajzat e një mature) është një tjetër poezi e ciklit, e cila mbart nota melankolike, ku ndërthuren njëra me tjetrën fjalë të tilla që e përçojnë këtë ndjesi, si: *e ndrojtur, piskamë, shqetësime* etj.

Mbyllja e strofës së parë me vargun:

Në bebe të syrit të valvitej

petali i një vjollce.

Mbart një dëshirë për dhuratë, për vjollca dhe për petale, lulet të cilat simbolizojnë dashurinë dhe delikatesën.

Pjesa e dytë është ajo në të cilën hapësirë i kushtohet djemve, ndryshe nga e para që ishte një përgjithësim drejt një himni, dhe ndryshe nga e treta që risjell më konkretisht vajzat të cilat nënkuptohen dhe në dy pjesët e para. Strukturalisht poezia ka një ndërtim magjik sepse pavarësisht një ndarje të tillë duket sikur çdo varg kuptimisht qëndron edhe më pranë me vargun më të largët të mundshëm. Vargjet dyshe në fund të çdo pjese janë një përmbledhje ndjesish të dhëna nga subjekti lirik, ndërkohë pjesët e tjera të krijojnë idenë e përshkrimeve të një natyre objektive. Megjithëse në poezinë e Zorbës është tejet e vështirë të hasësh përshkrime të thella e të detajuara të natyrave konkretizuese dhe objektivizuese. Por ndryshimi midis një qëndrimi objektiv dhe subjektiv gjendet. Aty ku ndjeshmëria është e thellë aq sa në vargje kemi vajtim, lot, dhe ngashërim, notat e ulëta shoqërojnë poezinë në të gjithë vargjet. Thuret një himn, duhet një i tillë që kërkohet në fillim të poezisë, himni i cili simbolizon lëvdatën dhe lartësimin. Mund të jetë himn për rininë, për vlerat e saj, kujtimet e risjellin atë me myshkun që të përqeth. Për sa i përket muzikalitetit, poezia mbart nota melankolie dhe tinguj të ulët. Duket sikur shtrirja e ritmit krijohet nga dy zëra, ku njëri është më i shuar, i qetë dhe i gjatë, ndërsa tjetri më i shkurtër, më

i shpejtë dhe më i fortë. Por ndërthurja midis tyre është aq e qëndrueshme dhe harmonike sa krijon një bukurtingëllim. Kjo pasi vetë vargjet e poezisë jepen në një strukturë të tillë dhe të krijojnë mënyra të tilla vetëreferuese nga stili krijues: “Në formë koncerti fantastik e muzikalisht absurd, na vjen *Parte concertante*.”

Poezitë e Zorbës me tema muzikore nuk e kanë një fabul. Ky projekt artistik na kujton Orkestrale e Ravel-it, Bolero (1928), për të cilën ai tha se po mendon për “një poemë simfonike pa një subjekt, ku i gjithë interesi do të jetë në ritmin”. Zorba e konsideron këtë koncert “muzikalisht absurd”, mirëpo brenda “absurditetit të muzikës ka arritur harmonië, çka tregon aftësi teknike në rritje të Zorbës në relacion me mjete e mënyra të korporimit të muzikës në veprën e tij. Ky lloj absurdi muzikal disi na ndër mend Ravelin, pjesët e tij që kanë të bëjnë me vështirësitë e balancimit të pianos me perkusion me tingujt e qëndrueshëm të violinës dhe violonçelit. Përzierja e elemente të ndryshme në një gjuhë artistike që është në mënyrë të padiskutueshme veçanësi nga stili i tij.”²⁹

Zef Zorba ka krijuar në “Mbresat e rrugëve” katër poezi të cilat përveç titujve që janë: *Kadenca e ksilofon kumbonëve*, *Kadenca e fagotit – Ballateta-*, *Kadenca e violës*, *Kadenca e Instrumentave me perkusion*, mbartin si nëntituj përkatësisht emërtimet e katër stinëve të vitit (*Pranverë*, *Verë*, *Vjeshtë*, *Dimër*).

Zorba shfaq një lidhje të qëndrueshme me *kadencën*³⁰, duke bërë zgjedhjen e duhur, sepse ajo lejon që të krijohen lidhje të shumëfishta konotimi, si me muzikën ashtu edhe me poezinë, një gjetje e duhur në shërbim të tekstit poetik që krijohet. Si një grup poezish të lidhura me një detaj tjetër domethënës për letërsinë, por edhe për artet e tjera. Koncepti dhe përfaqësimi i stinëve është paraqitur në mënyra të

²⁹ Isufaj, Viola, *Relacione muzikore në poezinë e Zef Zorbës*, në aktet e Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 2017

³⁰ Shih Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Akademia e Shkencave, Tiranë, f. 757

Kadencë: 1. (kup. muz.) kthesë në mbyllje të një fraze a periudhe muzikore; pjesa e koncertit që instrumentisti e luan me fantazi pa u shoqëruar nga orkestra; 2. (kup. let.) ritëm që përcaktohet nga mënyra e theksimit në vargjet e poezisë. 3. (kup. libr.) përsëritja e zhurmave, e lëvizjeve ose e goditjeve që vijnë rregullisht njëra pas tjetrës.

ndryshme nga artistë të mëdhenj botërorë por edhe shqiptarë, në forma dhe mënyra të ndryshme. Zorba ka zgjedhur t'i poetizojë ndjesitë e tij, përcjellja e të vërtetës dhe emocioneve është realizuar në një mënyrë të veçantë. Antonio Vivaldi ka kompozuar një nga kryeveprat e artit muzikor botëror, duke e emërtuar "Katër stinët". Zorba, i ndikuar nga madhështia e veprës së Vivaldit dhe nga shpirti i tij artistdashës, ka bërë një qasje të tillë. Elementet e stinëve jepen me detaje të zgjedhura: te poezia e parë *Kadenca e ksilofon kumbonëve (Pranverë)*: *Ditën e parë të pranverës..., gjethe të njomë..., brymë të ngrira..., gjelbërimin*. Te poezia *Kadenca e fagotit -Ballateta- (Verë)*: *tingujt marrin ngjyrë portokalli..., e njomë e po njëherëshi therse, një si puhi selvishë..., më të mbramet xixëllonja shashtisen*. Te poezia *Kadenca e violës (Vjeshtë)*: *prej shirokut kashturinat si mijëra fyej jehojnë..., rrugë e përmbytur... rrëqe të murrëme përcuan furishëm barëra, gjethe...* Te *Kadenca e instrumentave me perkusion (Dimër)*: *canar në vatër s'kërcëllen..., netësh me stuhi etj*. Lidhjet që krijohen midis këtij grupi poezish janë të brendshme dhe të shumëfishta, ajo çfarë ka mbetur enigmë në një poezi fillon të marrë kuptim në tjetrën.

Muzika, e lidhur aq ngushtë me shpirtin, është e vetmja që nuk e braktis dhe nuk e lë në baltë shpirtin e trazuar dhe pse gjithçka kishte krijuar mbeti thjesht një iluzion që u shkatërrua. Këto katër poezi, specifike për çdo stinë të vitit përkojnë me veprën e Vivaldit, sa i përket muzikalitetit dhe motiveve. I ndikuar prej tij, Zorba përvetësoi teknikat e muzikës, duke i personalizuar në poezinë e tij. Nëse Vivaldi nëpërmjet instrumenteve të tij solli në një mënyrë brilante një pjesë të natyrës, Zorba nëpërmjet fjalës përcjell natyralisht shpirtin dhe emocionet që mbart në çdo ngashërim dhe përvojë e tij. Nëse Vivaldi përcjell shushurimat e gjetheve dhe gurgullimat e ujërave të lumenjve, Zorba paraqet trazimin e shpirtit i unifikuar dhe me natyrën. Tek Vivaldi arrihet njësia e tingujve nëpërmjet kombinimeve të instrumenteve, ndërsa tek Zorba tingëllimi realizohet nga fjalët e zgjedhura dhe pranëvënia midis tyre krijon asosacione të reja. Zorba nuk ka synuar që në poezitë e tij të paraqesë peizazhe të pikturuara, ai sjell imazhe të zymta dhe plot kontrast, pasi synimi i tij është

bukurtingëllimi dhe magjia që përcjell tingulli. Ku në thelb të gjithçkaje dhe të vetë jetës qëndron ritmi dhe ndërthurja për krijimin e të bukurës.

Si përfundim, do të thoshim se në vëllimin poetik *Buzë të ngrira në gaz* dallon një sistem muzikor i ndërtuar nga: *ide muzikore; struktura muzikore; teknika në lojë instrumentesh; tinguj instrumentalë*. Në poezitë e ciklit “Fugat e fundit”, për sa i përket aspektit strukturor muzikor vihet re një prirje për të lidhur pjesët e ndryshme të veprës, me anë të një materiali të përbashkët muzikor, pra me anë të një teme muzikore që paraqitet në të gjitha kohët duke dhënë përshtypjen e unitetit mes tyre. Për sa i përket lojës së instrumenteve, te poezitë *Tema e ksilofon-kumbonëve* dhe *Tema e fagotit*, efekti që krijohet nga përkime zanoresh e bashkëtingëlloresh është i ngjashëm me tingujt që vijnë prej këtyre instrumenteve. Tingujt e instrumentaleve hasen më së shumti në ciklin “Mbresat e rrugëve”, që paraqitet si poemë, ndërsa për sa i përket pjesës ndërlëndore, muzikalisht kemi të bëjmë me një koncert instrumental, ku sinkronizohen njëra pas tjetrës pjesët: hyrje, zhvillim dhe mbyllje.

Poezia e Zorbës jo vetëm që vazhdon të mbetet një botë ku lexuesi mund të eksplorojë edhe më tutje, por ajo është një nxitje më shumë për të hulumtuar mundësitë shprehëse të gjuhës sonë. Veprat e tij kanë ende shumë për të dhënë, jo vetëm për mendimet, idetë, figurat, fuqinë e fjalës, por edhe në aspektin gjuhësor, për ndërtimin e frazës për unjisomi. Në këtë drejtim kritika jonë filologjike ka shumë për të bërë, për të përmbushur atë detyrë që i lind nga vetë vepra.

Bibliografi

- Chevrel, Yves. *Letërsia e krahastuar*, Puf, Tiranë, 2002
- Hamiti, Sabri. *Albanizma*, ASHAK, Prishtinë, 2009
- Isufaj, Viola, *Relacione muzikore në poezinë e Zef Zorbës*, në aktet e Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën shqiptare, Prishtinë, 2017
- Kadare, Ismail. *Parathënie, Buzë të ngrira në gaz*, Princi, Tiranë, 2010
- Kroce, Benedetto. *Estetika si shkencë e shprehjes dhe e gjuhësisë së përgjithshme*, Apolonia, 1998

- Prendi, Arben. *Tekste në kontekste*, Naimi, Tiranë, 2011
Rrahmani, Zenjullah. *Teori e letërsisë*, Prishtinë, 1996
Rrugova, Ibrahim. *Kritika*, ASHAK, Prishtinë 2007
Tole, Vasil. *Muzika dhe letërsia*, Onufri, Tiranë, 1997
Topçiu, Luan. *Tradita Moderne në letrat shqipe*, Zenit, Tiranë, 2010
Zorba, Zef. *Buzë të ngrira në gaz*, Princi, Tiranë, 2010

Kristiana Mihani

A SILVIA E G. LEOPARDIT, NË PËRKTHIMIN E Z. ZORBËS

*Çështje të përkthimit të teksteve të poetëve italianë,
nga Zef Zorba, në gjuhën shqipe*

Hyrje

Përkthimi ka meritën e komunikimit midis kombeve, kulturave të ndryshme dhe pa të, ky komunikim do të ishte i pamundur. Përkthimi është i lashtë, pothuaj sa vetë gjuha, e megjithatë, nuk ka ende një përkufizim përfundimtar për të. Ai është art më vete e si i tillë përkthyesit i lipset të zotërojnë njohuri jo vetëm të gjuhës, por edhe të kulturës nga e cila vjen ajo vepër.

Përkthimi i poezisë duhet thënë se cilësohet nga shumë studiues, gjuhëtarë e shkrimtarë, si tepër i koklavitur, e në disa raste edhe i pamundur. Ajo mund vetëm të rikrijohet e tjetërsuar. Kjo çështje do të kërkonte një studim tejte të gjerë e serioz për t'u realizuar në formën e duhur. Ne do të përqendrohemi te Giacomo Leopardi, me poezinë e tij *A Silvia*, për të vrojtuar se si e ka sjellë të përkthyer në gjuhën shqipe, Zef Zorba. Do të ndalemi në disa rrafshe: ideor, muzikaliteti dhe ai retoriko-metrik, duke i vrojtuar këto elemente si janë sjellë në gjuhën shqipe e duke i përqasur me tekstin origjinal.

Studimi është mbështetur, duke marrë si material parësor dorëshkrimet e Zorbës, të cilat të bijat m'i lëshuan nga biblioteka vetjake dhe të cilave u shpreh gjithë mirënjohjen time.

Ideja e Zorbës, kohët e fundit, sipas së bijës, Luçia, ishte "duke qenë se ai është marrë gjithë jetën me përkthimet e poetëve hermetikë", të bënte një përmbledhje dhe një antologji *del novecento dei poeti italiani* hermetikë e johermetikë.

A Silvia në përkthimin e Zef Zorbës

A *Silvia* e Leopardit, është përkthyer prej Zorbës nën titullin *Silvës*. Ky idil i njohur, është shkruar në Recanati, diku midis 19 dhe 20 prillit të vitit 1828 dhe shfaqet më pas në *Canti*, nën kujdesin e botuesit Piaddi di Firenze (1831). Poeti reflekton rreth palumturisë së pashmangshme të njeriut deri në shuarjen e shpresave. Gruaja, me vdekjen e saj të parakohshme, bëhet emblema e zhgënjimit dhe dhimbjes.

Boshti ideor mbi të cilin është ndërtuar poezia, sillet rreth dyzimit të ëndrrave rinore dhe realitetit që i këput ato, dhe e gjithë kjo realizohet përmes *Silvias*, e cila nuk është shëmbëlltë e vetëm e përjetimeve të saj, por shumë më tepër: atyre të poetit.

Silvia bëhet simbol i rinisë, i dashurisë, i pritjeve shqetësuese, i ëndërrimeve të paqarta, të ndërprera shumë shpejt nga vdekja, e cila zhbën të gjitha iluzionet. Në fakt, ajo që e bashkon atë me poetin, nuk është një histori e mirëfilltë dashurie, porse kushtet e njëjta të rinisë, përbërë prej shpresash dhe ëndrrash, të destinuara të jenë shumë shpejt zhgënjyese. Vdekja e *Silvias*, “rënia” e saj, pasqyrojnë edhe vdekjen e çdo shprese dhe iluzioni të poetit.

Është strofa e tretë, që flet më së miri jo vetëm për kujtimet rinore, por njëkohësisht nxjerr në pah lidhjen e poetit me *Silvian*.

Io gli studi leggiadri
talor lasciando e le sudate carte,
ove il tempo mio primo
e di me si spendea la miglior parte,
d'in su i veroni del paterno ostello
porgea gli orecchi al suon della tua voce,
ed alla man veloce
che percorrea la faticosa tela.
Mirava il ciel sereno,
le vie dorate e gli orti,
e quinci il mare da lungi, e quindi il monte.
Lingua mortal non dice
quel ch'io sentiva in seno.³¹

Un' nganjëher' studimet
bragtisja e letrat e dërsitura
tretjen e viteve rinore
unë t' mirën pjesë të jetës sime,
e prej ballkoni të shtëpisë atrore
jehon e zërit tënd vështroja,
e duart e shkathhta kundroja
përmbi pëlhurën e mundimshme.
Vështroja kthjellësinë e qiellit,
e rrugët e praruara e kopshtet,
e detin atje larg, e tutje malin.
S'ka goj njeriu q' e shpreh
Atë që ndjeja n' zemër.

³¹ Luperini, R., Cataldi P., Marchiani, L., Marchese, F. *Il nuovo manuale di letteratura*, G. B. Palumbo Editore, f. 835

Nga shembulli më lart, fjalët në të pjerrëta, tregojnë gjendjen e njëjtë të autorit dhe të Silvias: pas dritares së dhomës dhe bota jashtë ishte e largët, e këto fjalë, kështu, rievokojnë kujtimet. Përkthimi i kësaj ideje nga Zorba është bërë krejtësisht i plotë, duke përcjellë idenë e Leopardit.

Mirëpo, strofa pasardhëse, shfaq realitetin zhgënjyes që pret ëndrrat dhe jetën e re.

Che pensieri soavi,
che speranze, che cori, o Silvia mia!
Quale allor ci apparia
la vita umana e il fato!
Quando sovienmi di cotanta speme,
un affetto mi preme
acerbo e consolato,
e tornami a doler di mia sventura.
O natura, o natura,
perché non rendi poi
quel che prometti allor? perché di tanto
*inganni i figli tuoi?*³²

Sajime qiellore, sa shpresë
e zëra t'harmonishëm Silvja ime!
Se si na dukej jeta
e fati at'here!
Kur e kujtoj gjithë at'dëshirë të madhe,
zemrën diçka ma ndrydh
e thartë e pangushëlluar,
e mu në shpi ajo mënxyrë.
O natyrë, o natyrë!
pse nuk i mbanke kurrë
premtimet që ke dhënë?
si po gënjenke bijt e tu?

E gjithë strofa në realizimin në gjuhën italiane, por edhe përkthimi i Zorbës dukshmërisht paraqesin boshtin tjetër ideor. Përmes vargjeve të fundit të strofës, autori i thërret natyrës, në formë ankese për të padrejtat që i ka bërë. Sa i takon përkthimit të idesë në vetvete, çka në të vërtetë është edhe qëllimi i punimit, mund të theksojmë se kalimi i idesë në gjuhën shqipe, është bërë përmes frazash më të thjeshta, çka e lehtëson lexuesin në perceptimin e idesë leopardiane.

Fjala poetike - vagullnajë e fjalës

E gjithë poezia është e mbushur me paqartësi dhe nga ndjenja e papërcaktueshmërisë që për Lopardin, përbëjnë maksimalen poetike. Në fakt, në poezi nuk ka përshkrime dhe figura femërore nuk

³² Po aty, f. 835

pasqyron detaje konkrete dhe figura e Silvias është mjaft e paqartë. Elementet fizike apo reale janë vetëm një pikë fillese. E vetmja specifikë konkrete, e cila preket fare pak, është shikimi i qeshur dhe plot dritë, që në të njëjtën kohë, ndriçon fytyrën e Silvias, dhe nënvijëzon sjelljen e saj të shpërqendruar, por edhe reflektuese.

quando beltà splendea
negli occhi tuoi ridenti e fuggitivi,
e tu, lieta e pensosa, il limitare³³

kur sytë e tu gazmorë e plot mahi
mahniteshin prej hijeshisë,
e ti, me shend por pak e menduar përpjetje

Leopardi flet në mënyrë shumë të përgjithshme dhe vetëm për sytë e për mendimet e vajzës, pa treguar se ç'ngjyrë kishin apo karakteristika të tjera. Këtë paqartësi Zorba e ka ndjekur me përpikëri përmes përdorimit të duhur të mbiemrave që tregojnë fare pak.

porgea gli orecchi al suon della tua voce,
ed alla man veloce
che percorrea la faticosa tela.³⁴

jehon e zërit tënd vështroja,
e duart e shkathtë kundroja
përmbi pëlhurën e mundimshme.

Këtu poeti flet jo për karakteristika të veçanta, por për veprimet e Silvias dhe ndjesitë e tij, të cilat nuk mjaftojnë. Zorba po ashtu në përkthimin e poezisë, i ka qëndruar besnik dhe korrekt kësaj karakteristike mjaft të rëndësishme të Leopardit.

Po ashtu është i mjegullt dhe jo i qartë, edhe ambienti rrethues i karakterizuar vetëm nga pak mbiemra evokues: *quiete, odoroso, sereno, dorate*.

Sonavan le *quiete*
stanze, e le vie dintorno,
al tuo perpetuo canto,
allor che all'opre femminili intenta
sedevi, assai contenta
di quel vago avvenir che in mente avevi.

Sa fort jehonin kthinat
e paqte krejt rrethinat
nga kënga që s'të ndahej goje
kur ti me punë në dorë qëndroje
gjithaqë e shkujdesur
për të ardhmen e vagullt që mendoje.

³³ Luperini, R., Cataldi P., Marchiani, L., Marchese, F. *Il nuovo manuale di letteratura*, G. B. Palumbo Editore, f. 834

³⁴ Po aty, f. 835

Era il maggio *odoroso*: e tu solevi
Così menare il giorno.³⁵

...

Mirava il ciel *sereno*,
le vie *dorate* e gli orti,
e quindi il mare da lungi, e quindi il
monte.

Ish Maji *er'mirë* ahërë;
ashtu e kaloje ditën.

...

Vështroja *kthjellësinë* e qiellit,
e rrugët e *paruara* e kopshtet,
e detin atje larg, e tutje malin.

Poeti thotë vetëm se është pranverë, por nuk ka ndjesi të dallueshme. Ai përdor mbiemra të matur dhe fjalë evokuese, por nuk ka përshkrime të veçanta. Bota e jashtme është e privuar nga cilësitë fizike, çka Zorba e sjell edhe për lexuesin shqiptar përmes përdorimit të pak mbiemrave që tregojnë shumë pak.

Poezia është ndërtuar vetëm përmes filtrit të kujtesës që njëlloj si filtri fizik, i përfaqësuar nga dritarja, i bën imazhet të turbullta, pra, të paqarta dhe të padefinuara. Kjo dritare e kushtëzon kontaktin me realitetin duke i dhënë jetë imagjinatës. Gjithashtu, filtri i kujtesës, kontribuon në mënyrë vendimtare në shuarjen e iluzioneve, të cilat ndërpriten nga qetësia e së vërtetës.

d'in su i veroni del paterno ostello
porgea gli orecchi al suon della tua
voce,
ed alla man veloce
che percorrea la faticosa tela.

Mirava il ciel *sereno*,
le vie *dorate* e gli orti,
e quindi il mare da lungi, e quindi il
monte.³⁶

e prej ballkoni të shtëpisë atrore
jehon e zërit tënd vështroja,
e duart e shkathta kundroja
përmbi pëlhurën e mundimshme.

Vështroja *kthjellësinë* e qiellit,
e rrugët e *paruara* e kopshtet,
e detin atje larg, e tutje malin.

Përdorimi i foljeve

Në përpjesëtim të drejtë me idenë e mësipërme, është edhe përdorimi i kohëve të foljes. Kemi përdorimin e dy kohëve, të

³⁵ Luperini, R., Cataldi P., Marchiani, L., Marchese, F. *Il nuovo manuale di letteratura*, G. B. Palumbo Editore, f. 834

³⁶ Po aty, f. 835

pakryerës dhe të tashmes. Folja në të pakryerën, karakterizon strofat e kujtimeve të papërcaktuara të jetës rinore dhe dominon strofën e parë, të tretë dhe të pestë, të cilat evokojnë të shkuarën. E pakryera karakterizon çastet e kujtimeve, të ëndrrave rinore, dhe është koha e memories dhe iluzioneve.

Silvia, *rimembri* ancora
 quel tempo della tua vita mortale,
 quando beltà *splendea*
 negli occhi tuoi ridenti e fuggitivi,
 e tu, lieta e pensosa, il limitare
 di gioventù *salivi*?
 ...
 Io gli studi leggiadri
 talor lasciando e le sudate carte,
 ove il tempo mio primo
 e di me si spendea la miglior parte,
 d'in su i veroni del paterno ostello
porgea gli orecchi al suon della tua voce,
 ed alla man veloce
 che *percorrea* la faticosa tela.
Mirava il ciel sereno,
 le vie dorate e gli orti,
 e quindi il mare da lungi, e quindi il monte.
 Lingua mortal non dice
 quel ch'io *sentiva* in seno.
 ...
 Tu pria che l'erbe inaridisse il verno,
 da chiuso morbo combattuta e vinta,
 perivi, o tenerella. E non vedevi
 il fior degli anni tuoi;
 non *ti molceva* il core
 la dolce lode or delle negre chiome
 or degli sguardi innamorati e schivi,
 né teco le compagne ai dì festivi
ragionavan d'amore.

A të kujtohet, Silve, prap
 kohë e dikurshme e jetës sate,
 kur sytë e tu gazmorë e plot mahi
mahniteshin prej hijeshisë,
 e ti, me shend por pak e menduar *përperjetje*
 kufirin e rinisë?
 ...
 Un' nganjëher' studimet
bragtisja e letrat e dërsitura
 tretjen e viteve rinore
 unë t' mirën pjesë të jetës sime,
 e prej ballkoni të shtëpisë atrore
 jehon e zërit tënd *vështroja*,
 e duart e shkathta *kundroja*
 përmbi pëlhurën e mundimshme.
Vështroja kthjellësinë e qiellit,
 e rrugët e paruara e kopshtet,
 e detin atje larg, e tutje malin.
 S'ka goj njeriu q' e shpreh
 Atë që *ndjeja* n' zemër.
 ...
 Përpara se ta ngrinte dimri barin
 si prej lëngate t' zez sulmuar e mundur
 u thave, e njomë. E s' i gëzove
 lulet e tua të moteve;
 as *ta gazmonin* zemrën
 lëvdata për flokët e tu të zez
 as e për sytë e tu mahnitës e të tretur,
 as shoqet në asi di' kremtuese
 me ty, për dashuritë nuk *flisinin*.

Zef Zorba, gjithashtu, ka bërë një përkthim mjaft të mirë, jo vetëm me gjetjet e foljeve, por dukshmërisht edhe me përshtatjen e tyre në

kohën e poezisë origjinale, gjë që nuk është fort e lehtë duke llogaritur vështirësitë që ofron gjuha italiane, por edhe ajo shqipe njëkohësisht.

E tashmja karakterizon strofat e zbulimeve dhe konstatimeve, ku sintaksa është më e plotë dhe e pasur. Ajo mbizotëron në strofën e katërt ku autori i vihet kundër natyrës, e cila i mohon njeriut gëzimin. Sintaksa është e rregullt, me fraza të shkurtra.

Che pensieri soavi,
che speranze, che *cori*, o Silvia mia!
Quale allor ci apparia
la vita umana e il fato!
Quando *soviemmi* di cotanta speme,
un affetto *mi preme*
acerbo e sconsolato,
e tornami a doler di mia sventura.
O natura, o natura,
perché *non rendi* poi
quel che *prometti* allor? perché di tanto
inganni i figli tuoi?

...
Anche *peria* fra poco
la speranza mia dolce: agli anni miei
anche negaro i fati
la giovinezza. Ahi come,
come passata *sei*,
Cara compagna dell'età mia nova,
mia lacrimata speme!
questo, è quel mondo? questi
i diletti, l'amor, l'opre, gli eventi,
onde cotanto ragionammo insieme?
questa la sorte dell'umane genti?
All'apparir del vero
tu, misera, cadesti: e con la mano
la fredda morte ed una tomba ignuda
mostravi di lontano.

Sajime qiellore, sa shpresë
e zëra t'harmonishëm Silvja ime!
Se si na dukej jeta
e fati at'here!
Kur *e kujtoj* gjithë at' dëshirë të madhe,
zemrën diçka *ma ndrydh*
e thartë e pangushëlluar,
e mu në shpi ajo mënxyrë.
O natyrë, o natyrë!
pse nuk i *mbanke* kurrë
premtimet që ke dhënë?
si *po gënjenke* bijt e tu?

...
E nuk *vonoi e mejt*
dh'ajo shpres'që pata: fati
moteve t'mia ia paskëshin mohuar
rininë. Ah, si *u zhduke* ti,
si, mike e dhimbsur,
e moshës sime t're,
si shpresa që me lot e qava
kjo *qenka* bota? kaqë
gëzimet, dashurit', veprat e ardhmja,
për t'cilat kuvendonim kaq her?
ky *qenka* shorti njerëzor?
Posa arriti stina
si e mjerë re; e mortjen shakull
edhe në varr të ftohtë
Tregoje prej së largu.

Qartësisht nga foljet e evidentuara, Zorba ka përkthyer në mënyrë mjaft korrekte foljet në kohën e tashme, duke i qëndruar besnik, ideve që karakterizon këto strofa.

Përcjellja e sistemit metrik

Kjo është një poezi me strofa të lira dhe pa skema fikse metrike apo ritmike. I vetmi element i përsëritur, është vargu që mbyll strofën dhe rimon me një nga vargjet paraardhëse.

Silvia, rimembri ancora	A të kujtohet, Silve, prap
quel tempo della tua vita mortale,	kohë e dikurshme e jetës sate,
quando beltà splendea	kur sytë e tu gazmorë e plot mahi
negli occhi tuoi ridenti e fuggitivi,	mahniteshin prej hijeshisë,
e tu, lieta e pensosa, il limitare	e ti, me shend por pak e menduar përpjetje
di gioventù salivi?	kufirin e rinisë?

Në shqyrtim të poezisë së përkthyer, që duhet ta theksojmë herë pas here se pikërisht përkthimi është qëllimi i kësaj trajtese, vetëm strofa e parë ka ndjekur këtë rregull. Strofet e tjera e ndjekin rregullin vetëm në gjuhën origjinale, ndërsa në shqip sillen ndryshe.

Në strofën e dytë, rimës *giorno / dintorno* i qëndron përkthimi *ditën / rrethinat* që nga ana tjetër rimon me vargun e parë (*kthinat / rrethinat*).

Në strofën e tretë, rimës *seno / sereno* i qëndron përkthimi *zemër / e qiellit*. Ndërsa në strofën e katërt, rimës *tuoi / puoi* i qëndron përkthimi *e tu / kurrë*.

Në strofën e pestë, rimës *amore / core* i qëndron përballë përkthimi *flisnin / zemrën*. Ndërsa në strofën e fundit, rimës *lontano / mano*, i qëndron përballë përkthimi *largu / shakull*.

A *Silvia*, alternon lirisht shtatë- dhe njëmbëdhjetërrokshin, të cilët ndjekin njëri-tjetrin pa një skemë fikse apo të njohur si model më parë. Shtatërrokëshi ka përparësi ndaj njëmbëdhjetërrokëshit, specifikisht 34 shtatërrokësh dhe 29 njëmbëdhjetërrokësh, të cilët pjesërisht janë bartur edhe në poezinë e përkthyer.

Qëllimi i këtij punimi nuk është të analizojmë veçmas se si ka ardhur i bartur metri në përkthimin shqip, si rrjedhojë, nuk do të

ndalemi në analizën e secilit varg. Por nga analiza e përgjithshme e poezisë, arrijmë në përfundimin se metri është përgjithësisht i njëjtë, me ndonjë papërputhshmëri. Që muzikaliteti i përgjithshëm dhe ritmi themelor i poezisë të ruhet, e mbi të gjitha që të bëhet e mundur përkthimi i duhur i fjalëve, sidomos kur kuptimi i tyre semantik ka një peshë mjaft të lartë sa i takon reflektimit të idesë kryesore të poemës, disa bartje, do të anashkalohen apo nuk do të vijnë të plota.

Figurat retorike

Si pjesë integrale dhe mjaft të rëndësishme të poezisë do të shqyrtojm, gjithashtu, edhe disa nga figurat retorike më të përdorua, duke parë kështu bartjen e tyre përgjatë përkthimit nga Zef Zorba:

Apostrofa

*Silvia, rimembri ancora*³⁷

...

Che pensieri soavi,
che speranze, che cori, o *Silvia mia*!

Quale allor ci apparia
la vita umana e il fato!

Quando soviiemmi di cotanta speme,
un affetto mi preme
acerbo e sconcolato,
e tornami a doler di mia sventura.

*O natura, o natura,*³⁸

A të kujtohet, *Silve*, prap

...

Sajime qiellore, sa shpresë
e zëra t'harmonishëm *Silvoja ime*!

Se si na dukej jeta
e fati at'here!

Kur e kujtoj gjithë at' dëshirë të madhe,
zemrën diçka ma ndrydh
e thartë e pangushëlluar,
e mu në shpi ajo mënxyrë.

O natyrë, o natyrë!

Apostrofa zë një vend shumë të rëndësishëm në poezi, në komunikimin e poetit me Silvian, pra, me të shkuarën dhe kujtimet, dhe thirrjen prej inati që i bën natyrës së padrejtë, bartje që në gjuhën shqipe, Zef Zorba e ka bërë mjaft mirë.

Metonimia

Io gli studi leggiadri

Un' nganjëher' studimet

³⁷ Luperini, R., Cataldi P., Marchiani, L., Marchese, F. *Il nuovo manuale di letteratura*, G. B. Palumbo Editore, f. 834

³⁸ Po aty, f. 835

talor lasciando e le sudate carte,

bragtisja e letrat e dërsitura

Në këtë shembull metonimik, kemi rastin e konkretes për abstrakten. Letrat e djersitura, simbolizojnë studimet që kryente Leopardi, dhe siç duket dhe nga shpjegimi në shqip, transmetimi nga italishtja është bërë mjaft i saktë dhe i pastër.

ed alla man veloce
che percorrea la faticosa tela.

e duart e shkathta kundroja
përmbi pëlhurën e mundimshme.

Këtu, bëhet fjalë për të qëndisurit, edhe një herë, kuptimi ka kaluar i drejtë, në mënyrën e duhur.

*Lingua mortal non dice
quel ch'io sentiva in seno.*

*S'ka goj njeriu q'ë shpreh
Atë që ndjeja n' zemër.*

Duhet të kuptojmë përdorimin metonimik për të shprehur konceptin e njeriut që jeton, që është gjallë ndryshe nga Silvia e vdekur. Qartazi, Zorba ka bërë një punë të përsosur sa u takon gjetjeve metonimike në përkthimin e poezisë.

Inversioni

*ove il tempo mio primo
e di me si spendea la miglior parte,*

tretjen e viteve rinore
unë t'mirën pjesë të jetës sime,

Me qëllim arritjen e efektit muzikor të dëshiruar, Leopardi ka përdorur edhe inversionin dhe Zorba, mjeshtërisht e ka vënë atë në strukturën e poezisë së përkthyer.

Anafora

*Che pensieri soavi,
che speranze, che cori, o Silvia mia!*
...
*perché non rendi poi
quel che prometti allor? perché di
tanto
inganni i figli tuoi?*
...

Sajime qiellore, sa shpresë
e zëra t'harmonishëm Silvja ime!
...
pse nuk i mbanke kurrë
premtimet që ke dhënë?
si po gënjenke bijt e tu?
...
kjo qenka bota? kaqë

*questo, è quel mondo? questi
i diletti, l'amor, l'opre, gli eventi,
onde cotanto ragionammo insieme?
questa la sorte dell'umane genti?*

*gëzimet, dashurit', veprat e ardhmja,
për t'cilat kuvendonim kaq her?
ky qenka shorti njerëzor?*

Sa u takon anaforave, mund të kemi bartje vetëm në shembullin e tretë. Është e rëndësishme të evidentohen edhe rastet kur një element i poezisë origjinale, nuk kalon në atë të përkthyer, dhe kjo është shumë normale, për mjaft faktorë, të cilët i kemi thënë edhe më sipër.

Metafora

*il fior degli anni tuoi;
non ti molceva il core*

*lulet e tua të moteve;
as ta gazmonin zemrën*

Metafora e përdorur në kuptimin “lule e rinisë”, pra vajza ishte në kulmin e rinisë së saj. Bartja e kuptimit metaforik, është transmetuar plotësisht në poezinë e përkthyer nga Zorba.

*la giovinezza. Ahi come,
come passata sei,
Cara compagna dell'età mia nova,*

*rininë. Ah, si u zhduke ti,
si, mike e dhimbsur,
e moshës sime t're,*

Kuptimi metaforik indukon shpresën për një jetë të re të së ardhmes, dhe edhe një herë, kuptimi ka kaluar i plotë.

Si përfundim, do të thoshim se në punën e tij si përkthyes, Zef Zorba nuk ka bërë vetëm gjetjen e fjalëve barasvlerëse në faqet e një fjalori dygjuhësh, pasi përkthimi duhet të përfshijë jo vetëm zëvendësimin e barasvlerësve gjuhësorë, por edhe atë të barasvlerësve emocionalë. Ndër rreziqet që krijon përkthimi i poezisë së një tjetër gjuhe, është humbja e poetikës. Në të dyja përkthimet e Zorbës, themi bindshëm se kjo nuk ndodh. Përkundrazi emocioni i poezisë origjinale, na vjen i plotë në një gjuhë që ne e njohim më mirë.

Përmes një përkthimi më modern e me fjalë të thjeshta, lexuesi shijon dhe përthith poetikën që bartin poezitë. Bartja e poezive në

shqip, vjen me disa humbje të vogla, përgjithësisht aty ku autori duhet të gjejë një rrugë të mesme mes kuptimit semantik të fjalëve, dhe tingëllimit të tyre për të ruajtur të pandryshuar muzikalitetin e poezisë. Zorba ka arritur të zgjedhë fjalët e duhura dhe gjuhën figurative, pa lënë pas edhe krijimin e kujdesshëm të ritmit, të rimës, të metrit, të shprehjeve dhe të strukturave specifike, që mund të mos përputhen me ato të gjuhës së përditshme, por përputhen me gjuhën poetike të poezisë.

Nga ana tjetër, lexuesi shqiptar, përfshihet në po të njëjtin pikëllim që i serviret atij italian, përmes poezisë së Leopardit. Sa u takon elementeve specifike, si për shembull, muzikaliteti, Zorba ka bërë një punë të shkëlqyer me gjetjet, shumica prej tyre dialektore, duke rikrijuar në mënyrë të përpiktë tingujt e brendshëm të poetëve italianë, që do të thotë se teksti i përfutur nga përkthimi i Zef Zorbës, është në vetvete një rikrijim poetik.

Bibliografi

Luperini, R., Cataldi P., Marchiani, L., Marchese, F. *Il nuovo manuale di letteratura* 2, G. B. Palumbo Editore

Luperini, R., Cataldi P., Marchiani, L., Marchese, F. *Il nuovo manuale di letteratura* 3, G. B. Palumbo Editore

Dorëshkrime të pa botuara të Zef Zorbës

Buçpapaj, Ukë. *Përkthimi poetik*, Botim i akteve të konferencës shkencore ndërkombëtare, UT F.Gj.Huaja, Tiranë, 2009

Frost, W. 1969. *Dryden and the Art of Translation*, New Haven, CON: Yale University, Press

Holmes, J. 1970. *The nature of Translation: Essays on the Theories and Practise of Literary Translation*, Mouton

DUALITETI DHIMBJE-DASHURI NË POEZINË *GURI I ZI**Guri i zi*

*Ti pate zbritur prej majash të vrenjtura
Mendueshëm e duke u zvarritur,
Si korb i zi, me flatra të cunguara,
Një vaj të mekur me lëshue.*

*Do kthehem prap një natë
së bashku me ty me heshtë,
pse fatet vetmitare na afrojnë.*

*Isha i ri:
im' atë, i zymtë e zemërplasur,
mbi ty i pushonte sytë e bardhë e të përlotur
e kuvendoni gjatë.*

*(Biseda e juaj e fshehtë,
me ritme të nëndheshme,
krejt mishrat m'i rrënqethe!
Dhe strukesha i drojtur
Ndër dashuri vezulluese.)
Ashtu si im'at
Unë do vij prap një natë
Me heshtë me ty
Pse fatet na afrojnë.*

Në poezinë *Guri i zi*, Zorba krijon trinomin *at'-gur-bir*, një marrëdhënie komplekse dhe e pandashme, brenda së cilës guri ka po të njëjtën peshë dhe vlerë si për të atin ashtu dhe për të birin.

Epiteti *i zi* identifikohet me kujtimet për të atin, por edhe me marrëdhënien *at'* dhe *gur*, e këtë marrëdhënie me gurin poeti e

trashëgon nga ati dhe e përjeton po ashtu si *ai*. Guri është i zi, por sytë e të atit që e vështrojnë janë të bardhë, biseda e tyre zhvillohet me ritme të nëndheshme që ia rrëqethin mishin, por kjo në sytë e poetit duket sikur përjetohet *ndër dashuri vezulluese*. Biseda e gurit të zi dhe atit të tij është e fshehtë, pra, ajo është në njëfarë mënyre e koduar, por përballë një njeriu që në këtë rast është ati, ndodhet një kuvendues i pagojë; si mund të kuvendohet ose bisedohet vërtet me një gur?

Guri i zi mund të merret si një varr, e në këtë përfytyrim, ai është një ndërmjetës një herë i birit të vdekur e atit të gjallë (dikur) e tanimë i birit të gjallë (pra, djalit tjetër që është rritur – zëri i të cilit flet në këtë poezi) dhe atit të vdekur (sepse kanë kaluar kohë dhe ai është larguar nga kjo botë), pra guri është një ndërmjetës, në një plan më të gjerë, mes jetës dhe vdekjes.

Guri bëhet simbol për *atin* dhe *birin*: ati i tij ka kuvenduar e biseduar me gurin në fshehtësi, komunikimi, pra, është realizuar midis dy botëve asaj të gjallë dhe asaj të vdekur. Tani është radha e të birit të vendosë ose të krijojë marrëdhënien me gurin e vetmuar, por kësaj here jo si formë kuvendimi, por si heshtje që i afron fatet e tyre vetmitare. Këtë mungesë ose boshllëk (që nënkupton komunikimin/dialogimin) midis tyre duket se e mbush moskomunikimi me anë të fjalëve. Ashtu siç i bashkon fati i tyre i vetmisë, po në të njëjtën mënyrë i lidhin dhe kujtimet pasi kuvendimi apo marrëdhënia që ka pasur ati i tij me gurin e zi, është ngulitur thellë në kujtesën e tij në vogëli. I vogli i rritur, që tashmë vetëdijshtëm apo pavetëdijshtëm mbetet në këtë marrëdhënie, duket sikur kërkon ta vazhdojë atë.

Guri i zi bëhet njëherësh edhe dhimbja edhe dashuria e poetit: dhimbje që i kujton të atin dhe dashurinë, si i vetmi objekt më i afërt që e lidh me të, por kjo dhimbje dhe dashuri ndodhet gjithmonë dhe në mes të marrëdhënies *at'* dhe *gur*. Kujtesa e tij e kthen pas në të shkuarën, kërkon të plotësojë mungesën dhe, si pasojë e saj, e ndien të nevojshme për një përqendrim të heshtur; në rastin e poezisë sonë krijon idenë se e kërkon heshtjen me gurin, por ai përbrendësohet në të, ai shkrihet në po të njëjtën boshësi si guri, pra, ai bëhet një dhe i

vetëm me objektin e gurit. Poeti e bën edhe pjesë të komunikimit gurin, i drejtohet atij *së bashku me ty me heshtë*, e kthen në një bashkëveprues dhe poeti ndjek rrugën e të atit këtë takim me gurin e zi. Këtë i duhet ta bëjë natën, ndaj dhe zëri që flet në këtë poezi kërkon ta ruajë fshehtësinë. Nëpërmjet fshehtësisë dhe vetmisë, ai kërkon të ndërtojë ose të projektojë botën e tij të brendshme, të lënduar dhe vetmitare, mbi gurin e zi dhe pikërisht natën, në terrin e zi dhe larg prej syve të askujt.

Një arsye fundamentale pse marrëdhënia *bir-gur-at* do të vazhdojë edhe me vetë poetin, është se ai vetë humb të birin dhe vendos po këtë komunikim me gurin. I njëjti objekt vendoset midis poetit dhe birit të vogël të humbur, guri i mundëson po këtë komunikim, pra, një fat i përbashkët *at' dhe bir*. Dhimbja që poeti mbart identifikohet me *gurin e zi, korbin e zi, i zymtë e zemër plasur*, ndërsa e vetmja dozë e mbetur nga dashuria vjen përmes kujtimeve, si përjetim i një dashurie vezulluese. Është e pamundur që një poezi e Zorbës të mos ketë diç ndriçuese, të mos njohë një vezullim, qoftë përmes kujtimeve.

Zef Zorba i vesh gurit veçori dhe karakteristika të njeriut, si p.sh., mendimin dhe veprimin, me anë të ndajfoljes dhe formës së pashtjelluar foljore: *mendueshëm duke u zvarritur*. Ky mendim e rëndon gjendjen e **njeriut gur**, që është vetë pamja e shpirtit, prandaj shpirti dhe zemra e tij pranëvihen me korbin e zi me flatra të cunguara. Dhimbja është një klithmë e shpirtit të heshtur, e cila nuk e gjen forcën për të dalë prej andej. Shprehja e saj e vetme është vaji i mekur që ai lëshon. Heshtja dhe mbajtja mbyllur e dhimbjes i jep atij përmasat e rënda të një guri që do ta rëndojë gjithë jetën qenien e tij dhe fati i gurit do të bashkohet me atë të poetit si dy jetë paralele të një dhimbjeje të përbashkët.

Guri do të jetë gjurma e përhershme e dhimbjes, objekti i dëshmisë, ngulitja e përjetimeve të dhimbshme dhe e vetmisë – një element që duron, përballon mbishtresime të dhimbjeve që janë derdhur mbi të, që kupton vetminë, fjalën e heshtur, dhe që, do të jetojnë gjatë, për të kujtuar dashurinë dhe çastet e lumtura të përjetuara – për t'i përcjellë të gjitha këto në të ardhmen.

Objekti *gur* bëhet bashkëshoqërues i të dyjave, i *dhimbjes* dhe i *dashurisë* dhe i njeh mjaft mirë specifikat e tyre. Krijimi i këtij paradoksi, ku guri është i zi, por dashuria është vezulluese, ku terri ndriçohet nga drita, ku e zymta bashkëjeton me të bardhën dhe ku nata ndriçohet nga dashuria, mund të kuptohet si pjesë që përplotësojnë njëra-tjetrën. Heshtja ose lënia e gjendjes pezull është dinamike, ajo arrin të flasë, të dëgjojë, të ndjejë, paaftësia e saj është më e lëvizshme se vetë procesi i lëvizjes. Kjo heshtje është e qëllimtë përpara fakteve që shpalos vetë poezia, duke bërë që objekti i gurit të minimizojë elementet që shprehin gjendjen e dhimbjes, madje ato e fshehin të vërtetën.

Shumëfishimi i kuptimeve synohet të arrihet përmes heshtjes në mënyrë që t'i lërë vendin një leximi të pakufishëm, shtimi i mundësive dhe i zgjedhjeve për interpretime (krijimi i mjegullës semantike). Mjegulla semantike e shkëput objektin e gurit nga realiteti i zakonshëm, ku ai ndodhet, duke e ridimensionuar në të tjera aspekte të perceptuara nga një shumëllojshmëri lexuesish. Në këtë çast zë fill *suggestionimi*, Zorba nuk e thotë plotësisht mendimin e tij, por e lë atë në dorë të lexuesit për gjetjen e pjesëve të mozaikut dhe për t'u plotësuar prej tij për arritjen e një forme të lartë abstragimi. Vështrimi i poezisë së tij nga kjo optikë u lë vendin një sërë interpretimesh të shumëfishta, lënia përgjysmë, pezull dhe mungesa e strukturës lidhëse. Struktura e papranishme që është *e fshehur dhe e heshtur*, është e vetmja që të bëjë zbulimin e së vërtetës, kjo mungesë në poezi arrin të kulmojë mendimin vlerë, pra, në një formë të pashprehur. Objekti *gur* duket sikur i përket vetëm poetit, si objekt individual mbase që nga fëmijëria (*isha i ri...*), prandaj ai kërkon të ruajë dhe ta forcojë këtë raport, të cilin mund ta quajmë "pronë" të tij, e lënë nga i ati dhe tashmë e trashëguar prej birit të tij. Për të kjo është më se është e pranueshme edhe pse në të brendësohet edhe dhimbja, por edhe dashuria si bashkëshoqëruese dhe kujtime të përjetshme. Raporti i fshehtë i vendosur me gurin lë pezull njohjen e plotë të gjendjes që nuk mund të ndahet se çfarë është, mund të jetë dhimbje, dashuri ose dashuri dhe dhimbje njëkohësisht?! *Guri* mbart

në vetvete një gjuhë specifike, edhe pse një gjuhë memece e heshtjes flet me hamendje për të mbushur hapësirën ose strukturën në mungesë. Zbritja e gurit prej majave më të larta është njëkohësisht dhe një lloj zbritje me destinacion shpirtin për të zbuluar në të dhimbjen dhe dashurinë, kjo pamje e parë nga sytë e poetit kërkohet me ngul të përsëritet me të njëjtat ritme.

—●● Anjela Velia

DYSIA DHIMBJE-SHPRESË NË POEZITË QOKTHI, EJA ME NE

Kënaqësia që merr nga një poezi, të cilën e ndesh për herë të parë, nganjëherë bëhet dhe shtysa kryesore për ta studiuar atë. Kjo gjë të ndodh me ato poezi, vlera estetike e të cilave i reziston kohës dhe pret lexuesin e specializuar, me ato poezi që mbeten në sirtar për një farë kohe me qëllim që të rrëzëllejnë më pas. Kureshtja për të studiuar një vepër të tillë, si dhe kënaqësia që më dha teksta e lexova për herë të parë, u bënë shtysat themelore për të marrë në studim një poet, Zef Zorbën, sa të shquar po aq dhe të pashquar, në kuptimin që vepra e tij nuk është e studiuar aq sa e autorëve të tjerë. Poeti, për hir të artit, është përballur me pjesën më të vështirë të një krijuesi, të qenit “i padukshëm” (ka shkruar, por nuk ka botuar, ndaj veprat e tij mbeten në sirtar; duke u përballur me dramën e mungesës së lexuesit.)

Nëse do të përdornim termat e U. Ekos, mund të themi se kemi të bëjmë me një shkrimtar model, që gjatë krijimit ka përfytyruar lexuesin model, për të cilin ishte i vetëdijshëm se do të vinte vetëm atëherë kur vepra e tij do të reshtte së quajturi letërsi e sirtarëve. Është fjala për një poet, që ka jetuar në periudhën e komunizmit, në periudhën e ndryshimeve të mëdha të statusit të artistit, në periudhën ku gjithsecilit i duhej të gjente forma “arratie” në artin e tij, të cilat do të endnin më pas unin poetik. Zorba zgjodhi të shkruajë në fshehtësi, zgjodhi t’i flasë lexuesit të së ardhmes, duke u vlerësuar nga kritikët si një nga përcaktuesit emodernitetit të vargut shqip bashkëkohor.

Lind nevoja të flasim diçka për jetën e një personaliteti të shquar si Zef Zorba, por sigurisht do flitet për aq sa jeta hedh dritë mbi veprën e tij. Këto dy ndjenja kaq të kundërta, që i gjejmë në poezitë e marra në shqyrtim, e kanë ndjekur këtë personalitet gjatë gjithë jetës. Si shumë të tjerë, Zorba është intelektual që pati fatin e keq të jetonte në epokën e errët të diktaturës shqiptare, por dashuria për jetën e mbajti

atë gjallë. Edhe në poezitë e tij, bën po të njëjtën gjë, në mes të vuajtjeve dhe të shpresës, zgjedh me vendosmëri të plotë shpresën, dritën, dashurinë.

Me vëllimin poetik *Buzë të ngrira në gaz*, lexuesit i bëhet e mundur të përfytyrojë një njeri që dashuron dritën, harmoninë, muzikën, ngjyrat e, mbi të gjitha, përfytyron një njeri që zgjedh të jetojë pavarësisht gjithçkaje.

Në poezitë *Qokthi* dhe *Eja me ne* do të analizojmë funksionin e kujtesës, përdorimin e elementit të dritës, por mbi të gjitha do të fokusohemi tek kundërvënia dhimbje- shpresë, për të nxjerrë në pah triumfin e shpresës, të dashurisë për jetën, që është më e fortë se çdo vuajtje.

Qokthi

“Në dendësinë e murrme të çinarit

heshtjet qyqare shqetësohen

e në shtëpitë e mënjanuara

ngashërimi bën dritën m’udridhë

e erë

e shi papra.

Për ato netët e Prillit

rishtas po ngjallet kujtesa:

vazhdimësi,

zemër që heq të shkoqet

prej flakësh të pabesa,

Por fjala ngrinë në gojë.

Prap mbeta vetëm, e dashur,

me murmuritjen e përveuajtur

të rrëkeve nëpër vija.

Strukur në errësirë, përmbi pullaze

daca thatiqë e të kërleshur,

melankolikë kotullohen,

e nëpër rrugë përhapet

erë kubule të fërguar

teha që natën shporojnë,
e shfrime.
Por diç njëherë gufon në gji
e m'jepet një buzëqeshje me ia prirë
çdo drite motër
që shuhet."³⁹

Vargu i parë i poezisë na sjell ndër mend një temë shumë të rëndësishme letrare për këtë personalitet, kujtesën⁴⁰, në rastin konkret kujtesën dokumentare.

Në dendësinë e murrme të Çinarit

Siç mund të vërejmë, poezia nis me përshkrimin fizik të një vendi, (i cili përbën pa dyshim një detaj mjaft të rëndësishëm për zbërthimin e mëtejshëm të saj), për të kaluar në një përshkrim ndjesor, në vargun e dytë. Metafora e përdorur në këtë varg është paraprijëse e dhimbjes që shfaqet në vargjet pasardhëse: *e në shtëpitë e mënjanuara / ngashërimi bën dritën m'udridhë*. Vargjet në vijim na dëshmojnë se kjo gjendje e rënduar shpirtërore është në sinkronizim me natyrën; *e erë/e shi pa pra*. Nuk mund mos të na bjerë në sy, në këtë strofë, përsëritja e lidhëzës bashkërenditëse shtuese -e-në fillim të vargjeve 3,5,6; përsëritje që krijon përshtypjen e shtimit dhe të rritjes graduale të dhimbjeve, që e kanë fillin e tyre në vargun e parë.

³⁹ Zorba, Zef, Buzë të ngrira në gaz, Princi, Tiranë, 2010, f.30-31

⁴⁰ Shih: Isufaj, Viola, *Të gjitha mitet kishin vdek*, f. 1-2.

Sipas studiueses V. Isufaj, kujtesa në korpusin e Zorbës del kryesisht në dy modele të dallueshme, të cilat shpesh ekzistojnë edhe njëkohësisht në të njëjtin tekst, si një mjet për të ngulitur një ndjenjë nostalgjie; nga ana tjetër edhe më universalisht, si një mënyrë për ndërtimin e identitetit individual, historik, kulturor. Jo rrallë, thekson studiuesja, në tekste të njëjta dallojmë shfaqje tjetër të kujtesës, atë dokumentare. Në shënimet që shoqërojnë vëllimin *Buzë të ngrira në gaz*, Zef Zorba ndalet në dukuri, vende e ngjarje e njerëz të njëmendtë, të shfaqur në poezitë e tij të cilët i ngulit në memorien kolektive. P.sh.: termi *Çinari*, i përdorur në vargun e parë ka kuptimin e rrapit të madh të varrezat katolike, ku janë varur e pushkatuar të dënuarit politikë.

Dy vargjet e para të strofës së dytë: *Për ato netët e Prillit/rishtas pongjallet kujtesa*, na sjellin ndër mend një tjetër mënyrë të shfaqjes së kujtesës në veprën e Zorbës, atë të nostalgjisë. Përmes kësaj strofe, ne përfytyrojmë, nga njëra anë ndjenjën e nostalgjisë për të shkuarën, për netët e një muaji, që është konsideruar si muaj i ringjalljes e, nga ana tjetër, vargjet në vazhdim, të ndërtuara me figurën e metaforës, krijojnë tek ne si lexues imazhet e vuajtjes, dhimbjes por edhe të një lloj sfide apo beteje për të mbijetuar, për t'ia dalë mbanë; *zemër që heq të shkoqet/ prej flakësh të pabesa*.

Vargu pasardhës na krijon idenë e dështimit në këtë luftë me flakët e pabesa; *por fjala ngrin në gojë*, metafora e përdorur në këtë rast, na përcjell idenë e pengesës, e mungesës së fjalës e njëkohësisht edhe të dështimit, humbjes së mendimit për t'u artikuluar. Vargjet në vijim na japin imazhet e vetmisë, por jo të një vetmie absolute; vetmia shoqërohet nga tingujt e ujit, ndonëse edhe ky lloj tingulli është melankolik: *me murmuritjen e përveuajtur/të rrëkeve nëpër vija*.

Në strofën pasardhëse kalohet përsëri në një përshkrim fizik, tashmë jo më të shtëpive, por të dacave që qëndrojnë përmbi pullaze, përshkrim që bëhet përmes mbiemrave *-thatiqë, të kërleshur, melankolikë-* për të kaluar në një përshkrim ndjesor, ku vihet në veprim shqisa e të nuhaturit e për ta mbyllur në fund me dhënien e imazhit fizik - *teha që natën shporojnë/ e shfrime*. Kjo strofë na jep mënyrën se si ka ardhur dhimbja, në fillim përmes të vëzhguarit, më pas përmes të ndjekurit, e në fund fare, dhimbjen fizike e vuajtjen prej saj.

Strofa e fundit përcjell idenë e mosdorëzimit, idenë e shpresës për t'ia dal mbanë, pavarësisht dritave që shuhen. Vëmë re që shpresa në këtë poezi mund të paraqitet edhe me anë të një kurbe, e cila në fillim është e rënë (strofa e parë), ngjitet (2 vargjet e para të strofës së dytë), ulet (strofa e tretë), por kurrë nuk humbet (strofa e fundit).

Eja me ne

Derën teksa e çele

por drita brenda nuk hyri.

Në pikëllimin e dhomës së murrme
gazi yt mërgohet i plogët;
të zverdhët fytyra kujtimesh
si ditë e trishtë nëntori.
(Ah atasy të vakët
ku ndeshen tash agime t'mekura!)

Derën teksa e çele,
por terri jashtë nuk doli.
Me vozitje të ngathët
mendimet shakull po të struken
ndër varret larg, pìrgje shtrigane,
që zemrën ta kanë zatetë
e nuk ta lanë
me pa me sy,
gojën m'e çelë me këngë.
Ti s'don të jetosh me ne.
A sheh si pika e zhegut
dëshirat na i përcëllon?
Si thahemi dushk për një dashuri
kur diku tutje nisë e flakëron
vetëtimat vetmitare?
(sa kem kaluar kështu shtigjesh!)

Ngeshëm nuk bën me vdekë.
E di? Dimrash që shkuan
sa mbetën rrugësh prej nesh:
i kaltërti thellim ua ngrinte buzën në gaz.
Ti qan. Të vika era mort:
ai që ti doje të la qyqare.
Eja, eja me ne.
Brejmë hekur ne me dhëmbë,
kërkojmë,
pëlcasim, -lajnë faqet tona lot e gjak?
ani, kërkojmë.
Dhe e dijmë: ku shuhet melankolia
e heshtet mjerimi,

*atje zë fill jeta vigane,
jeta pa kob,
flakë,ëndërrtare,
me dëshirë paqe të thepisur,
dëshirë e vrazhdët për dreq.
Gjëmon hare prej gjoksesh tona
mbuluar me plagë.⁴¹*

Në strofën e parë vihet re një përdorim i dendur i fjalës *dritë* (*drita* *çel*, *agime t`mekura*), por në këto raste është *dritë* që po shuhet, që shkon drejt mekjes. Antiteza e përdorur në dy vargjet e para të strofës së parë përkon me antitezën e përdorur në dy vargjet e para të strofës së dytë, pra kemi:

*Derën teksa e çele por drita brenda nuk hyri
përkundrejt:
derën teksa e çele por terri jashtë nuk doli*

Figura e antitezës thekson kundërvënien *dritë-errësirë*; shpresë – dhimbje; jetë- vdekje. Kemi të bëjmë me një krijim me përmasa filozofike të dukshme, me një poezi që përcjell dramën e vazhdimësisë së jetës, triumfit të shpresës, pavarësisht gjithçkaje, duke përfshirë këtu edhe humbjet.

Siç vërehet edhe në këtë poezi, nuk mungojnë notat melankolike, por mbyllja përngjet me hapjen, pra me ftesën për të jetuar, duke artikuluar idenë se jeta vazhdon e duhet të vazhdojë hareshëm, sepse gjithmonë pas vuajtjeve ka lehtësim, pas trishtimit hare. Është natyra kontradiktore e jetës që ta dikton pa fund diçka të tillë.

Tek të dyja poezitë e Z. Zorbës vërejmë përdorimin e fjalës kyçe – *dritë*-, por në dallim nga shumica e krijimeve, në të cilat *drita* paraqitet e plotë, shpresëdhënëse, në këto dy poezi, *drita* është drejt shuarjes. Përdormi i fjalës *dritë* në poezinë *Eja me ne*, në përfytyrimin e një kundërvënieje, të një lufte të vazhdueshme mes jetës dhe

⁴¹Zorba, Zef. *Buzë të ngrira në gaz*, Princi, Tiranë, 2010, f. 37-39.

vdekjes, mes dhimbjes dhe shpresës, i japin këtij krijimi përmasa filozofike.

Megjithëse drita në këto poezi nuk na paraqitet ashtu si te poezia *Baladë dritash për Lalin*, përsëri duhet përmendur fakti që ajo nuk shuhet plotësisht, çka na shpie në përfundimin se *drita* për Zef Zorbën ishte shtëpia e tij shpirtërore, burimi i shpresës.

Për dritat, Lam, desha të tham, që kam takue,

Me të cilat shoqnohesha gjithmonë,

Dritat që si i desha prap i due.

(poezia *Baladë dritash për Lalin*)

Fluturina Nurçe

NOCIONI I DRITËS: MES HERMETIZMIT DHE ORIGJINALITETIT

Zef Zorba, ndonëse për fat të keq mbeti për shumë gjatë një autor sirtarësh, është një nga poetët më të veçantë në llojin e tij, i cili krijoi një poezi vërtet risuese, moderne të një tjetër lloji e tjetër natyre. Kjo jo vetëm në formë, në strukturimin e saj, por dhe në brendi të poezisë, e pasur me një larushi të gjerë imazhesh, ngjyresash e nuancash muzikore të pandeshura më parë në krijimet poetike shqipe në përgjithësi e në atë moderne më specifikisht.

Krahas muzikës, ndikim të madh tek ai patën dhe shumë autorë të veçantë botërorë, sidomos hermetistët italianë. Vlen të theksohet fakti që ky ndikim mbetet më tepër në trajtën e një fryme sesa brendi sendërtuese dhe e patjetërsuar, pasi ai mbetet shumë origjinal e individual në përfatesën e këtyre ndikimeve e frymëzimeve.

Shumë prej procedeve artistike, po dhe motiveve, Zorba i mori kryesisht prej hermetikëve italianë, siç ishin: vetmia, ankthi, mbizotërimi i notave e ngjyrave të dëshpërimit, gjuha e errët dhe simbolike, e pasur me metafora e me lojëra imazhesh, thukësia, mungesa e shenjave të pikësimit etj., të cilat gjejnë përdorim në shumë prej poezive të tij.

Madje një element tjetër esencial i poezisë së Zorbës është *drita*, simbolika e së cilës shkon përtej përdorimit të zakonshëm, duke dalë një motiv e tematikë me karakter filozofiko-esencial, që ndër të tjera, bashkëpërkon me këndvështrimin e hermetikëve italianë.

Megjithatë tek Z. Zorba, dritën veçse si simbol, metaforë apo dhe si koncept metafizik e ndeshim dendur edhe tekstualisht si leksemë, të ngarkuar emocionalisht, me ngjyresa e nuanca origjinale të vetë poetit, çka shënjon njëherazi një përfatesë krejt individuale, të ndikimit

hermetik të tij. Gjithashtu, drita paraqitet dhe në aspekt të një kontrasti me të kundërtën e saj, *terrin*. Pranëvënja e të cilave veçse vërteton postulatit filozofik që *terri, gjysma e plotësisë, e bën dritën të dukshme, çon dhe drejt kuptimësisë së dritës si frymë hyjnore*, një përmasë tjetër kjo e dritës përtej asaj si shpëtim e fuqi dritëdhënëse.

Në poezinë *Eja me ne*, drita del si abstraksion për shpresën, për idealen që kërkon të arrijë, ndërsa mungesa apo mosdepërtimi i dritës përvijon mungesën e gëzimit, shpëtimit, ndriçimit e ndryshimit të gjendjes. Si e tillë, ajo ndiqet në strofë nga një sërë epitetesh, metaforash, ngjyresash e imazhesh, që e përforcojnë më tej këtë kahje shprese e fuqie dritëdhënëse të dritës, përmendim: *pikëllim, dhomë e murrme, gazi i plogët, të zverdhet fytyra, dritë e trishtë nëntori, sy të vakët, agime të mekura*.

Shohim se drita shënjohe e paraqitet në mënyrë thuajse konstante, në një paralelizëm me *terr*, natë, zymtësi e trishtim. Por *ky theksimi i territ, errësirës, e bën shumë më të thekshme fshehjen e dritës që shfaqet si buçimë* përballë këtij *terri* jo vetëm si objekt, si materie e prekshme prej syrit po dhe si frymë, duke i dhënë asaj përmasat e hyjnore. Drita, ku ai kërkon ndihmë, shpëtim, si dhe caku i fundit ku dëshiron të arrijë:

Derën teksa e çele,

por drita brenda nuk hyri.

Në pikëllimin e dhomë së murrme

gazi yt mëgohet i plogët;

të zverdhet fytyra kujtimesh.

si dritë e trishtë nëntori.

Derën teksa e çele, por terri jashtë nuk doli...

Këto vargje antonimike dëshmojnë se nuk bëhet fjalë vetëm për dritën fizike, pasi pavarësisht hapjes së derës, që metaforikisht mund të shihet si mjeti “pengus” i dritës, ajo sërish nuk futet brenda, nuk ndriçon mbi *terr*in në dhomë.

Kështu, drita nuk ia del të ngadhënjej mbi alteregon e saj. Nuk është aq pozitive pasi deri në fund, si duket subjekti tekstori mbetet i

pikëlluar e peng i mendimeve tepër të forta e të rënda, që kanë hedhur rrënjë trishtimi në zemrën e tij, por që sërish kjo nuk e zbeh aspak adhurimin e hyjnore të kjo dritë apo dhe dritën si pozitivitet e frymë e së vërtetës që e frymëzon autorin.

E kundërta ndodh me rastin e poemës me notat më të forta emotive ,që i kushtohet së bijës, të titulluar *Baladë dritash për Lalin*. Një larushi dritash të një sërë ngjyrash e formash paralajmërohen që në fillim, madje që në titull.

Në vargjet e poemës drita derdhet në të gjitha format e përsiatjet e saj. Ajo nuk është veç një element i shënjuar me fjalë, por dhe metaforë e shpëtimit, e lirisë dhe një abstragim i së mirës, i së bukurës, hyjnore etj. Si nocion metafizik, në formën më të plotë të saj, ajo shpreh: gëzim, trishtim, dhe ngjyroset prej nuancash e çastesh jetësore.

*Për dritat lal, desha të tham, që kam takue,
Me të cilat shoqnohesha gjithmonë,
Dritat që s'i desha prap i due*

.....

*Por vetëm drita s`ka mbarim
Si ajo drita përmbi kënetë a soentësh gushti
Kur mbushet qielli anëpëranë
Me pala të pakufishme
Të një flamuri gjigand
E gjithëfarë ngjyrash
Veç drita s`ka mbarim.*

Si të tilla, dritat janë përjetimet, dëshirat, shpresat që sikurse drita s`kanë mbarim, janë të pakufishme. Sikundër shprehet tekstualisht në poemë:

- Por vetëm drita s`ka mbarim.

Megjithëse poema na ofron një ekspozitë të tërë dritash *me gjithfarë ngjyrash që mbushin qellin anëpëranë e me pala të pakufishme* dhe në këtë poemë drita paraqitet përmes kontrastit me errësirën. Por që kjo

e fundit del vetëm në disa fragmente të poemës, duke lënë kështu vetëm disa shkëndija ndijimesh dhe idesh të vagullta, pa mundur të hedh hije mbi fuqinë dritëdhënëse të vetë dritës.

Kësisoj, në sintezë të gjithë poezive, ku shfaqet nocioni i dritës qoftë të atyre që ne i ndeshim të shënuara me fjalë të drejtpërdrejta apo si objekte burimore dhe veprime që të çojnë te drita si moment metafizik i pashmangshëm, një mënyrë edhe më e thellë është kur ajo shfaqet si frymë apo ndjesi që ne e marrim prej përjetimit edhe nga situata, gjendje, artikulime poetike të ndryshme që, edhe pse nuk kanë në trup të këtyre teksteve fjalë apo detaje, as të përafërta me dritën, përsëri përçojnë dritë apo ajër drite. Ajo është aty si energji e padukshme, si thirrje, si atribut i përhershëm i shpresës e i së nesërme, si derivat i tërë veprimtarisë dhe i qenësisë njerëzore; me praninë e saj është një kuptim i munguar, por i pafshehur përfundimisht asnjëherë.⁴²

Zef Zorba shfaqet qartazi si një hermetist i përpunuar, pasi ndonëse ka elemente të hermetizmit, i përvijon në një prerje e përftesë krejt origjinale, infantile e unikale të dhëna përmes një rrjeti të paradoksesh, ku terri ndriçohet me dritë dhe ku dhimbja pakësohet nga hareja, duke mbizotëruar mbi të keqen e plogështin *e ku vetëm drita s'ka mbarim*.

⁴² Doktoratura, Riza Braholli, *Poetika e refuzimit estetik në poezinë tonë (Zef Zorba dhe Frederik Rreshpja)*

KALVARI I MARRJES SË KRYQIT: POEZIA SA MIRE, ATËHERË...

Në historinë e krijimeve poetike, ka ndodhur e vazhdon të ndodhë marrja e elementit biblik, duke e konsideruar sakralen si një fuqi të qenësishme e të patjetërsueshme të jetës, ku gjejnë zgjidhje edhe konfliktet e brendshme e ku e jashtëmja jetësohet.

Zef Zorba, ky poet që me anë të kujtimit, shenjtëron përvojën origjinale⁴³, ka ndërkallur në poezinë e tij një nga elementet më të rëndësishme biblike, *kryqin*. Në dukje, mendohet e thjeshtë marrja e këtij elementi dhe shprehja e botës shpirtërore me anë të tij, por nisur nga ajo çfarë elementi përfaqëson, mund të themi që pakkush e ka ndërkallur në artin poetik ashtu si Zorba ka bërë.

Së pari, përpara se të depërtojmë në botën poetike të Zorbës, do të japim një përcaktim të simbolikës së kryqit. Atë do ta gjejmë në shumë momente në Bibël, por po parashtrojmë tri vargje tepër domethënëse të *Ungjillit sipas Mateut*, *Ungjillit sipas Markut* dhe *Ungjillit sipas Lukës*, që, në fakt, shprehin të njëjtën gjë:

“Dhe ai që nuk e merr kryqin e vet dhe nuk vjen pas meje, nuk është i denjë për mua.” - Mateu 10:38⁴⁴

“Atëherë Jezusi e vështroi në fytyrë, ndjeu dashuri për të dhe i tha: “Një gjë të mungon; shko, shit të gjitha ato që ke dhe jepua të varfërve dhe do të kesh një thesar në qiell; pastaj, eja, mere kryqin tënd dhe më ndiq.” - Marku 10:21⁴⁵

⁴³ Isufaj, Viola, *Të gjitha mitet kishin vdekë*, Aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare *Letërsia si kujtesë*. Organizuar nga Departamenti i Letërsisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2019.

⁴⁴ Bibla e studimit, Shoqëria Biblike Shqiptare, Tiranë, 2009, f. 1087.

⁴⁵ Po aty, f. 1138.

“Dhe kush nuk e mbart kryqin e vet dhe nuk më ndjek, nuk mund të jetë dishepulli im.” - Luka 14:27⁴⁶

Së dyti, le të kalojmë konkretisht në poezi, të analizojmë simbolikat biblike e, më pas, të kuptojmë funksionin e simbolikës së kryqit, që mbart rol qendror në poezi.

Retrospektivisht, në poezi, autori do të rikthehet në fëmijëri:

*Sa mirë, atëherë, o mite, kur isha fëmi;
I lodhur prej lodrimesh gjithë ditën...*⁴⁷

Duket si një kujtim tepër i shtrenjtë, si një dëshirë për të përjetuar botën fëminore. Por, po të kemi parasysh Biblën, është përfaqësimi i një bote të çiltër, pa mëkat, që e pranon të vërtetën hyjnore në pafajësi. Do ta gjejmë shëmbëllimin e këtij vargu tek Ungjilli sipas Markut: “Në të vërtetë po ju them se kushdo që nuk e pranon mbretërinë e Perëndisë si një fëmijë i vogël, nuk do të hyjë në të”. Marku 10:15⁴⁸ Edhe “lodhja prej lodrimesh” përfaqëson qartë botën fëminore. Në këtë pikë kemi të bëjmë me një thelb ekzistencial unik për natyrën njerëzore, sepse njohja e së keqes, dallimi i qashtër i saj, na bëjnë të mendojmë për fëmijërinë, momentet kur ndiheshim kaq pranë me hyjnoren dhe pesha e fajit nuk na mundonte.

Menjëherë, pas këtyre vargjeve hyrëse, do të vijojnë vargjet e realitetit të trishtë, vargjet që njeriun me arsyetim të zhvilluar e çojnë në mundim e përpjekje për të gjetur motivin e ekzistencës e njëherësh i ndjellin frikë ndaj përkohësisë në këtë botë:

*I pezamtuar tash vetëm ndrydhi, e nata, e ditës lubi,
shpirtin ndër helme përkundë,
e arsyeja brehet pa nda, e bren*⁴⁹.

⁴⁶ Po aty, f. 1183.

⁴⁷ Zorba, Zef, *Buzë të ngrira në gaz*, Botimet Princi, Tiranë, 2010, f.78.

⁴⁸ Bibla e Studimit, Shoqëria Biblike Shqiptare, Tiranë, 2009, f. 1138.

⁴⁹ Zorba, Zef, po aty, f.78.

Këto vargje do të na ngjallin njënjëshmërinë me vargjet e Salomonit tek libri i *Predikuesit në Dhjatën e Vjetër*: “Tërë ditët e tij nuk janë veçse dhembje dhe puna e tij është e rëndë. Zemra e tij nuk pushon as natën. Edhe kjo është kotësi”.⁵⁰

Duhet të theksojmë se poezia mbart një linjë logjike me atë të perceptimit dhe arritjes së besimit nga natyra njerëzore. Fillon me dëshirën për të përjetuar pafajësinë fëmijnore, kalon në kotësinë dhe ngërçin ekzistencial e do të vijojë tani me kërkimin e shpëtimit:

*bie ora pesë: unë kryqin marr në krah
e me pak frymë fillohem për Kalvar*⁵¹.

Kemi arritur, këtu, kulmin poetik. Me një forcë që depërton në skutat e zbrazëta shpirtërore, kërkohet arsyeja e ekzistencës, antihelmi për shpirtin e helmuar. Bartja e kryqit qëndron në thelb të gjithë poezisë e në këto vargje përqendrohet simbolika e kryqit biblik, që e parashtriam më sipër. Të mbash kryqin, do të thotë të ndjekësh hyjnoren, të shkosh pas saj si shpëtim ndaj mundimeve shpirtërore në botë. Këtu fillon Kalvari, udhëtimi për të arritur të përjetshmen, e për të gjetur atje pafajësinë fëmijnore, për të shpëtuar nga mëkatshmëria e botës.

E në vijim të linjës logjike, në fund të Kalvarit, do të gjendet prehja e shpëtimit, ndihma hyjnore:

*Eci. Dhe ngadalë e lehtë një këngë sajohet
ndër dej: “ad adiuvandum me festina”*⁵².

Në qenësinë e autorit, këndohet dëshira që hyjnorja të nxitojë për ta ndihmuar. Një buçimë, thirrje për të gjetur prehjen e përhershme.

Mund të themi që Zef Zorba është një nga mjeshtërit e shprehësisë së bukurisë poetike, e doemos një nga përfaqësuesit më të

⁵⁰ Bibla e Studimit, f. 776.

⁵¹ Zorba, Zef, po aty, f. 78.

⁵² Zorba, Zef, Buzë të ngrira në gaz, Botimet Princi, Tiranë, 2010, f. 78.

rëndësishëm të letërsisë bashkëkohore. Poetika e tij, e veçanërisht ajo me motiv biblik, që përbënte dhe synimin e këtij punimi, e ngre autorin në pedestalin e autorëve të tjerë të letërsisë bashkëkohore në botë.

Poezia e Zorbës, është një këlthitje drejt kërkimit të hyjnore përmes artit poetik e për ta përfshirë atë si pjesë të rëndësishme të thelbit ekzistencial. Zorba rizgjon motivet e dikurshme, por duke ruajtur modelin avangardist të poezisë, e kjo e bën unikale veprën e tij.

Bibliografi

Bibla e Studimit, Shoqëria Biblike Shqiptare, Tiranë, 2009.

Viola Isufaj: *Të gjitha mitet kishin vdekë*, Aktet e konferencës shkencore ndërkombëtare “Letërsia si kujtesë”, të organizuar nga Departamenti i Letërsisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, 2019.

Zef Zorba: *Buzë të ngrira në gaz*, Botimet Princi, Tiranë, 2010.

Xhensila Bogdani

“RITMI ROCK” NË POEZINË NJË GOZHDË***Një gozhdë***

*Një gozhdë e ngulur thik në mur, një gozhdë
 e ngulur thik në mur, një gozhdë e ngulur.
 Një gozhdë e futur thellë në mur, një gozhdë.
 e futur thellë në mur, një gozhdë e futur.
 Një gozhdë e mbetur thatë në mur, një gozhdë
 e mbetur thatë në mur, një gozhdë e mbetur
 e ngulur thik ...
 e futur thellë...
 e mbetur thatë ...*

Nëse nisemi nga titulli i poezisë *Një gozhdë* në mendjen tonë shfaqet si fotografi objekti i gozhdës, e cili shërben për t’u ngulur apo për t’u mbërthyer në objekte të tjera, pra, bëhet bashkëvepruese e kjo ndodh dhe në poezinë tonë, ku gozhda bëhet pjesë e jetës së poetit, ajo është aty e ngulur thikë dhe e futur thellë.

Po ç’është kjo e papritur që e fut poetin tonë në një vorbull përjetimesh të hidhura. Sa lidhet kjo poezi me unin poetik?

Poezia të lë të nënkuptosh se diçka e papritur ka ndodhur, diçka shkatërruese, diçka që përvëlon porsi llava, diçka që të shkul zemrën. Poezia përcjell një gjendje të rënduar sentimentale, një zhgënjim nga njeriu i zemrës ose një zhgënjim nga jeta, por poezia të lë të perceptosh edhe pafuqinë e unit poetik përballë fatkeqësisë së humbjes së fëmijëve të tij dhe këtë e dëshmojnë vargjet e fundit.

E ngulur thikë/e futur thellë/e mbetur thatë

Fëmijët i ikin para syve, një fatkeqësi që nuk kërkon asnjë koment sepse kjo ndjenjë është e papërshkrueshme, por autori ynë (nëse i qëndrojmë këtij interpretimi për ndarjen nga jeta të fëmijëve të tij) e shpreh atë si thikë të ngulur, të futur thellë e në fund -të mbetur pa asnjë fëmijë- të mbetur thatë.

Nëse mbetemi te ky interpretim vargu: Një gozhdë e ngulur thikë në mur, do të zëvendësohet me një dhimbje e futur thellë në zemër."

Poezia shoqërohet me tinguj të fortë, të ashpër, bubëllues etj.

Ndërmjet leximit dhe interpretimit të poezisë është e mundur të dallohet loja e një instrumenti të fortë goditës. Roku është zhanër muzikor i ngjyer me nota të errëta, i cili merret me problemet sociale të kohës dhe shkëputet nga karakteri dëfryes i *rocken rollit* a i mbrëmjeve të dëfrimit. Ai identifikohet si muzikë në kundërshtim me modelet morale dhe muzikore të kohës e për këtë arsye zhvillohet mënjane, në ambiente antikomformiste, ku shpesh qarkullojnë droga dhe alkooli.

Roku përgjithësisht përdor një gjuhë harmonike të thjeshtë, por ka dhe raste ku harmonia bëhet e komplikuar. Tonalitetet bazë bëhen maxhori dhe minori, por shpesh harmonia merr dhe tone të zymta ndërmjet akordit të zvogëluar mbi septimen e dominantes. Një rol përcaktues në gjuhën harmonike të rokut luajnë dhe notat blu. Në formën e saj më të pastër muzika rok karakterizohet nga tri akorda, një goditje ritmike e fortë dhe një melodi që të mbetet në mendje.

Ritmikisht roku preferon strukturat binare, por ngjet që të ndeshemi edhe me struktura ritmike të thyera e kjo ka të bëjë me natyrën *ambigue* të vetë rokut. Këngët rok realizohen në ritme të shpejta e përfshijnë tema nga më të ndryshmet, nga ato më të përditshmet, problemet sociale e politike deri tek ato më delikatet e me ngjyra filozofike.

Gjuha e poezisë nuk mund të jetë kurrë e njësuar; ajo që nënkupton sot një poezi mund të ndryshojë e të pasurohet ose të varfërohet, nesër.

Poezia ngërthen në brendinë e saj tinguj të fortë e tronditës, bëhet një ritëm monoton gati-gati si vetë ngulitja e një gozhde; semantika e fjalëve *thikë - thellë - thatë* e veshin poezinë me elemente të forta ritmike.

Duke ditur mirë se poeti kishte lidhje të ngushta me muzikën, lidhja dhe shkrirja e elementeve muzikore në poezi nuk është e rastësore.

Sipas prof. Viola Isufajt, ndërlikueshmëria lidhet me tipin e muzikalitetit të Zorbës, që është jo imitim i drejtpërdrejtë, por përshkrim poetik dhe simbolik i fenomenit të cilin Zorba synon të përshkruaj. Një skenë apo një ngjarje e veçantë shprehet me anë të rrethanave të jashtme, duke komunikuar emocionet që provokojnë pikërisht këto rrethana; këtë përcjell mjeshtërisht poezia *Një gozhdë*.

Siç mund të shohim në këtë poezi objekti bëhet subjekt, pra gozhda si objekti i poezisë bëhet subjekti i saj. Gozhda nuk ka kuptimin e gozhdës si metal, por të një fjale të thellë, një fjalë lënduese, një fjalë të dhimbshme që i është ngulur thellë në zemër, ajo gozhdë, pra, ajo fjalë është ngulur thikë në mur, por a ngulet vallë thika në mur?!

Në poezi dhimbja është e pakrahasueshme, pasi kjo e papritur nuk fshihet as nga muri dhe as nga zemra, e mbetur thatë.

Siç mund të shohim, në poezi përdoret shumë shkronja -th-, thikë, thellë, thatë, që është një bashkëtingëllore e pazëshme e pazëshme si dhimbja prindit-baba e poet që është ndarë me fëmijët nga kjo botë.

Përsëritja është e pranishme në këtë poezi, kjo lë të kuptosh se autori i kushton kujdes të veçantë vetëm këtyre fjalëve: një gozhdë dhe e ngulur thellë.

Metafora është e pranishme dhe gjallon në këtë poezi të Zorbës. Poezia na vë përballë një gjendjeje emocionale shpirtërore të rënduar, të vrarë, të lënduar dhe të pashëruar.

Muzikalitetin në këtë poezi e vëmë re tek vargjet e fundit thikë/thehtë/thatë duke i nisur nga një ton më të lartë dhe më pas vjen duke u zbutur, lento-gjendja e amullt, e trishtë dhe plot me tension emocional të mbajtura mbyltese. Autori nuk jep shumë

informacione, çka nënkupton një shpirt të lodhur, që ka luftuar, për të mos u lënduar, por nuk ja ka arritur, pasi kjo e papritur ka kapluar zemrën e tij të mbetur thatë. Ky shpirt i lodhur nuk ka më forcë të jetojë, nuk ka më fuqi të gëzojë e nuk ka jetë të gjallojë, ndaj dhe zëri i interpretimit të poezisë ulet, pasi dhimbja sa vjen e shtohet. E papritura është aq e madhe, saqë shpon në zemër si thikë e njëherësh është futur aq thellë, saqë shpon në zemër si thikë; dhimbja nuk kalon, mbetet aty thikë, thellë, thatë.

Adela Ndoj

DEPËRTIM NËPËR ERRËSINË E POEZISË SË ZEF ZORBËS

Poezia e Zorbës është një ëndërr e këqyrur në të dalmen e dritës. Ashtu siç shkrihen nuancat e blusë së agimit, ashtu shkrihet terri i hermetizmit me bardhësinë e lirikës në poezinë e tij. Poezia e Zorbës është e njëjtë me ëndrrën, që kërkon ndjekje të vëmendshme për t'u zbërthyer.

Semantikisht, çdo fjalë në vete gëzon kufij të qartë, por shumatorja semantike e fjalëve kthehet në një labirint mundues për lexuesin. Poetika e Zorbës nuk ka për detyrë të deklarojë, as të vetëmbrohet, as të pohojë si i ardhuri rishtas në letërsi. Arti poetik i Zorbës synon që të zgjojë të pavetëdijshmen, t'i flasë e ta rrokë atë. Dhe e gjitha arrihet nëpërmjet fjalës.

Si hermetik, por edhe si intelektual, për të, fjala është çelësi që mbyll dhe hap çdo kuptim. Përtej fleksibilitetit ritmik, përzgjedhjes së saktë të semave dhe lidhjes sintaksore në harmoni, fjalëve nuk u vishen kuptime të reja, përkundrazi ato synojnë të prekin formën më të vjetër kuptimore. Fjala synon të shpalosë gjendjen e paprekur të saj, abstraktin hyjnor.

Me pak fjalë Zorba shpalos dhimbjen personale që tek lexuesi nuk është gjë tjetër veçse një përkthim i denjë i përfytyrimeve individuale.

Po t'i qasemi fjalorit për të kuptuar më shumë rreth hermetizmit ndeshemi me dy shpjegime kryesore:

Së pari, i mbyllur mirë, që nuk lejon aspak të kalojë ajri ose diçka tjetër; i padepërtueshëm (për enë, dhoma).... Derë (dhomë) hermetike. Mbyllje hermetike.

Së dyti, është shpjegimi i terminologjisë brenda kontekstit letrar, pra një gjuhë shumë e vështirë, paqartësi në ide dhe figura.

Arti poetik i Zorbës duket se i prek të dy shpjegimet e mësipërme.

Si letërsi arke a sirtari, që me të vërtetë deri pas vdekjes së autorit nuk ka depërtuar ajri, e as nuk është përplasur ndër fletë fryma e ndonjë lexuesi përveç vetë autori, duke e bërë kështu edhe materien hermetike. Një material i shkruar në vetmi, e i fshehur në terrin e sirtarit.

Poetika e Zorbës është thelbësisht ajo çka kuadratohet si letërsi hermetike, e paqartë në ide e figura, zorshëm e ndriçueshme e zorshëm e kuptueshme.

Qasja me fjalorin dhe zbërthimi i mëtejshëm në poezi, na flet pastërtisht për një njeri hermetik, në praktikë edhe në teori.

Por, edhe pse poezi hermetike, ajo arrin t'i flasë shpirtit të lexuesit, mbase prej faktit se është hermetizuar diçka e thjeshtë, një realitet i jetuar bashkë. Sado e ngurosur, poezia e Zorbës përthith lexuesin, prej notave lirike, prej dhimbjes, pikërisht se përkap gazin e ngrirë në cep të buzës së të secilit. Në thelb është hermetizuar ajo çka është esenciale, duke prerë në një pikë drejtëzat e autorit me ato të lexuesit. Dhimbja ka të njëjtën forcë, të njëjtën "shije" për çdo kurm dhe është ndjenja pika nëpërmjet së cilës fillon depërtimi. Depërtimi i dritës së hënës nëpër terr, ashtu siç e hasim në poezitë e autorit.

Të studiosh hermetikët mbase kërkohet një punë kolosale, në dukje e pamundur, "aq sa hiqet dreqi me vdekë" siç përmend në një varg Zorba. Një poezi e mbushur me inkorporime filozofike, të pranuar edhe nga vetë krijuesi i tyre si terrnajë e që presupozohet të ngelet edhe për lexuesin një sprovë shumë e vështirë. Sigurisht, po të flasim me termat e autorit, ai nuk dëshiron një lexues që teksti i ofrohet i gatshëm, madje lexuesit i duhet përgatitja e duhur jo vetëm për ta interpretuar tekstin, por gjithashtu për të ndjerë vuajtjen e dhimbjen. Në thelb, duket se kërkohet një lexues *par-exellance* që bashkëvepron me autorin dhe dhimbja është pikërisht zanafilla, që shndërron lexuesin në një bashkëveprues të denjë.

Poezia e Zorbës mbrun një problematikë universale, një realitet të përbashkët siç është vuajtja, fizike a shpirtërore qoftë ajo. Një emërues i përbashkët. Prej dhimbjes autoriale derivon një dhimbje kolektive

dhe e anasjella, prej dhimbjes kolektive derivon dhimbja individuale e autorit dhe gjithsecilit.

Më rrashtë e më tepër ferr/ shkrepat ceporë,/ kërcënuese për m'u shprazë në rrënojë/ përmbi eshtra/ që vetëm lëkura i lidhë/ e vullneti (poezia Shkalla e Kakarriqit)

Dhimbja e universalizuar, e njëjtësuar është pika ku fillon depërtimi i hermetizmit, duke lejuar kështu komunikimin me lexuesin. Sepse siç e përmendem edhe më lart, është mbyllur fort substancialja, dhe mbyllja e thelbit nuk është karakteristikë vetëm për poezinë hermetike, për Zorbën, por për çdo shpirt që mbrun një konflikt me veten a me tjetrin.

Përdorja e pandalshme e formave thirrore(*e nuk lëviznin...e merrnin frymë me zor e...oh...*), nuk është vetëm një mjet shprehës, nuk është përdorur drejt vetëm nga ana morfologjike dhe sintaksore, por është përdorur në mënyrë të drejtë për të gjithë shumësinë e kuptimeve që një *Oh* mban mbi vete. Një ofshamë, një *Oh* mban mbi vete kuptimet leksikore të çdo poezie, të çdo letërsie, të çdo gjuhe, të gjithë historisë njerëzore, andaj nuk është rastësisht aty.

Pse s'ngjitesh, qyqare, gjersa të kânde?

(Unë nuk vij dot me ty:

Nuk kam si shkoqem prej kësi ngujimi ku frymën e mbaj gjallë me cirka arsyetimi;)

Inkorporimet meditative në terr dhe vetmi nuk janë gjë tjetër veçse nevoja për dritë, për ndriçim, për frymëzim, për një dorë që shtrihet.

(I errët ky shteg. Nuk mundem rrugën me gjetë pa dritën tande(Çka më sembon?))

Tek Zorba hasen të gjitha format e marrëdhënieve, duke filluar tek intertekstorët me poetët dhe artistët e huaj (*Oh, kot se i përsëris me mend poetët, -poezia Lento*), marrëdhëniet me tjetrin, me lëndën, me objektin, me materien, me fushat e tjera jetësore.

(Këso-netësh,/ në bankat e lulishtes, me Prenkun,/ fugat e para zhvironim e çvendosjen e yjeve gjeometrikisht të sakta).

Relacionet e shumta, miqësore, letrare, muzikore, artistike, nuk janë hiç më pak se damarë komunikimi që lidh poezia. Me tërë mend, e pranojmë që ekziston një pengesë mes tekstit dhe lexuesit, por autori na e ka dëftuar kanalën e komunikimit përmes funksionit estetik që poezia mban në vete. Të gjithë shenjat e tekstit na flasin për përvoja jetësore, për kujtime, për ngjarje, për vende konkrete, për njerëz e data, për plagë, vraga, e gaz. Kësisoj depërtimi nëpër hermetizmin e pranuar me të drejtë, ndjek një shkallëzim rritës. Mbresa të ngrira e të ngarkuara me ngjyra e ndjenja, kapërcimet përtej kohës dhe hapësirës lënë kështu një shteg të hapur për veten dhe lexuesin.

E për rrjedhojë duket se vetëm e tashmja është e errët, jo e ardhmja. Boshi do të mbushet prej dritës. Ajo çka u cilësua edhe prej autorit terrnaje qenka momenti i jetuar, jo e pritshmja. Ajo nuk është gjë tjetër pos shpresë e dritë.

E mandej edhe ne ndoshta na prihet mbarë e do të bahemi dikur me ble një radio gramafon Hi-Fi bashkë me një diskotekë të pasun simfonike."

Natyrisht ty, si e ke zakon, mbas pak batutash ka për të marrë gjumi në poltron (do të kemi poltrona, atëhere!) e do të vazhdojsh me pa andërr patën që struk nën flatra zogjkat e veta. (Letër nga arkivi familjar)

Ndjenja e nostalgjisë, nevoja për kthimin pas, a për të shkuarën para tek e bardha, kujtimet e mbresat, zbehin të gjithë konotacionin e fjalëve "të shkruara në terr dhe vetmi". Nuk dyshojmë se praktikisht kështu ka ndodhur, por funksioni poetik i poezisë na flet vetëm në trajtën e ngjyrave. Sado hermetike si poezi, autori vendos komunikim me vetë qenien, me zgripet me të errëta ekzistenciale dhe lejon dritën, dritën ta ndriçojë atë.

S`andejmi

ku paskeshin ngelur kujtesë brymore

zgjohen flauri

tjera blerime,

rinore

(poezia *Tjera blerime*)

Jola Male

POEZIA KADENCA E VIOLËS (VJESHTË)

Profil

Zef Zorba u lind, më 1920, në Kotorr të Malit të Zi, në një familje shqiptare dhe vdiq më 1993, në Shkodër. Studioi në Padova të Italisë, në degën "Studime Politike". Jetoi e punoi në Shkodër, në repertorin e tij profesional renditen: puna si regjisor, vuri në skenë drama me tingëllim disident; përkthyes i sërë autorësh të huaj, si: B. Kroçe, T. S. Eliot, Xh. Ungareti etj. Ai ka qenë autor i disa pjesëve dramatike e librete operash. Ismail Kadareja do ta klasifikonte krijimtarinë e Zorbës në atë që u quajt në gjuhën e përditshme *letërsi e sirtarëve*, sepse përgjatë jetës së tij nuk botoi asnjë poezi apo vëllim poetik, e kjo për arsye të politikës së kohës dhe të censurës. Siç shprehet vetë poeti në një shkrim të tijin më 1989, "... botimi i tyre kurdo, më tremb pa masë". Vepra e tij e vetme mbetet *Buzë të ngrira, në gaz*, botuar më 1994, një vit pas vdekjes së tij, ku janë përfshirë të gjitha përmbledhjet e tij poetike: *Elemente, Pasqyra të cflituna, Fugat e fundit, Mbresat e rrugëve* (poemë).

"Mbresat e rrugëve" (poemë)

Nëntitulli: *"Në formën e një koncerti për violë, fagot, ksilofon- kombonë dhe instrumenta perkusioni"*

Kjo përmbledhje poetike është përcaktuar nga vetë poeti si *poemë*, për arsye se poezitë kanë lidhje organike dhe logjike mes syresh. Vepra mund të shihet si poemë letrare dhe si poemë simfonike, pra, si një vepër muzikore me formë të lirë, me karakter lirik. Vetë autori në nëntitull shpjegon se kjo poemë është ndërtuar në formën e një

koncerti muzikor – kjo është dukshme edhe në poezinë *Kadenca e Violës (Vjeshtë)*. Poezia ka disa specifika, ndër të cilat *muzikaliteti, harmonia e kumbimi* gati prej muzike.

Fjalorth i poezisë *Kadenca e Violës (Vjeshtë)*:

Stomi: (breg dheu, bregore) rrip toke që ngrihet për së gjati, si një ishull i vogël në mes të një lumi apo kënete.

Zhuarit: (zhaurimë) zhurmë e zgjatur shurdhuese (si zhurma e dallgëve kur përplasen).

T'amullt: (mbiemër që përdoret zakonisht për ujin) nënkupton ujë të ndenjtur që nuk rrjedh, pra, rri pa lëvizur, ka mungesë gjallërie, rri në gjendje të fjetur.

Harbohen - harboj: kërcëj, hidhem e lodroj, duke bërë rrëmuje e zhurmë.

Shirok: erë detare e ngrohtë dhe e lagësht, që fryn nga jugu dhe sjell zakonisht mot me shira.

Kashturina: kashtëra drithërash e bimësh të ndryshme. Mbeturina kashte. Barëra të këqija.

Fugë: 1. Lloj i muzikës polifonike me shumë zëra; 2. Ecje e shpejtë, nxitimthi.

Kometë: trup qiellor, yll me bisht.

Cegëm (ciknë): acar.

Shpjegimi i titullit të *Kadenca e Violës (Vjeshtë)*

Kadencë:

(në kupt. muzikor) paraqet një kthesë në mbyllje të një fraze a periudhe muzikore, pjesa e koncertit që instrumentisti e luan me fantazi pa u shoqëruar nga orkestra.

(në kupt. letrar) ritëm që përcaktohet nga mënyra e theksimit në vargjet e poezisë.

Figuracioni artistik që mund të përbëjnë një kadencë në letërsi, është: përsëritja e zhurmave, e lëvizjeve ose e goditjeve, përdorimi i fjalëve me tingull të fortë apo që tregojnë lëvizje dhe veprime me veti tingullore (të cilat do t'i evidentojmë në vargjet e mëposhtme).

Violë:

Vegël muzikore që bën pjesë në orkestrat simfonike, operistike.

Vjeshtë: Pse vjeshtë?

Në këtë poemë “Mbresat e rrugëve”, kemi 4 kadenca poetike, ku secila prej tyre përfaqëson një stinë.

1. “Kadenca e ksilofon-kumbonëve” (Pranverë).
2. “Kadenca e fagotit” (Verë).
3. “Kadenca e violës” (Vjeshtë).
4. “Kadenca e instrumenteve me perkusion” (Dimër).

Argumenti i dytë se pse kjo kadencë poetike është përcaktuar në stinën e vjeshtës është se në vetë vargjet e poezisë pasqyrohen elementet e vjeshtës, si: shiroku, shiu, kashturinat, shtrëngata, rrugët e përmbytura etj.

Kadenca e Violës

Kadenca e Violës është e ndërtuar mbi bazën e figurës së metaforës, ku thuren natyrshëm, bukur dhe në mënyrë estetike imazhet e pasura poetike me tingujt e fenomeneve të natyrës të gjitha këto vijnë si një metaforë e vetme që shënjohe me kadencën e violës. Që në vargjet e para nis koncerti muzikor, qetësia karakterizuese e natyrës prishet: *Prej stomit të zhuaritur*, një bregore dheu që lëshon një zhaurimë (zhurmë): *Ku ujrät t’amullt moçalorë harbohen*. Në këtë varg kemi jo vetëm një metaforë, por edhe një antitezë kuptimore, ujërat e “fjetur”, që u mungon gjallëria nisin të kërcejnë e të lodrojnë.

Ku prej shirokut kashturinat

Si mijëra fyje

Jehojnë,

Shiroku, një puhizë e lehtë detare me tingujt e saj zhurmues i bashkohet orkestrës së natyrës. Në këtë varg kemi një krahasim metaforik të kësaj puhize detare me mijëra tinguj fyjesh.

Këtë sekuençë imazhesh imagjinare na e ndërpret një pyetje sa retorike aq edhe metaforike: *A mund u ruajtkan gjatë pikëllimet?*. Shpirti

poetik nën këta tinguj ndjen dhe kujton pikëllimet e ruajtura prej shumë kohësh.

Këto pikëllime shoqërohen me *Rrymë e klithmë*, me tinguj rrëqethës. Këta tinguj të lehtë pikëllues e disi të ftohtë të japin ndjesinë e stinës së vjeshtës.

Tashmë këto nota muzikore zhurmuese, në strofën e dytë formojnë të gjitha bashkë një “fugë”, një polifoni zërash që arrijnë “të zhbirojnë zhvendosjen e yjeve, gjeometrikisht të sakta” – elipsë.

Kjo polifoni natyrore merr trajta kozmogonike, këtyre zhurmave zhuaritëse u vishet një madhështi, një fuqi qiellore. Ashtu sikundër refrenet muzikore që mbartin gjithë fuqinë dhe tonalitetin më të lartë, ku muzika (kadenca) arrin pikën kulmore, kështu ndodh me strofën e dytë të poezisë, kadenca poetike arrin në pikën e saj më të lartë, në atë qiellore.

Por këto yje, kjo kometë poetike në strofën e tretë zhduket, bie, ikën, humbet dhe pikëllimet rikthehen, tingujt poetik i largohen kulmit kozmogonik dhe i rikthehen sërish toneve tokësore.

*Shtrëngatë e madhe atë ditë.
Nëpër faqet e skuqura të varzave
lotët rridhin përzier me shi,
e djemve,
rrëzë murit ngjeshur,
zemra u mori cegëm:*

Koha zymtohet me shi të rrëmbyer, me erë të furishme, me shkrepitima e bubullima. Në këtë furtunë e stuhi nis menjëherë një shpërthim, një shprehje e vrullshme e një ndjenje a një përjetimi. Shiut e shtrëngatës i bashkëngjiten lotët e vajzave dhe zemrat e djemve me ndjenja drithëruese e të acarta. Shtrëngata natyrore, këtu, paralelizohet dhe metaforizohet me ndjenjat shpërthyes rinore.

*“në rrugën e përmytur
rrëke të murrme përçuan furishëm
barëra, gjethe, krande të ngatërruara
e kushdiku (moj grua!)
edhe një boçe karafili*

posa të çelur...

Në këtë shpërthim muzikor e natyror ashtu si në lumin filozofik të kohës që rrëmben gjithçka që i del përpara, ashtu dhe kjo rrëke e murrme i rrëmben "*kushdiku*".

"*Kushdiku*"- është një fjalë poetike e krijuar nga poeti, morfologjikisht kemi të bëjmë me një përngjitje, mund t'i jepen dy kuptime gjuhësore:

Kushdiku:

- *Kush (dikush) + diku = Kush (përemër pyetës), dikush (përemër i pacaktuar), diku (ndajfolje vendi);*

- *Kush e di se ku;*

Dikush i papërcaktuar, dikush ndoshta i panjohur edhe nga vetë pavetëdija poetike rrëmben tingujt që lëshojnë furishëm gjethet, barërat, krundet, e ndoshta edhe muzikën e rrëmben, shkojnë furishëm gjithë këto tinguj. Ndoshta ky "*kushdiku*" jemi ne lexuesit, që rrëmbejmë këto imazhe të bukura dhe këta tinguj poetikë.

Deri ku mund të shkojmë? Sigurisht që arrijmë deri në imagjinatën tonë dhe përtej saj, toni, ritmi, koloriti i fjalëve, vargjeve e frazave të poezisë krijojnë pamje mjaft mbresëlënëse dhe një muzikë për veshët tanë.

Pikëllimet poetike nisin me klithmat, vazhdojmë me kometën e zhdukur dhe përfundojmë me "*një boçe karafili posa të çelur*", vargjet poetike pësojnë një thyerje, bëjnë një kthesë të madhe, në atë zymtësi vjeshtore çel një boçe karafili, si një shpresë për harresën e pikëllimeve.

Por ...

edhe muzika, thua?

Nën këtë furi e shtrëngatë lind pyetja: *Po muzika, a thua rrëmbehet e humbet në 'rrëketë e murrme të kohës'?* Ajo që mbetet, që nuk humbet në dekada e ndoshta në shekuj është vija melodike e violës, e cila fshihet mjeshtërisht në tingujt e natyrës.

Kjo kadencë violistike nuk është gjë tjetër veçse një fantazi e instrumentistit tonë poetik.

Hermetizmi poetik

Gjatë poezisë mund të ngrihen disa pikëpyetje, si:

- Të kujt janë këto pikëllime të së kaluarës?
- Kush është Prenku?
- Cilës grua i drejtohet poeti në strofën e fundit:

“e kushdiku (moj grua!)”?

Të gjitha këto pikëpyetje mbeten deri diku të pashpjegueshme, të cilat marrin interpretime të ndryshme, por sërish mbeten hermetike, ashtu sikurse krijimtaria e Zef Zorbës. Poezia *Kadenca e Violës* është një poezi jo e shfaqjeve dhe e mesazheve të drejtpërdrejta, por është e paraqitur me një nëntekst të thellë, ndoshta të mbuluar qëllimtazi. Muzikaliteti i kësaj poezie më shumë se i zhurmshëm është i brendshëm, për pasojë dhe mjaft i thellë. Në interpretimin e poezive të këtij lloji synohet të rindërtohet e pathëna, por pa menduar se tek ajo mund të arrihet përfundimisht. Vetë poeti Z. Zorba, në një shkrim të tijin thekson: *Rrugën e “esencialitetit” ose të “hermetizmit” e kam përqaftuar kryesisht sepse kam ndjerë mundësinë e dhënies emocionale dhe të krijimit të përfytyrimit vetjak*⁵³.

⁵³ Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz, “Princi”*, Tiranë, 2010, f. 172

Uendi Belba

MBI POEZINË NË VEND TË HYRJES

Në vend të hyrjes

*I errët ky shteg. Nuk mundem
rrugën me gjetë pa dritën
tande. (Çka më sëmbon?)
Në cep të greminës,
që joshë e ngujon,
a nuk e sheh si po lëkundem?*

Poezia *Në vend të hyrjes*, nën këtë cilësim mund të tingëllojë në këtë rast paradoksal. Në radhë të parë, sepse Zef Zorba ishte, në të vërtetë, e kundërta e të shquarit, e, në radhë të dytë, sepse koha e komunizmit në një përfitim të parë, më pak se e kujtdo, mund të quhej kohë e tij.⁵⁴

Që në titull të kësaj poezie, kuptojmë se Zorba na ka rezervuar diçka ndryshe, diçka që të zëvendësojë atë, që ne do t'a konsideronim një hyrje për këtë cikël poezish.

Dikotomia dritë-errësirë, një errësi që vjen duke u ndriçuar, krijohet në vargun e parë me epitelin "*i errët*", ndërsa në vargun e dytë me fjalën "*dritë*", duke krijuar kështu një kontrast dritë-errësirë, të cilin do ta lidhim me letërsinë e realizmit socialist, fatin e intelektualit në periudhën e diktaturës, ku errësira përfaqëson diktaturën, censurën, torturat, pra, gjithçka që shkaktonte terr, terror e në anën tjetër *drita* është liria, e drejta.

⁵⁴ Ismail Kadare: Parathënia, *Buzë të ngrira në gaz*, "Princi", Tiranë, 2010, f. 11.

Në dukje, kemi një rrugë të hapur diku, *shtegu*, (*I errët ky shteg*), përtej kontekstit politik, në një interpretim më të gjerë e më të thellë, përfaqëson rrugën apo rrugëtimin që do të ndërmarrë konkretisht poeti. Por shpeshherë, në fund të këtij shtegu, nuk është ajo që presim, nuk është drita që udhëheq, por errësira mbizotëron.

Në vargun thirror a lutës (*Nuk mundem rrugën me e gjetë pa dritën tande*), duket sikur pa lirinë, pa dritën, pa rrezet e saj që ta mposhtin errësirën, uni lirik nuk mundet të gjejë rrugën e tij dhe vetveten. Duket se uni zorbian po i dorëzohet fatit të tij duke pranuar kësisoj edhe fatalitetin. Përemri (*tande*) kryen një rol jo pak të rëndësishëm, sintagma (*pa dritën tënde*), na zgjon pyetje e pandehma: pa dritën e kujt nuk mundet poeti t'ia dalë mbanë, mos vallë pa dritën hyjnore (*religjioni*) apo pa dritën e arsyes? Nga mënyra e thirrjes së muzës, frymëzimit poetik, në vargjet që hapin *Buzët e ngrira*, mund të mendohet përsëri ç'është, ai apo ajo të cilit i drejtohet, një Zot, një perëndi e vjetër... është frymëzimi poetik, siç e thirri Fishta, De Rada, që na vjen nga lashtësia që nga Homeri, Virgjili...por mënyra e thirrjes, mendojmë është e frymëzuar edhe nga hermetistët italianë: prologu i Zorbës ashtu si *Muza ime* e Montales, ka ngurrimin, pikëpyetjen, të gjendurit midis, gjendja e ndërmjetme, pezull.

Joshja nga humnera-afërsia e jetës dhe heqjes dorë nga jeta, është vetë drama e njeriut intelektual të kohës, kontrastet në të cilat luhatet në mënyrë sfilitëse, konfliktet psikologjike e shoqërore në të cilat ndodhet intelektualit shkodran janë të ngjashme me ato të intelektualëve të vendeve të tjera në variantet e tyre.

Për ta përmbyllur strofën e parë kemi mes kllapash një pyetje retorike, e cila s'ka e as merr përgjigje, por që duket se del nga subkoshienca e unit lirik. E thënë ashtu me heshtje, në formën e një bashkëbisedimi me veten ku folja "sëmbon", sipas nesh i referohet atij kuptimit të figurshëm, të asaj dhimbjes shpirtërore, të keqardhjes, të ndjesisë së diçkaje që e ka peng, diçkaje na e cila ndonëse ai ka hequr dorë, ajo nuk po e lë të lirë. E thënë mbase duke u gjendur në midis të grahmave të dorëzimit dhe një rreze drite prej një yjësie të largët... - kjo do të ishte diçka që e mundon, një dhimbje e vazhdueshme,

dëshira për të jetuar i lirë, për të gjetur rrugën, duke qenë në dy kahe të kundërta shpirti me trupin.

Në strofën e dytë, vargu i parë (*në cep të greminës*) na është paraqitur vetë momenti, pozicioni në të cilin autori ndodhet, në çastin e dyzimit prej “greminës”, pra, e cila e josh nëse vepron siç duhet dhe e ngujon nëse gabon, pra, e mbyll, e largon, e izolon fizikisht, por edhe shpirtërisht. Teksa “ecën” përgjatë një litari të shtrirë tej mbi një humnerë, metaforikisht, vetë jeta e tij, tashmë e tendosur, varet nga këmbët e tij, çdo hap, çdo lëvizje sado e vogël e radhës, mbajnë mbi vete suspancën, nëse do t’ia dalë e nënshtrohet apo të rebelohet e të bjerë.

Poeti e ka njohur vdekjen gjithnjë, në të gjitha kohërat dhe në shumë forma, ajo nuk është diçka e re. Vuajtja dhe gëzimi për jetën, vuajtja dhe gëzimi për poezinë janë të pandashme, ato shkojnë bashkë. Ato identifikojnë njëra- tjetrën. Poezia është vetë jeta e tij. Për shkak të kthesave të papritura që mori jeta e tij, ai ishte një nga shtegtarët.

Joshja e ngujimi e lenë shpirtin në vend të palëvizur. Kjo është gjendja më delikate.

Heroizmi është i pashpallur sepse shpirti poetik nuk e di që ka prekur fundin, dhe në këtë prekje të caktit të mbramë ai është një hero i heshtur, i pavetëdijshëm për këtë.

Bibliografi

Zef Zorba, *Buzë të ngrira në gaz*, “Princi”, 2010, Tiranë

Dizertacion nga Riza Braholli: *Poetika e refuzimit estetik në poezinë tonë (Zef Zorba dhe Frederik Reshpja)*, Tiranë, 2017

Bashkim Kuçuku, *Pas eklipsit letrar*, Toena, 2014

Leksionet e lëndës *Letërsi Bashkëkohore Shqipe*, prof. Viola Isufaj

Pasthënie

Në shekullin XX, në poezinë shqipe bashkëkohore dy emra poetësh: Martin Camaj dhe Zef Zorba, përcaktojnë modernitetin e vargut shqip bashkëkohor. Në gjysmën e dytë të një shekulli plot pështjellime politike, të cilat nuk lanë pa prekur e dëmtuar trungun e letërsisë shqipe, bëjnë jetë në errësi, për t'u shfaqur më pas, në dritë të plotë, këta poetë me modelet më ekzemplare të shkrimit të poezisë moderne shqipe.

Është mbresëlënëse sesi, e këndvështruar prej një distance kohore që mundëson kalimin nga subjektivizmi i zhvendosur te një lloj objektivizmi estetik, panorama letrare e këtij zhanri, poezisë, shfaqet tashmë qartë e dominuar prej talentit të atyre që, duke krijuar në mënjanim, të panjohur e të fshehur me shpirtra të vetmuar e të heshtur qëndruan dinjitozë kundrejt një bote të zbrazët dhe shkurajuese.

1.

Në mars të vitit 1920, në Kotorr të Malit të Zi, Niko Zorba, atëkohë djalë katërmbëdhjetëvjeçar, hyn në dhomën ku ishte shtrirë Elena Zorba, lehonë, i afrohet pranë shtratit, i puth asaj dorën dhe i thotë: “Nanë, faleminderës që më ke ba me vëlla!”. Zef Zorba, intelektual me profil artisti, do të thirrej kurdoherë *Bep* prej familjarëve. Bepi erdhi nga një familje plot fibra aristokratike, me pasione e me talente të posaçme, në dije e në arte, të cilat do t'i trashëgonte në mënyrën më të bukur në punët e tij: në pikturë, muzikë, gdhendje...

Albumi familjar i Zorbajve nis me “Motrën Tone”, pikturën e famshme të Kolë Idromenos. Motra Tone është gjyshja nga nëna e Zef Zorbës, emri i plotë i së cilës është Antonia Idromeno. Fatkeqësisht,

Antonia vdes herët, në moshën 32-vjeçare. Kolë Idromeno, vëllai i Antonias, bëhet udhëheqës shpirtëror i Zef Zorbës për dije, formim e dashuri njerëzore, çka mund të shpjegojë njohjen dhe afeksionin e tij për pikturën e për artet figurative, krijimin e imazheve dhe hedhjen e penelatave, shpesh ekspresioniste, në poezi.

*Kish bluzën bojë orizi e gjithandej
Me guaska, verdh e blu e manushaqe.*

Ja një arsye pse, në poezinë e Zorbës, këtij admiruesi të dritës, harmonisë dhe ngjyrave, vezullojnë imazhe mrekullore origjinale, veshur me ngrohtësi dhe dëshirim të jetës, siç është tabloja madhështore e derdhjes së dritës, në një teatër universal, ku e mira vërshon triumfuese përmbi mjerimin: *Si ajo drita përmbi kënetë aso ditësh gushti/ Kur mbushte qiellin anë për anë/ Me pala t'pakufishme të një flamuri gjigand/ E gjithfarë ngjyrash.*

Afeksioni për pikturën shpjegon një hedhje të tillë penelatash të shpejta, të gjalla e të ndezura:

Ashtu të ndezur flakë/ Me turr në mes të sheshit zbritëm, dorë/ Për dore u kapëm, e shaminë e kokës/ Ajo duke u tundur na priu në valle:/ "Hej, largohu mal sa të dali hana, sa/ T'na bajë dritën për mbarama!..."/ E ne të dy/ Ishim në mes/ E bota po na dukej/ E madhe sa një diell.

2.

Do të ketë qenë viti 1940 kur pas mbarimit të gjimnazit, Zefi regjistrohet në Universitetin e Padovas, në degën e Shkencave Politike. Në vitin 1943 ndërpret studimet për shkak të luftës. I gjithë brezi i tij është kthyer për pushime. Në këtë kohë po ndodhin bombardime në detra dhe rrugët u mbyllen. Kështu Zorba, mbetet në Shqipëri duke e lënë vitin e tretë të studimeve përgjysmë.

Falë zotësisë së tij në matematikë dhe në përgjithësi në shkenca ekzakte, ai fillon punë në Bankën e Napolit, në Shkodër, ku punon deri në vitin 1945, kohë kur Banka u mbyll. Po këtë vit, pas mbylljes së Bankës, nis punën në Shtëpinë e Kulturës si regjisor ku krijon

grupin e parë teatror, grup që do të vinte në skenë dramën e Gjergj Fishtës *Juda Makabe*. Zorba do të tregojë se çfarë pasoi më tej, sesi vijuan ngjarjet nga ndalimi i shfaqjes, deri tek arrestimet e dhuna që “që nuk diji me pushue”.

Diku në një zyrë të errët, gjëmoi llahtarshëm çjerrja: “Ndal!”

Ishte cegëm dhjetori atë ditë kur i njoftova grupit teatral urdhërin se “shfaqja nuk do të jepej më as në Shkodër, as gjëkund”.

Qanim, bashkë me Fishtën dhe me shikim nga qielli dëneshim:

Ra perdja mbi desidencën e parë e dhuna pastaj nuk diji me pushue. (Zef Zorba, “Disidenca e parë publike e intelektualëve shkodranë”, në: Shejzat, Romë, Itali, janar 2016, f. 208)

Ka një transpozicion nga etika në estetikë. Mësimet që mori nga sprovat e një jete të vështirë, plot andralla, përmes një rrjeti të tërë paradoksesh shtrihen në poezinë Zorbës, një thurimë ku terri ndriçohet me dritë dhe ku nga plaga bulon hareja duke mbizotëruar të keqen.

3.

Kur Zorba përshkruan retë e turbullta gjithnjë e më të kobshme, gjithnjë e më kërcënuese që s’vonuan të duken nën qiellin e euforisë që krijoi fitorja mbi fashizmin, duhet të kuptojmë se shpejt do të vinte koha e arrestimeve në masë. Sapo kishte filluar klima e tmerrshme e terrorit, ajo klimë plot ankth e agoni, kur pas çdo nate gjindja zgjohej me fjalët “kë kanë arrestu mbramë?”. (Në familjen e Zorbës arrestohen dy eksponentë kryesorë, dy burrat e hallave të tij). Zorba dëshmon: ...Qemal Draçini, Kolë Luka, Filip Ndocaj, Injac Zamputi, Vehbi Bala, Tefë Gjonej, Myzafer Pipa, Paulin Pali, Ramadan Sokoli, Muhamet Ademi e shumë e shumë të tjerë (pjesa më e madhe e këtyre më vonë u mbytën nëpër burgje, u ekzekutuan, internuan ose sido u përndoqën politikisht)⁵⁵.

⁵⁵ Kur Zorba flet për ndihmën konkrete, për çdo gjë gjatë vënies në skenë të *Juda Makabe*, që gjetën te të gjithë intelektualët e qytetit, ai ndalon tek ata të cilët më pranë u qëndruan në çdo kohë, të cilët, siç shprehet Zorba: *Më vonë u mbytën nëpër burgje, u ekzekutuan, internuan, ose sido u përndoqën politikisht* (Zef Zorba, “Disidenca e parë publike e intelektualëve shkodranë”, në: Shejzat, Romë, Itali, janar 2016, f. 209).

Më 17 shtator 1945, Zefi ishte duke shëtitur në bulevard, kur një punonjës i Sigurimit, i veshur civil, i avitet duke e pyetur: “A ke me ndezë?”. Sapo Zefi ndalet, dëgjon një urdhër të prerë: “Hajde mbas meje!”, kjo ngjarje do të shënojë fillimin e viteve të burgut, vitet më të vështira për të.

*Div i kërtylur ëndërrimesh, pa drojtje
Zhigat kundroje, e syri fek s'të bënte
Pse binin një pas një: e Zot e trima,
E dituri të lashta. Dhe atëherë me shifra
Ujdi sendërgjoje, e vetëm lëndës
ia pate besën, pa e marrë në dorë
Teposhtën.
Por gjeometria afshin nuk ta zgjidhi,
Madje as vargu kur e hulumtove
Ne difraksion rrezesh iks. Jeremisur
Ka mbetë
Në mes të askurrgjësë e të pambarimit...*

Sepse disa ditë pas arrestimit të tij, arrestojnë edhe Terezën, vajzën me të cilën sapo kishte filluar një lidhje dashurie. Zefi dhe Tereza dalin prej burgu të dy, në shtator të vitit 1951. Pas daljes prej burgu, kurorëzojnë lidhjen e tyre. Martohen në qershor të vitit 1953. Është një lidhje shumë e bukur dhe e fuqishme, përplot rreziqe, por një peshë e rëndë (burgu politik) i ndjek pas gjithë jetën dhe pasojat në shumë sfera të jetës s'do të vonojnë. Një ndër dëshmitarët e martesës është miku i pandarë Prenkë Jakova. Nga Prenku mësoi teknikat muzikore.

4.

Duket sikur ky artist, Zorba, ka studiuar imtësisht aftësinë e çdo instrumenti orkestral për të përcaktuar potencialin e secilit, për t'u dhënë pastaj ngjyrave individualitet dhe timbreve të posaçëm një përdorim maksimal.

Duket se ai është, poeti që më së miri e di peshën e një note tromboni, harmoninë e një violonçeli, kombinimet e instrumenteve me perkusion apo tam-tam-et dhe kumbimet në marrëdhëniet e një grupi orkestral.

Përmbi të gjitha njohuritë, Zorba, më shumë i vetëdijshëm se i pavetëdijshëm, derdh në poezinë e tij, veç formimit të veçantë, edhe shijen, edhe ndjeshmërinë, edhe sensualitetin, e këtu verbi i tij melodioz është si në përputhje të plotë me muzikën e brendshme që ekziston në zemër të universit. Ai ka kapur me intuitë lidhjet e fshehta që ekzistojnë në relacione të thella midis sendeve. Pra, çka është më e rëndësishmja, ai ka ndier një rend të tërë të nënkuptuar muzikor, që ekziston dhe komunikon prej brendësisë së thelbeve të fenomeneve të kësaj bote dhe të të gjitha botëve.

E në këtë shkrirje, ku vështirë se mund të veçohet *melos*-i nga *lexis*-i, mund të thuhet me plot bindje se ideja muzikore ka lindur megjithatë, njëkohësisht me poezinë e tij.

Për këtë, në punët e mia, poezinë e Zorbës e kam parë jo thjesht si një sistem tingujsh të studiuar, por si shkrirje parimesh që ndërton një sistem që kërkon dialog ndërmjet sferave të krijimtarisë njerëzore.

Me gjithë dijet e tij muzikore dhe pasionin për këtë art, më shumë se nga teknikat e muzikës dhe analogjitë, ka mësuar nga vetë teknikat e artit të tij. Ndonëse nuk përdori struktura dhe tema klasike dhe ndonëse është një poet thellësisht modern, pastërtia e pabesueshme, në përdorimin e teknikave për të realizuar virtuozytetet e tij poetike, e bën atë një klasik modern.

5.

Që nga thellësitë e shpirtit inteligjent, lind një poezi e re, që kullon traditën e trullit të vet dhe duke përthithur me pasion elemente nga tradita hermetike, sjell në dritë formulime thelbësore të papritura, fjalë të dala nga heshtja, nga thellësia e meditimeve. Këto fjalë, të zbuluara e të risuara në dimensionin e tyre semantik, dëshirojnë të thonë esencën e një pështjellimi sentimental.

Komunikimi me hermetikët italianë nuk presupozon ndjekjen ose aplikimin e një modeli fqinj, presupozon përputhjen e botëkuptimeve vetjake dhe rrethanave jetësore dhe gjetjen e shtegut për të dhënë përfytyrimet vetjake. Dhe kjo është një përputhje mahnitëse. Le të kujtojmë arsyet pse kthimi i shkruesve të sotëm të modernizmi a specifikisht të hermetizmi është simptomatik.

Zef Zorba, në një mënyrë është “një *Homo Viator*, por ai nuk e harron udhën e kthimit, teksa shkel vendet e reja. Qenia poetike e tij mëton të jetë vendi i këmbimit të përhershëm ndërmjet esencializmit që e ka zbuluar dhe dashuruar kur ishte student në Padova dhe tharmit vendës që kurrë nuk e ka braktisur; sepse ai ka ndjenjën e një mirëkuptimi ndërkulturor, por po aq dhe të palcës etnike.

Duke kaluar më pas, qoftë edhe imagjinativisht nga njëri vend në tjetrin, ky shkrimtar kalon nga njëra kulturë në tjetrën, por vendlindja, kombi, vendbanimi mbeten kritere imanente, çka e bëjnë Zorbën “një të shpëtuar” nga “ankthi i ndikimit”.

6.

Të përpiqesh t’i afrohesh sa më pranë synimeve dhe ndjenjave të autorit do të thotë të ribësh së brendshmi udhën e tij. U desh kështu që, për punimet e mia të botuara dhe të pabotuara mbi Zorbën, të udhëtoja brenda shpirtit të poetit dhe shpirttrave të filozofëve dhe poetëve të tij të dashur, për t’i njohur e për t’i dashur pothuaj si ai, e po kështu për të përkapur gjurmët që njerëz e ngjarje reale lanë tek ai – gjurmë të cilat i shndërroi në poezi.

Në këtë botim janë përzgjedhur një pjesë e diplomave të studentëve të degës “Gjuhës-Letërsi” që kam udhëhequr në punën time universitare mbi poetikën e Zorbës, po dhe analiza teksti gjatë orëve mësimore, të cilat, me qëllimin për të mos ua prishur zërin autentik, nuk ia nënshtrova një redaktimi të thellë.

Fillimisht ndjeva keqardhje, që për shkak të kushteve të kaplimit të pandemisë, nuk munda t’i mbledh të gjitha punimet më të mira, sepse studentët gjenden pranë familjeve të tyre në izolim, ndërkaq që punimet e tyre gjenden në Tiranë. Ndieva të kundërtën, kur vërejta

se studentë të të gjitha niveleve i janë afruar apo kanë përqafuar një poetikë kaq të ndërlikuar si ajo e Zef Zorbës.

Falënderimet për mbështetjen dhe bashkëpunimin për përgatitjen për botim i takojnë përgjegjës së Departamentit të Letërsisë të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, profesoreshës Lili Sula, të njohur për vënien në pah të punëve të studentëve, nga botimi i akteve të konferencave shkencore të studentëve të doktoraturës deri te botimi i krijimeve letrare të studentëve të cikleve të tjera.

Një shprehje mirënjohjeje për drejtoreshën e Qendrës Kombëtare të Librit dhe Leximit, znj. Alda Bardhyli, e cila me ndjeshmërinë e hollë për poetikën e Zef Zorbës dhe studimet letrare shqiptare, pa u mëdyshur mori përsipër botimin në një kohë të trazuar.

Urojmë t'i kemi bërë një dhuratë shpirtit të Zorbës në 100-vjetorin e ardhjes në këtë botë dhe një të papritur të bukur studentëve, duke u ofruar një pasqyrë ku të shikojnë punët e tyre, për t'u dhënë forcë e besim në kohëra të pazakonta.

Tek e fundit, vetë u kemi shpjeguar, se që një punë të fitojë karakterin shkencor, duhet përveç të tjerash të plotësojë edhe dy kushte: të sjellë diçka të re dhe t'u vlejë të tjerëve. Urojmë që të jenë plotësuar të dyja kushtet. Të tjerë do të mbështeten mbi këto punime e me "të tjerë", nuk e kam fjalën vetëm për studentë. Unë vetë do t'i citoja ata pa ngurrim.

7.

Veptra e Zorbës është një vepër komplekse dhe multivalente. Pavarësisht depërtimit, ajo përmban gjithmonë një numër nivelesh që kanë për qëllim të kënaqin një larushi lexuesish. Për shkak të organizimit të ngjeshur ose aspekteve të karakterizuara nga vështirësia dhe errësia, tensioni midis kuptimit dhe formës do të vijojë i lartë e si i tillë, mund ta vështirësojë interpretimin ose ta bëjë jo të vlefshëm atë.

Ka një mendim se një akt i madh i interpretimit i avitet çdo herë e më shumë zemrës së një vepre dhe kurrë nuk i afrohet tepër ngushtë. Distanca ngacmuese e një interpretimi të madh është dështimi,

largesa, paaftësia. Por, paaftësia e tij është dinamike, është sugjестive, elokuate dhe artikuluese. Aktet më të mira të leximit janë aktet e paplota, aktet e mprehtësisë fragmentare, që refuzojnë parafrizat, metafrizat; që përfundimisht thonë: “Më interesanten në tërë këtë, nuk kam qenë në gjendje ta prek”.

Shpresojmë të jenë zbuluar të vërteta morale të paekuivoke që i prinë udhën artistit Zorba, i cili i zënë në pasionin eternal për dije e për arte, ka paraqitur a shndërruar mendimet, vëzhgimet, ndjesitë ose qëllimin e tij, në një formë poetike të veçantë e mbresëlënëse, të brishtë dhe të ndjeshme, multivalente dhe të bukur në vetvete, në një vepër që rilind nga hiri i vet.

Prof.asoc.dr. Viola Isufaj

PËRMBAJTJA

Parathënie: Rikthimi i Zef Zorbës, nga Alda Bardhyli	1
Zef Zorba: Poezi të zgjedhura	5
<i>Marinela Hysenllari:</i> Përkime dhe ndikime në poezinë e Zef Zorbës	21
<i>Adriana Balla Sadiku:</i> Marrëdhëniet muzikore në përmbledhjen poetike Buzë të ngrira në gaz	54
<i>Kristiana Mihani:</i> A Silvia e G. Leopardit, në përkthimin e Z. Zorbës	76
<i>Sara Zaçe:</i> Dualiteti dhimbje–dashuri në poezinë Guri i zi	88
<i>Anjela Velia:</i> Dysia dhimbje–shpresë në poezitë Qokthi, Eja me ne	93
<i>Fluturina Nurçe:</i> Nocioni i dritës – mes hermetizmit dhe origjinalitetit	100
<i>Ledio Hala:</i> Kalvari i marrjes së kryqit: poezia Sa mirë, atëherë	104
<i>Xhensila Bogdani:</i> “Ritmi rock” në poezinë Një gozhdë	108
<i>Adela Ndoj:</i> Depërtim nëpër errësinë e poezisë së Zorbës	112
<i>Jola Male:</i> Poezia Kadenca e Violës (Vjeshtë)	116
<i>Uendi Belba:</i> Mbi poezinë Në vend të hyrjes	122
Pasthënie: Viola Isufaj.....	125